REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 66/22
Datë/Datum. 16. 08. 2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

---

Psh. nr.66/2022

Bordi i Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik, në bazë të nenit 5, nenit 105, nenit 106 si dhe nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe 104 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L -031, në përbërje znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, z. Agon Ramadani- Anëtar, znj. Kimete Gashi- Anëtare dhe znj. Nita Bejta Cerkini- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës me numër protokolli 66/22, të parashtruar nga operatori ekonomik (në tekstin si më poshtë OE) N.T.SH. "KASTRATI - L" me adresë në Nekoc - Drenas, Bordi i OSHP-së më datë: 12 korrik 2022, mori këtë:

# V E N D I M

I. <u>Hudhet si jashtë afatit për shqyrtim,</u> ankesa e operatorit ekonomik: N.T.SH. "KASTRATI - L" me adresë në Nekoc - Drenas, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e deponisë inerte" me numër të prokurimit: 611-22-293-5-2-1 dhe numër te brendshëm: 611-22-006-521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues (në tekstin si më poshtë AK ) Komuna e Gllocit.

II. Konform nenit 118 të LPP-së OE N.T.SH. "KASTRATI - L" me adresë në Nekoc - Drenas i kthehet tarifa sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

III. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.T.SH. "KASTRATI - L" me adresë në Nekoc - Drenas, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 22.03.2022 me nr. të protokollit 66/2022, kundër vendimit të AK-së –Njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e deponisë inerte" me numër të prokurimit: 611-22-293-5-2-1 dhe numër te brendshëm: 611-22-006-521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK Komuna e Gllocit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se nga data 01. 04. 2021 ka funksionuar pa Bordin për shkak se atij paraprak i ka kaluar mandati ligjor për shqyrtim sipas kompetencave të parapara me ligj, dhe rrjedhimisht nuk ka qenë e mundur që të krijohen panelet shqyrtuese për marrjen e një vendimi përfundimtar ashtu siç është e paraparë me nenin 117 të LPP-së lidhur me nenin 5 të po këtij ligji, si dhe nenit 104 të Ligjit për Procedurë Administrative.

Anëtarët e Bordit të OSHP-së pas analize të të gjithë situatës në tërësi dhe diskutimeve të shumta, përparësive për shqyrtim dhe mos shqyrtim të ankesave që janë pranuar gjatë kohës sa Bordi ka qenë jo funksional, në mbledhjen e mbajtur me datën 12 korrik 2022, me shumicë votash konstatuan se ankesat e parashtruara nuk mund të shqyrtohen për faktin se kanë kaluar afatet ligjore për shqyrtim dhe të njëjtat janë jashtë afatit për shqyrtim.

Bordi i OSHP-së duke u bazuar në nenin 104 të Ligjit për Procedurën Administrative ku thuhet: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", vlerëson se pas kalimit të të gjitha afateve ligjore për shqyrtim ashtu siç parashihet në LPP në nenet 114 115

dhe 117 që përcakton afatet e mundshme deri të marrja e vendimit përfundimtar sa i përket shqyrtimit të një ankese, qëllimi i shqyrtimit të ankesave të grumbulluara është bërë i pamundur dhe i kotë.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore afati i përgjithshëm deri te nxjerrja e një vendimi përfundimtar është 34 ditë si dhe OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij. Andaj, Bordi i OSHP-së, duke u bazuar në të gjitha këto dispozita ligjore, kalimin e afateve ligjore dhe pamundësisë për të nxjerr një vendim përfundimtar nga paneli shqyrtues i OSHP-së, gjithmonë duke pasur parasysh interesin publik, vlerëson se shqyrtimi i këtyre ankesave, do të ishte në kundërshtim me ligjin.

Marrë parasysh mos ekzistencën e organit te shkallës së dytë, në këtë rast të Bordit të OSHP-së, sipas nenit 124, paragrafi 6.1 të LPPA-së, bordi ka konsideruar se palët kanë pas mundësin e shfrytëzimit të mjetit juridik, të padisë, për realizimin e pretendimeve të tyre si dhe marrjen e një vendimi meritor nga Gjykata. Për më tepër, të njëjtat kanë pasur mundësinë të ushtrojnë bashkë me padi edhe kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit sipas nenit 22 të LKA-së pranë Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative.

Meqë ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, rrjedhimisht kemi edhe kontrata te nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, pastaj disa autoritete kontraktuese këto aktivitete te prokurimit të cilat janë objekt i ankesës nuk i kanë në planin buxhetor të këtij viti andaj është e pamundur të bëhet edhe zotimi i mjeteve që është kusht për nënshkrim të kontratave publike.

Bordi si rrethanë tjetër ne marrjen e këtij vendimi ka marrë parasysh edhe ngritjen e konsiderueshëm të çmimeve, fakt ky që është i njohur botërisht, andaj konsiderojmë se mund të mos ketë interes nga operatorët ekonomik të nënshkruhen kontratat që janë objekt i ankesës. Bordi i OSHP-së konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me

kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

**Kryetarja e OSHP-së**

Znj. Vjosa Gradinaj Mexhuanaj

---------------------------------

**Anëtarët:**

z. Vedat Poterqoi

---------------------

z. Agon Ramadani

---------------------

Znj. Kimete Gashi

---------------------

Znj. Nita Bejta Çerkini

---------------------

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gllogocit;

1x1 N.T.SH. "KASTRATI - L" me adresë në Nekoc - Drenas ;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 121/22
Datë/Datum. 10.08.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

---

Psh. nr.121/2022

Bordi i Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik, në bazë të nenit 5, nenit 105, nenit 106 si dhe nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe 104 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L -031, në përbërje znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, z. Agon Ramadani- Anëtar, znj. Kimete Gashi- Anëtare dhe znj. Nita Bejta Cerkini- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës me numër protokolli 121/22, të parashtruar nga operatori ekonomik (në tekstin si më poshtë OE) "Studio Links 4, " me adresë Rr. Xhemajl Mustafa , Su 9/14, Prishtinë, Bordi i OSHP-së, më datë: 12 korrik 2022, mori këtë:

# V E N D I M

I. <u>Hudhet si jashtë afatit për shqyrtim,</u> ankesa e operatorit ekonomik: "Studio Links 4, " me adresë Rr. Xhemajl Mustafa , Su 9/14, Prishtinë, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i draft planit komunal te veprimit për energji dhe klimë " me numër të prokurimit: 611-22-2019-2-2-1 , aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues (në tekstin si më poshtë AK ) Komuna e Gllogocit.

II. Konform nenit 118 të LPP-së OE : "Studio Links 4, " me adresë Rr. Xhemajl Mustafa , Su 9/14, Prishtinë, i kthehet tarifa sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

III. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Studio Links 4, " me adresë Rr. Xhemajl Mustafa , Su 9/14, Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 04.05.2022, me nr. të protokollit 121/2022, kundër vendimit të AK-së –Njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i draft planit komunal te veprimit për energji dhe klimë " me numër të prokurimit: 611-22-2019-2-2-1 , aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK Komuna e Gllogocit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se nga data 01. 04. 2021 ka funksionuar pa Bordin për shkak se atij paraprak i ka kaluar mandati ligjor për shqyrtim sipas kompetencave të parapara me ligj, dhe rrjedhimisht nuk ka qenë e mundur që të krijohen panelet shqyrtuese për marrjen e një vendimi përfundimtar ashtu siç është e paraparë me nenin 117 të LPP-së lidhur me nenin 5 të po këtij ligji, si dhe nenit 104 të Ligjit për Procedurë Administrative.

Anëtarët e Bordit të OSHP-së pas analize të të gjithë situatës në tërësi dhe diskutimeve të shumta, përparësive për shqyrtim dhe mos shqyrtim të ankesave që janë pranuar gjatë kohës sa Bordi ka qenë jo funksional, në mbledhjen e mbajtur me datën 12 korrik 2022, me shumicë votash konstatuan se ankesat e parashtruara nuk mund të shqyrtohen për faktin se kanë kaluar afatet ligjore për shqyrtim dhe të njëjtat janë jashtë afatit për shqyrtim.

Bordi i OSHP-së duke u bazuar në nenin 104 të Ligjit për Procedurën Administrative ku thuhet: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", vlerëson se pas kalimit të të gjitha afateve ligjore për shqyrtim ashtu siç parashihet në LPP në nenet 114 115

dhe 117 që përcakton afatet e mundshme deri të marrja e vendimit përfundimtar sa i përket shqyrtimit të një ankese, qëllimi i shqyrtimit të ankesave të grumbulluara është bërë i pamundur dhe i kotë.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore afati i përgjithshëm deri te nxjerrja e një vendimi përfundimtar është 34 ditë si dhe OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij. Andaj, Bordi i OSHP-së, duke u bazuar në të gjitha këto dispozita ligjore, kalimin e afateve ligjore dhe pamundësisë për të nxjerr një vendim përfundimtar nga paneli shqyrtues i OSHP-së, gjithmonë duke pasur parasysh interesin publik, vlerëson se shqyrtimi i këtyre ankesave, do të ishte në kundërshtim me ligjin.

Marrë parasysh mos ekzistencën e organit te shkallës së dytë, në këtë rast të Bordit të OSHP-së, sipas nenit 124, paragrafi 6.1 të LPPA-së, bordi ka konsideruar se palët kanë pas mundësin e shfrytëzimit të mjetit juridik, të padisë, për realizimin e pretendimeve të tyre si dhe marrjen e një vendimi meritor nga Gjykata. Për më tepër, të njëjtat kanë pasur mundësinë të ushtrojnë bashkë me padi edhe kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit sipas nenit 22 të LKA-së pranë Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative.

Meqë ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, rrjedhimisht kemi edhe kontrata te nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, pastaj disa autoritete kontraktuese këto aktivitete te prokurimit të cilat janë objekt i ankesës nuk i kanë në planin buxhetor të këtij viti andaj është e pamundur të bëhet edhe zotimi i mjeteve që është kusht për nënshkrim të kontratave publike.

Bordi si rrethanë tjetër ne marrjen e këtij vendimi ka marrë parasysh edhe ngritjen e konsiderueshëm të çmimeve, fakt ky që është i njohur botërisht, andaj konsiderojmë se mund të mos ketë interes nga operatorët ekonomik të nënshkruhen kontratat që janë objekt i ankesës. Bordi i OSHP-së konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me

kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

**Kryetarja e OSHP-së**

Znj. Vjosa Gradinaj Mexhuanaj

---------------------------

**Anëtarët:**

z. Vedat Poterqoi

---------------------------

z. Agon Ramadani

---------------------------

Znj. Klimete Gashi

---------------------------

Znj. Nita Bejta Çerkini

---------------------------

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gllogocit;

1x1 "Studio Links 4, " me adresë Rr. Xhemajl Mustafa , Su 9/14, Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 176/22
Data/Datum 07.06.22
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | | |
|---|---|---|---|
| *SahitBeqiri - Ekspert Shqyrtues* Beqiri | *Data e autorizimit të ekspertit:* **01.06.2022** | *Data e dorëzimit të raportit:* **07.06.2022** | *Nr. i lëndës:* **176/22** |

**BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: **31.05.2022.** OE: **"Diamanti" Sh.p.k. – Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **176/22**, kundër **Njoftimit për kontratës,**lidhur me aktivitetin e prokurimit:**"NDERTIMI I KOLEKTOREVE TË UJËRAVE TË ZEZA DRENAS-DOBROSHEC – Projekt dy vjeçar"**, me nr. të prokurimit: **611-22-3495-5-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna Gllogoc.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **612,519.52 €**

***Shënim:*** Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "Diamanti" Sh.p.k. –Prishtinë**

*(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

**Neni 1 i LPP-së**
**Neni 6 i LPP-së**
**Neni 7 i LPP-së**
**Neni 59 i LPP-së**
**Neni 60 i LPP-së**
**Neni 62 i LPP-së**
**Neni 69 i LPP-së**
**Neni 72 i LPP-së**
**Neni 44.5 i RRUOPP-së**

**Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:**

Te nderuar,

1. Duke i analizuar mekujdes dhe vlerësuar se këtë kriter te cilat i ka përcaktuar AK, ne këtë aktivitet dhe vënja e këtij kriteri **ISO 3834-2-2005 (quality requirements for fusion welding of metalic materials part 2 comprehensive quality requirments).** Nga ana e AK, vlerësojmë se është e pa nevojshme dhe pa justifikuar, projekti ka te beje me Ndërtimin e Kolektorëve te ujërave te zeza, ndërsa kërkesa qe kompania te jete e certifikuar me ISO 3834-2-2005 është kërkesë diskriminuese, kjo kërkesë është për konstrucione metalike për Kompani qe merren shkrirje te metaleve metalike, e qe nuk ka fare te beje me projektin ne fjale, dhe është kriter i pa nevojshëm.
   - Andaj kërkojmë nga OSHP qe te merr vendim për largimin e këtij kriteri.

2. Po ashtu ju njoftojmë se duke vlerësuar se këto kritere te cilat i ka përcaktuar AK, ne këtë aktivitet dhe vënja e këtij kriteri **traktor 4x4 me lug ngarkuese**, Ne vlerësojmë se është e pa nevojshme dhe e pa justifikuar, projekti ka te beje me Ndërtim te rrjetit kanalizimit, ndërsa kërkesa për**traktor 4x4 me lug ngarkuese**ështëkërkesë diskriminuese sepse kjo makineri përdoret ne sektorin e bujqësisë dhe jo për kompani ndërtimore, ju njoftojmë se është hera e pare qe kërkohet njëkërkesë e tille, dhe është kriter i pa nevojshëm dhe i pa justifikuar si kritere (Diskriminuese).
   - Andaj kërkojmë nga OSHP qe te merr vendim për largimin e këtij kriteri.

   Kompania jone e ka bere kërkesën për informata shtese me dt. 10.05.2022 për kriteret e lartcekura.
   Ndërsa ne si kompani kemi marruarpërgjigje si sqarim se është vendosur si kriter për "*mos dëmtimin e kulturave bujqësore me makineri te rende dhe punimet zhvillohen kryesisht lidhje sekondare*".
   **Gjithashtu ju sqarojmë se** përkëtë projekt nuk ka te beje fare me lidhje sekondare si dhe mos dëmtuar kulturat bujqësore duhet përdorur makineri për kompani ndërtimore adekuate 4x4 (jo te renda) siç janë: Bobacat i vogël (me rrote), dumper i vogël me rrota, bager i vogël me rrote, Skip me rrote (i cili është me i përdoreshim dhe ngjashëm sipas kërkesës se parapare), ku te gjitha këto mekanizmat e cekur janë funksional ne teren sesa kriteri te cilin e keni kërkuar ju.
3. Po ashtu vënja e këtij kriteri **Kamion kiper pesha max 4 ton** është e pa nevojshme sepse për projekte tilla si kriter vendosen Kamion Kiper me pesha te caktuara e jo kamionete.
4. **Një bachelor i diplomuar ne menaxhimin e emergjencave – 3 vite përvojë pune.**
   Na sqaroni çfarë kuptimi ka te kërkohet bachelor i emergjencave kur keni kërkuar punëtorë te trajnuar për siguri dhe mbrojtje ne pune, nuk është e logjikshme te kemi edhe kërkesa përbachelor te emergjencave.
   - Andaj kërkojmë nga OSHP qe te merr vendim për largimin e këtij kriteri.
5. Po ashtu ju njoftojmë se këto kritere te cilat i ka përcaktuar AK si **Vlerësimi i rriskut për kompani te dëshmohet me vërtetim nga një kompani e licencuar nga organi kompetent (MPMS) se ka kryer vlerësimin e rrezikut për te gjitha pozitat konfor me Ligjit 04/L-161 (vërtetimi duhet te jete i noterizuar) – lideri** vlerësojmë se këto kërkesa janë te pa nevojshme dhe diskriminuese.
   Andaj kërkojmë nga OSHP qe te merr vendim për largimin e këtij kriteri.

Ne baze te hulumtimeve te kompanisë tone dhe eksperiencës shumëvjeçare ne mendojmë qe këto kritere diskriminuese i vendose vetëm AK, Komuna e Gllogoc, ku ne kemi plotësisht baze dhe argumente te dyshojmë se ky tender ështëpërgatitur vetëm për kompani te caktuara, dhe si i tille është kriter favorizues, duke e eliminuar konkurrencën e shëndoshë.

**Pra duke u bazuar ne ligjin e prokurimit publik nuk lejohet te favorizohen një ofertues i shërbimeve dhe te përjashtohen te gjithë te tjerët.**
Kështuqe si kritere te tilla bien ndesh me Ligjin Nr. 04/L-042, për PROKURIM PUBLIK TE REPUBLIKES SE KOSOVES, dhe ligjin nr. 05/L-092, përkatësisht nenin 51.3 dhe nenin 26.2, 26.3 dhe 26.4, Rregulloreve dhe udhëzimeve te Prokurimit Publik.

Kërkojmë nga ju qe këto kritere diskriminuese dhe te kundërligjshëm te largohen si kritere për mundësin teknike dhe profesionale, duke e përmirësuar dosjen.
Duke pasur parasysh te gjitha arsyet faktike dhe ligjore qe u përmenden me lartë, kërkojmë nga OSHP qe te merr :

**VENDIM**

**APROVOHET** – si e bazuar ankesa e OE "Diamanti" Sh.p.k. - Prishtine.
**ANULOHET** – këto kritere diskriminuese dhe te kundërligjshëm duke e përmirësuar dosjen te njoftimit për kontrate dhe te mos favorizohet një kompani ofertuese dhe te përjashtohet te gjithë te tjerët dhe lënda te kthehet ne **RIVLERESIM.**
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore institucione tjera kompetente

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK ), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues,
Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – nuk janë të njëjta me atë te dorëzuar ne kërkesa për rishqyrtim pran AK-së, sepse OE ankues ka shtuar edhe pretendimin **nr. 3 për kamion kiper max. 4 ton** dhe pretendimin **nr. 5 Vlerësimi i rrezikut nga një kompani e licencuar nga (MPMS) – lideri.**





S.B

## KRITERET PËR VLERËSIM

*(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa qëlidhen me pretendimet ankimore*

### III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| 6.- Kompania duhet te jet e certifikuar me Iso - ISO 9001 2015 (Quality Management System).<br>**- ISO 3834-2-2005 (Quality requirments for fusion welding of metallic materials part 2 comprehensive quality requirments).**<br>- ISO 45001-2018 (Occupati olnak helath and safety management system. | 6.- Kompania duhet te jete e certifikuar me Iso - ISO 9001 2015 (Quality Management System).<br>**- ISO 3834-2-2005 (Quality requirments for fusion welding of metallic materials part 2 comprehensive quality requirments).**<br>- ISO 45001-2018 (Occupati olnak helath and safety management system.- CERTIFIKATAT KOPJE |

### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

| Kërkesat: | |
|---|---|
| 8.Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme)<br>- Ekskavator (2copë) minimum 18 ton - Kamionët për transportin e dheut dhe zhavorit kapacitetit min 10 m3 (3 copë) - Kamionë me vinç me peshë bartëse<br>- **Kamionet kiper pesha max 4 ton**<br>- **Traktor 4x4 me lugë ngarkuse te deshmohet me librez.**<br>- Luge ngarkuese për largimin e materialeve -Një makinë hidraulike për shpim - Një pompë për largimin e ujërave nga kanali<br>- Makinë për ngjeshjen e kanalit | **8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje deshmi (kopjet e librezave , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë te noterizuar mbi shfrytëzimin e tyre me qera .**<br><br>- Marrëveshje për Furnizim me gypa të plastikes HDPE SN8 - Marrëveshje për Furnizim me Zhavor - Marrëveshje për Furnizim me gypa te betonit |

## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

*Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Tëpërshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).*

OE ankues: "Diamanti" Sh.p.k., - Prishtinë, ka parashtruar ankese kundër ***Njoftimit për Kontratë***, lidhur me ketë aktivitet te prokurimit, prandaj nuk ka raport të vlerësimit nga AK- Komisioni i vleresimit.

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet të cilat gjenden në platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitur nga operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit.

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

*(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)*

///

## VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

*(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).*

///

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

*(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).*

///



S.B

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Diamanti" Sh.p.k. –Prishtinë

*- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:*

**Përgjigje në Pretendimi nr.1**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se kriter te cilat i ka përcaktuar AK, ne këtë aktivitet dhe vënja e këtij kriteri **ISO 3834-2-2005 (quality requirements for fusion welding of metalic materials part 2 comprehensive quality requirments).** Nga ana e AK, vlerësojmë se është e pa nevojshme dhe pa justifikuar, projekti ka te beje me Ndërtimin e Kolektorëve te ujërave te zeza, ndërsa kërkesa qe kompania te jete e certifikuar me ISO 3834-2-2005 është kërkesë diskriminuese, kjo kërkesë është për konstrucione metalike për Kompani qe merren shkrirje te metaleve metalike, e qe nuk ka fare te beje me projektin ne fjale, dhe është kriter i pa nevojshëm.
Andaj kërkojmë nga OSHP qe te merr vendim për largimin e këtij kriteri.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE ankues ka kërkuar sqarime sipas nenit 53 te LPP-se për informatë shtese dhe AK – ZPP është përgjigjur ka ngritur ne platformën elektronike me datën 12.05.2022 si ne vijim:

*Sqarimet e AK:*

1. *Brenda paramanës dhe parallogarisë është edhe pozicioni i depërtimit te rrugës magjistrale R102 me gyp te qelikut, kjo është arsye a e kërkesë për ISO 3834-2-2005.*
2. *Është kërkuar kamionet kiper, ndërsa për traktor 4*4, duke marrë parasysh ankesat e shumët nga ana e qytetareve pas investimeve ne kanalizim neper prona privat e ku kryesisht janë dëmtuar kulturat bujqësore, është paraparë përdorimi i makinerisë se tille, për arsye te shmangies se problemeve dhe mos dëmtimit te kulturave bujqësore nga makineritë e renda, gjithashtu punimet qe do te zhvillohen janë kryesisht ne lidhje sekondare.*

*JU FALEMINDERIT PER MIREKUPTIM!*

Pas kësaj OE ankues me date 24.05.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim ngrit kërkesën për rishqyrtim, ndërsa AK – ZPP te njëjtën date nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si te pa bazuar me arsyetimin si ne vijim:

*Duke ju referuar ankesës nga OE Diamanti sh.p.k. te gjitha pikat e kërkesës për ri-shqyrtim janë te pabazuara për arsye se:*

1. *Brenda paramases dhe parallogarise është edhe pozicioni 3.5 i depërtimit te rrugës magjistrale R102 me gyp te qelikut, kjo është arsye e kërkesës per ISO 3834-2-2005.*
2. *Per traktor4*4 , duke marre parasysh qe një ankese e tille është paraqitur edhe ne rastet e tjera te ofertave, mirëpo me një makineri te tille ka pasur ofertues te mjaftueshëm, andaj mendojmë se si kriter është i qëndrueshëm.*
3. *Dukem marr parysh qe kolektori do te punohet ne thellësi te mëdha kërkojmë qe sa me shume te këtë staf dhe persona te trajnuar ne këtë drejtim, andaj duhet merren përsysh edhe rreziqet, AK kërkesa te tilla ka parashikuar edhe ne oferta tjera edhe ne periudha paraprake.*

*Kriteret e parashtruara ne njoftimin për kontrate janë te qëndrueshme duke marr parasysh edhe vlerën e madhe te projektit.*

*Me respekt!*

Duke u bazua ne te gjitha këto sqarime nga AK – ZPP lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, **Eksperti shqyrtues sqaron** se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne nenin 71 par. 4 te LLP, ku thote: *"Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit"*, qe do te thotë se OE e interesuar për këtë procedure te prokurimit nëse duan te marrin pjese duhet te jene te licencuar me këto ISO standard, prandaj nëse AK vlerëson se pajisjet te cilat synon ti prokuroj duhet te jene me cilësi sipas këtyre standardeve mund te kërkoj tek specifikimi teknik ne Aneksin 1 ose/dhe mund te kërkoj këto ISO standarde tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne FDT, prandaj AK nuk ka



S.B

respektuar **nenin 7 par. 6 të LPP-së**, sepse zyrtari i prokurimit gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, do të sigurojnë: *(iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik*", duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë. gjithashtu bazuar ne **nenin 51 par. 1 te LPP-se**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate: Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji*". Autoriteti kontraktues duhet te marr për bazë këto nene, gjate hartimit te njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit si material themelore, ne bazë te cilit operatoret ekonomik do te krijojnë tender e tyre, autoriteti kontraktues, duhet te dije me se miri, sepse ata janë te obliguar ti njohin dhe ti përmbushin nevojat për autoritetin kontraktues, ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-se, ne atë mënyrë, qe aq sa është e mundshme te gjitha dokumentet qe duhet te dorëzojnë operatoret ekonomik me dosjen e tenderit, te kufizohen vetëm ne aq dokumente, sa është i nevojshëm për ti lejuar autoriteti kontraktues qe te verifikoj se operatori ekonomik, i përmbush kriteret minimale te përzgjedhjes te saktësuar ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit dhe qe janë ne pajtim me **nenet 65-70 te LPP-se**. Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit ose me fjale tjera ai/ajo është përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te tenderit, **kritereve te përzgjedhjes**, si dhe **kritereve te dhënies**, ndërsa specifikimet teknike do te përgatiten nga struktura te specializuara ne çështjen qe do te prokurohet, brenda autoriteti te kontraktues (mirëpo, specifikat teknike, duhet të jenë në raport të drejt me kriteret e përzgjedhjes). si dhe **nenin 7 par. 2 te LPP-se** , po citoj: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*". Pasi qe ISO standardi 3834-2-2005 përcakton kërkesat gjithëpërfshirëse të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike si në punishte ashtu edhe në vendet e instalimit në terren, andaj duke marr për bazë se poz. 3.5 ne paramasë dhe parallogari ka sasi vetëm 80 metra gjatësi dhe nuk përmban as 10% te vlerës se projektit dhe meqë ka te beje me instalim ne teren sigurisht kish me qene praktike e mire te kërkohet saldues i certifikuar ne mënyrë qe te arrihet qëllimi dhe funksionimi sa me i mire e realizimit te projektit dhe te mbikëqyret nga AK gjate ekzekutimit te projektit, sepse OE mund te jete i certifikuar me këtë, ISO standarde por nëse nuk do te mbikëqyret ne mënyrë strikte nga AK nuk do te sigurohet AK se ky projekt do te realizohet sipas këtij ISO Standardi, dhe sigurisht do te rrite rrezikun për te pranuar oferta me çmim me te lartë për shkak te kufizimit te konkurrencës me këto kritere te përzgjedhjes, sepse ka shume kompania te specializuar për punimet e kanalizimit por ka pak kompani qe janë te certifikuara me ketë ISO standard. Po ashtu ky ISO duhet te kërkohet tek kërkesat mbi aftësitë teknike dhe/ose profesionale dhe jo tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, duke mos e kufizuar konkurrencën mes OE. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **janë të qëndrueshme.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 2**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se vënja e këtij kriteri **traktor 4x4 me lug ngarkuese**, ne vlerësojmë se është e pa nevojshme dhe e pa justifikuar, projekti ka te beje me Ndërtim te rrjetit kanalizimit, ndërsa kërkesa për **traktor 4x4 me lug ngarkuese** është kërkesë diskriminuese sepse kjo makineri përdoret ne sektorin e bujqësisë dhe jo për kompani ndërtimore, ju njoftojmë se është hera e pare qe kërkohet një kërkesë e tille, dhe është kriter i pa nevojshëm dhe i pa justifikuar si kritere (Diskriminuese).

Andaj kërkojmë nga OSHP qe te merr vendim për largimin e këtij kriteri.

Kompania jone e ka bere kërkesën për informata shtese me dt. 10.05.2022 për kriteret e lartcekura.

Ndërsa ne si kompani kemi marruar përgjigje si sqarim se është vendosur si kriter për "*mos dëmtimin e kulturave bujqësore me makineri te rende dhe punimet zhvillohen kryesisht lidhje sekondare*".

**Gjithashtu ju sqarojmë se** për këtë projekt nuk ka te beje fare me lidhje sekondare si dhe mos dëmtuar kulturat bujqësore duhet përdorur makineri për kompani ndërtimore adekuate 4x4 (jo te renda) siç janë: Bobacat i vogël (me rrote), dumper i vogël me rrota, bager i vogël me rrote, Skip me rrote (i cili është me i përdoreshim dhe ngjashëm sipas kërkesës se parapare), ku te gjitha këto mekanizmat e cekur janë funksional ne teren sesa kriteri te cilin e keni kërkuar ju.





S.B

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar **nenin 7 par. 2 të LPP-së** , po citoj: *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*. Pasi qe OE ankues e ka sqaruar mjaft mire dhe ka argumentuar ku thote: *"se përkëtë projekt nuk ka te bëje fare me lidhje sekondare si dhe mos dëmtuar kulturat bujqësore duhet përdorur makineri për kompani ndërtimore adekuate 4x4 (jo te renda) siç janë: Bobacat i vogël (me rrote), dumper i vogël me rrota, bager i vogël me rrote, Skip me rrote (i cili është me i përdoreshim dhe ngjashëm sipas kërkesës se parapare), ku te gjitha këto mekanizmat e cekur janë funksional ne teren sesa kriteri te cilin e keni kërkuar ju"* sepse pavarësisht mundësia për marrëveshje për shfrytëzimin me qira, këto pajisje zakonisht nuk i posedojnë kompanitë te ndërtimit apo kompanitë e specializuar për punimet e kanalizimeve dhe kjo do ta rrite kastën e këtij projekti dhe do ti bëjë te pa barabarte OE qe nuk posedojnë ketë makineri ne raport me ata OE qe posedojnë si dhe makineritë: *Bobacat i vogël (me rrote), dumper i vogël me rrota, bager i vogël me rrote, Skip me rrote*, do te kryejna te njëjtin funksion ne realizimin e qëllimit te projekti dhe ruajtjen e kulturave bujqësore. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **janë të qëndrueshme.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 3**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka kërkuar **Një bachelor i diplomuar ne menaxhimin e emergjencave – 3 vite përvojë pune.**
Na sqaroni çfarë kuptimi ka te kërkohet bachelor i emergjencave kur keni kërkuar punëtorë te trajnuar për siguri dhe mbrojtje ne pune, nuk është e logjikshme te kemi edhe kërkesa për bachelor te emergjencave.
Andaj kërkojmë nga OSHP qe te merr vendim për largimin e këtij kriteri.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimitpërkëtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti Kontraktues – Zyrtari Përgjegjës i prokurimit – Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasiqë dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Rrjedhimisht përgjegjësia mbi përzgjedhjen e kritereve te përzgjedhjes dhe kritereve te dhënies, bie apo ështëpërgjegjësi e plote mbi autoritetin kontraktues. Ai është plotësisht përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te Tenderit, kritereve te përzgjedhjes, si dhe kritereve te dhënies, ndërsa specifikimet teknike do te përgatiten nga struktura te specializuara ne çështjen qe do te prokurohet, brenda autoritetit kontraktues.

Gjithashtu, **eksperti shqyrtues sqaron**, autoriteti kontraktues, duhet te dije me se miri, sepse ata janë te obliguar ti njohin dhe ti përmbushin nevojat për autoritetin kontraktues, ne pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, mirëpo Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, po citoj: ***Kërkesa** 5.Një bachelor i diplomuar në menaxhimin e emergjencave- 3 vite përvojë pune* . ***Dëshmia** 5.Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja , dëshmitë e përvojës ose marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.* ***Kërkesa** 6.Dy punëtor të trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë* . ***Dëshmia** 6.Deshmit e trajnimit , kontrata ose marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.* Bazuar ne **nenin 7 par. 2 te LPP-se** , po citoj: *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*, si dhe **nenin 51 par. 3 te LPP-se**, po citoj: *" Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse,* prandaj konsideroj se është duplifikim i kërkesave nuk janë relevant dhe jo proporcionale, dhe duke marr per baze edhe natyrën e punëve dhe qëllimin, funksionin e këtij projekti, aktiviteti te prokurimit, vetëm njëra kërkesës është e mjaftueshme dhe rrite konkurrencën e OE qe te ofertojnë sa me shume ne funksion te përmbushjes se qëllimit te prokurimit dhe parimit kryesor te prokurimit ***"vlerën për para"***. Prandaj, në bazë të analizës se dokumentacionit te prezantuar, pretendimet e palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht e qëndrueshme.**





S-B

**Përgjigje në Pretendimi Nr. 4**
Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59, 60, 62, 72, të LPP-së, dhe nenin 44.5 te RRUOPP-se.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues është ankuar kundër njoftimit për kontrate, **para hapjes se ofertave**, kurse këto nene kane te bëjnë (flasin për procedurat dhe kushtet pas hapjes se ofertave) me procesin pas hapjes se ofertave. Prandaj, në bazë të analizës se dokumentacionit te prezantuar, pretendimet e palës në ankese në këto pika **nuk janë të qëndrueshme.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 5**
Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, tek pjesa 8. Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet, pretendimi me **nr. 3 për kamion kiper max. 4 ton** dhe pretendimin **nr. 5 Vlerësimi i rrezikut nga një kompani e licencuar nga (MPMS) – lideri.**

Duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me **nenin 108/A të LPP-së**, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e që në rastin konkret OE ankuese, këto pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim, **eksperti shqyrtues** bazuar në**nenin 109 të LPP-së** si dhe **paragrafit 9.2 të nenit 9** të dokumentit **F03 Rregullat për parashtrim te ankesave-verzioni 2**, ku thuhet: *"Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues"* si dhe **neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020, e datës 03.03.2020** në të cilën thuhet: *"Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues"*, andaj nga të cekurat si më lartë pretendimet në fjalë nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike.

**MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE, **të aprovohet si të bazuar**, dhe rekomandon që autoriteti kontraktues korrigjoji/përmirësoj dosjen e tenderit dhe ti njoftoj OE te interesuar me ndryshimet e dosjes se tenderit, ku kriteret e përzgjedhjes të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse, si dhe te beje zgjatjen e afatiti per dorezimin e tenderve sipas **nenit 53 par. 7 të LPP-së**, *(si dhe sa here te ngrite ne sistem B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, te përmiresoj edhe dosjen e tenderit dhe ta ngarkoj ne sistem e-prokurim ne pajtim te plote me nenin 27 par. 4 të LPP-së.),*

*Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:*

- *Autoritetit Kontraktues – Komuna Gllogoc*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – "Diamanti" Sh.p.k.. – Prishtinë,*



S.B

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 176/22
Data/Datum 16.08.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

---

Psh. nr.176/2022

Bordi i Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik, në bazë të nenit 5, nenit 105, nenit 106 si dhe nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe 104 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L -031, në përbërje znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, z. Agon Ramadani- Anëtar, znj. Kimete Gashi- Anëtare dhe znj. Nita Bejta Cerkini- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës me numër protokolli 176/22, të parashtruar nga operatori ekonomik (në tekstin si më poshtë OE) "DIAMANTI" SH.P.K . me adresë Rr. në Naim Frasheri nr. 16 Prishtinë, Bordi i OSHP-së, më datë: 12 korrik 2022, mori këtë:

# V E N D I M

I. Hudhet si jashtë afatit për shqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik: "DIAMANTI" SH.P.K . me adresë Rr. në Naim Frasheri nr. 16 Prishtinë, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kolektorëve te Ujerave te zeza Drenas - Dobroshec-Projekt dy vjeçar" me numër të prokurimit: 611-22-3495-5-1-1 , aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues (në tekstin si më poshtë AK ) Komuna e Gllogocit.

II. Konform nenit 118 të LPP-së OE : "DIAMANTI" SH.P.K . me adresë Rr. në Naim Frasheri nr. 16 Prishtinë,, i kthehet tarifa sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

III. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "DIAMANTI" SH.P.K . me adresë Rr. në Naim Frasheri nr. 16 Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 31.05.2022 me nr. të protokollit 176/2022, kundër vendimit të AK-së –Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kolektorëve te Ujerave te zeza Drenas - Dobroshec-Projekt dy vjeçar" me numër të prokurimit: 611-22-3495-5-1-1 , aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK Komuna e Gllogocit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se nga data 01. 04. 2021 ka funksionuar pa Bordin për shkak se atij paraprak i ka kaluar mandati ligjor për shqyrtim sipas kompetencave të parapara me ligj, dhe rrjedhimisht nuk ka qenë e mundur që të krijohen panelet shqyrtuese për marrjen e një vendimi përfundimtar ashtu siç është e paraparë me nenin 117 të LPP-së lidhur me nenin 5 të po këtij ligji, si dhe nenit 104 të Ligjit për Procedurë Administrative.

Anëtarët e Bordit të OSHP-së pas analize të të gjithë situatës në tërësi dhe diskutimeve të shumta, përparësive për shqyrtim dhe mos shqyrtim të ankesave që janë pranuar gjatë kohës sa Bordi ka qenë jo funksional, në mbledhjen e mbajtur me datën 12 korrik 2022, me shumicë votash konstatuan se ankesat e parashtruara nuk mund të shqyrtohen për faktin se kanë kaluar afatet ligjore për shqyrtim dhe të njëjtat janë jashtë afatit për shqyrtim.

Bordi i OSHP-së duke u bazuar në nenin 104 të Ligjit për Procedurën Administrative ku thuhet: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", vlerëson se pas kalimit të të gjitha afateve ligjore për shqyrtim ashtu siç parashihet në LPP në nenet 114 115

dhe 117 që përcakton afatet e mundshme deri të marrja e vendimit përfundimtar sa i përket shqyrtimit të një ankese, qëllimi i shqyrtimit të ankesave të grumbulluara është bërë i pamundur dhe i kotë.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore afati i përgjithshëm deri te nxjerrja e një vendimi përfundimtar është 34 ditë si dhe OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij. Andaj, Bordi i OSHP-së, duke u bazuar në të gjitha këto dispozita ligjore, kalimin e afateve ligjore dhe pamundësisë për të nxjerr një vendim përfundimtar nga paneli shqyrtues i OSHP-së, gjithmonë duke pasur parasysh interesin publik, vlerëson se shqyrtimi i këtyre ankesave, do të ishte në kundërshtim me ligjin.

Marrë parasysh mos ekzistencën e organit te shkallës së dytë, në këtë rast të Bordit të OSHP-së, sipas nenit 124, paragrafi 6.1 të LPPA-së, bordi ka konsideruar se palët kanë pas mundësin e shfrytëzimit të mjetit juridik, të padisë, për realizimin e pretendimeve të tyre si dhe marrjen e një vendimi meritor nga Gjykata. Për më tepër, të njëjtat kanë pasur mundësinë të ushtrojnë bashkë me padi edhe kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit sipas nenit 22 të LKA-së pranë Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative.

Meqë ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, rrjedhimisht kemi edhe kontrata te nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, pastaj disa autoritete kontraktuese këto aktivitete te prokurimit të cilat janë objekt i ankesës nuk i kanë në planin buxhetor të këtij viti andaj është e pamundur të bëhet edhe zotimi i mjeteve që është kusht për nënshkrim të kontratave publike.

Bordi si rrethanë tjetër ne marrjen e këtij vendimi ka marrë parasysh edhe ngritjen e konsiderueshëm të çmimeve, fakt ky që është i njohur botërisht, andaj konsiderojmë se mund të mos ketë interes nga operatorët ekonomik të nënshkruhen kontratat që janë objekt i ankesës. Bordi i OSHP-së konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me

kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

**Kryetarja e OSHP-së**

Znj. Vjosa Gradinaj Mexhuanaj

-----------------------------------

**Anëtarët:**

z. Vedat Poterqoi

-------------------------

z. Agon Ramadani

-------------------------

Znj. Kimete Gashi

-------------------------

Znj. Nita Bejta Çerkini

-------------------------

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gllogocit;

1x1 "DIAMANTI" SH.P.K . me adresë Rr. në Naim Frasheri nr. 16 Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 210 / 22
Date/Datum. 01.07.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| *Ilir Halili*<br>*Ekspert shqyrtues* | *Data e autorizimit të ekspertit*<br>*21.06.2022* | *Data e dorëzimit të raportit*<br>*01.07.2022* | *Nr. i lëndës:*<br>*210/22* |
|---|---|---|---|

## 1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:17.06.2022, OE ankues **"Sky Net"**, ka parashtruar ankesë me nr: 210/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja dhe abonimi me internet për institucione shkollore dhe kulturore në Komunëne Drenasit"**, me nr.të prokurimit: **611-22-2980-2-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Drenasit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë – shërbim, vlera e vogël, kriteri i dhënjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, , vlera e parashikuar e kontratës: 46732,00 euro per tri vite.

Data e njoftimit për kontratë 07.04.2022, afati i fundit i dorëzimit të tenderit 29.04.2022, kërkesa për rishqyrtim 06.06.2022, Vendimi nga ana e AK-se per kërkesën për rishqyrtim 07.06.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2. PRETENDIMET ANKIMORE

**Neni 1 Qëllimi**

**Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

**Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskrimininii**

**Neni 59 Ekzaminimi, Vlcrësimi dhe Krahasimi i Tenderëvc**

**Neni 69 Aftësia Teknikc dhe/ose Profesionale**

**Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesëDESHMI DHE FAKTE**

Neni 1 Qëllimi

1. **Qëllimi i këtij iigji është të siguroj mënyrën më eflkase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.**
   - **Përmes vlerësimit jo te drejtë dhe shpalles si i pasuksesshem nga aktiviteti i prokurimit te Operatorit Ekonomik NTSH" SKY - NET" AK- KOMUNA GLLOGOC ka kufizuar konkurrencën duke i dhene kontraten operatorit ekonomik i cili nuk eshte ne rregull ne dokumenta dhe me saktesisht tek katalogu i ofruar.**

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. **Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.**
2. **Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.**

**- Përmes vlerësimit jo te drejtë dhe shpalles si i pasuksesshem nga aktiviteti i prokurimit te Operatorit Ekonomik NTSH" SKY - NET" AK- KOMUNA GLLOGOC ka bërë diskriminim dhe trajtim jo te barabartë tc ofertuesve duke eliminuar konkurrencën dhe transparencën qe janë parimet kryesore te Ligjit për Prokurim Publik.**

Ncni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhc Krahasimi i Tcnderëve

1. **Autoriteti kontraktucs do të themcloi një Komision Vlerësues për ckzaminimin, vlerësiniin dhe**

krahasiniin e ofërtave.

2. Paragrafi 2 i nenit 59 te LPP-se ne mënyrë shumë te çarlë e thekson, citat paragrafi *"Autoriteti kontraktues niundet që nte shkrim të kërkojë nsa një tenderues gë të sisurojë një sgarint nte shkriin ntbi cilindo nsa aspektet e tenderit të tij, në ntënyrë gë të bëhet ekzantininti, vlerësinii ose krahasinti i tenderëve. Asnië ndryshint ntaterial dhe asnië aspekt i tenderit niik duhet të kërkohen ose pranohen nsa autoritetikontraktues ose të ofrohen nsa një tenderues. AK-* KOMUNA GLLOGOC *nuk ka zbatuar ketë parasraf dh ene ketë tnënyrë ka bërë shkelje te LPP-se.*

Ncni 69 Aftësia Teknike dhc/ose l'rofesionalc

I. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe speifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik qc të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

- Përmes këtij vlerësimi AK- KOMUNA GLLOGOC duke na shpallur te papergjegjshem neve si Operator Ekonomik NTSH" SKY - NET", ka bere shkelje ligjore duke shpallur fitues nje oe i cili pas qasjes ne dokumenta dhe marrjen e dokumentacionit te ketije OE kemi verejtuar se ka gabime ne katalog dhe ne prezantimin e produkteve.

Ne me date 05.06.2022 kemi bere kerkesen per qasje ne dokumentat e operatorit ekonomik te shpallur fitues , dhe me date 06.06.2022 kemi pasur qasje ne dokumentacion ku kemi marrur te gjithe dokumentacionin dhe oferten e operatorit ekonomik te shpallur fitues .Me poshte do te ju shtjellojme te gjitha ne pika te caktuara te dokumentuara me fakte dhe detaje mbi ecurine e kesaj.

**DETAJE DHE FAKTE:**

Ne operatori ekonomik NTSH SHKY-NET pas pranimit te letres standarde mbi sqarimin e tenderit i kemi kthyer AK-se pergjigjjen ne menyren me te mire te duhur duke i argumentuar me fakte dhe ne detaje te gjitha , ku ne i kemi argumentuar me fatura te rregullta ku keto edhe pse jane konfidenciale ne i kemi derguar per te pasur nje arsyje te forte te pergjigjjes mbi letren standarde qe na ka derguar AK-komuna Gllogoc , ne keto i kemi argumentuar me fatura te rregullta me kupona fiskal dhe normalisht te gjitha keto jane te regjistruara ne ATK , dhe siq edhe ju e dini faturat e prezantuara nga kompania jone jane RAPORTE TE PRANIMIT dhe jane te barasvlefshme dhe te ngjajshme sikurse referencat , bile me te sigurta dhe me te vlefshme mund te jene faturat e rregullta dhe te prezantuara sepse jane raporte te pranimit direkt me klientin qofte institucion publike , private apo edhe me kiient privat.

Gjithashtu ne pergjigjjen tone ne ju kemi cekur se ne jemi te shtrire ne 95% te vendeve te kerkuara nga anet e juaj me fiber optike dhe kyqja e cila do te behet me fiber optike per te gjitha pikat e kerkuara nga ju .

Gjithashtu ne kemi kapacitetet e duhura nga aspekti i logjistikes ku ju kemi cekur se posedojme

veturat e llojit CADDY te dedikuara enkas vetem per terene dhe per klientet tane.

Gjithashtu vlene te ceket se ne jemi prej kompanive kryesore furnizuese nga shtetet e jashtme sa i perket kabllove optike dhe paisjeve percjellese dhe ne me keto materiale i furnizojme si kompanite e medha ashtu edhe te mesme dhe vogla deshmi ju kemi bashkangjitur faturat e shiljes se materialit per keto lloje.

Edhe njehere vlene te ceket se ne i kemi prezantuar te gjitha FATURAT E RREGULLTA DHL ME KUPONA FISKAL DIIE KF.TO JANE RAPORTE TE PRANIMII DHE JANE DESHMI REALE . KETO MUNDEN TE DESHMOHEN EDIIE ME TRANSAKSIONE PERMES BANKES.

Gjithashtu ne si kompani e profcsionalizuar ne kete veprimtari keini vcrcjtur leshimc dhe manipulimc qe jane bere nga ky OE i pretenduar apct pcr dhcnie te kontrates scpsc gjate inspcktiineve qe kemi berc ne dorcziniet e materialeve heren e kaluar nga ky OE kane qcne ne kundershtim me specifikat teknikc ku ky OE nuk ju ka permbajtur specifikavc teknike te dhena sipas Ancksit 1 te D.T inc qellim dhe AK eshtc berc kinsc nuk i ka verejtur. Ne kemi rnbledh prova dhe deshmi inc faktc te listuara si me poshte :

1. Rack cabinet 12u 600x800 (eshte dashur te jete)
   eshte monutar 600x600, deshmi foto

2. Ftofesi per rack cabinet (eshte tjeter lloj por ne paramas nuk ka paramasa te gjate pranohet)
3. Shprendares rryme 9 njesi, per rack mont (eshte dashur te jete)
   eshte monutar 6 njesi, deshmi foto

4. HDMI - Gjatesi 10 metra (ende seshte montuar duhet kontrolluar prap, ne fund te projektit)
5. VGA - Kabell 10 metra (ende seshte montuar duhet kontrolluar prap, ne fund te projektit)
6. MONITOR Brand Name (ende seshte montuar duhet kontrolluar prap, ne fund te projektit)
7. Turbo HD DVR 32CH: (eshte dashur te montohet, modeli DS-8132HUHI-K8)
   eshte montuar (DS-7232HQHI-K2) deshmi foto

8. Turbo HD DVR 16CH: (eshte dashurte montohet DS-7316HUHI-K4)
   eshte montuar (DS-7232HQHI-K2), deshmi foto

9. Turbo HD DVR 8 CH (eshte dashur te montohet, modeli IDS-7208HUH-M2/S)
   (nuk e kemi verifikuar sepse nuk kemi qene ne vende ku ka me pak se 16 kamera)

10. HDD 4TB 3.5 SATA 6GB PURPLE (Nuk kemi mundurta verifikojm sepse eshte dashur te hapet dvr)
11. HDD 2TB, interial, 3.5 SATA 6BPS RPM Intellipovver, PURPLE (Nuk kemi mundur ta verifikojm sepse eshte dashur te hapet dvr)
12. Mbajtes DVR-ri per Rack Mount (eshte vendosur ne rregull sepse nuk kerkohen specifikacione shtese)
13. Kamera BuIlet per perdorim te jashtem (eshte dashur te montohet DS-2CE16H8T- IT3F OSE

DS-2CE16H8T-1T5F)

14. **Kamera bullt per perdorim te brendshem (eshte dashur te montohet DS-2CE16H8T- ITF) eshte montuar nje lloje qe nuk ka as llojin e vendosur por sipas pamjes dyshohet te jene (DS-2CE56H0T-IRMMF(C))**

15. **Rozete per Kamera Material ALUMIN: (eshte dashur te vendosen te aluminit dhe ëaterproff jane vendosur te plastikes deshmi foto**

16. **Eshte dashur te vendoset Poëcri mutlichannels me siguresa**

**Është vendosur tjetër llohj dëshmi foto**

17. **RG-59 BNC Krimp konektor**

**18.Ok**

**10. CCTV kabllo eshte dashur te vendosel furnizimi i rrymes 2x0.75**

**sipas shiqimit nuk cshte 2x0.75 eshte 2x0.50 por per kete duhet hukimtin shtese**

20. **Kanale plastike pa vrima (mbaten metrat ne fund te projcktit**
21. **KThesa per kanale plasitkc pa vrima (shiqohen nc fund te projektil)**
22. **UTP CAT6 (kabull e rrjetit nuk ka nevoj te vendoset farc por, ne fund tc projcktit duhet shiquar)**
23. **Sxvitch 24 port POE (Nuk ka nevoj te vendoset fare, nuk jane vendosur, endc duhct shiquar ne fund te projektit)**
24. **Patch panel cat6 (Nuk ka nevoj te vendosct fare, nuk jane vendosur, cndc duhet shiquar ne fund te projektit)**
25. **Kabllimi i kamerave (ne Disa shkolla jane shfrytezuar kabllot egzisutese, qc kanc qenc te vendosura, kabllot janc te vjetra gjithashtu kabllo cshte per perdorim te brendshem jane vendosur mbi kulum e cila demtohen brenda 3 muajve sepse kabllo eshte per kualitet te brendshem)**

26. **Montimi i kamerave brenda objektit (OK)**
27. **Moniti i kamres jashte objektit (OK)**
28. **OK**
29. **OK**
30. **Priza rj45 (nuk ka pas nevoj fare, dueht shiquar ne fund te projektit)**
31. **Materrail te imet (nuk kemi informacion)**

**Gjitha keto manipulime ne realicionin AK-OE ne i kemi te argumentuar dhe deshmuara me fakte me foto te prezantuara ku keto foto do i bashkangjesim Ankeses sone ne OSHP si deshmi se ky OE ka kryer pune duke mos i qendruar specifikave teknike , dhe normalisht AK keto eshte bere kinse**

**nuk i ka vrejtuar dhe ja ka aprovuar liferimin e mallit jo konform specifikave teknike.**

**Eshte e pa logjikshme te na eliminoni per kete kriter kur eshte vleresuar nga nje institucion me i larte se ju i cili e ka bere vete kete dosje dhe e ka monituruar dhe vleresuar.**

**Ne shprehim shqetesimin tone mbi kete dhe asesi nuk pajtohemi me vendimin e AK-se dhe per kete arsyje ne bejme ankesen ne OSHP.**

**Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) qe sipas dispozitave ligjore te Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, te aprovoj ankesën tonë si te <u>BAZUAR</u> dhe te kthej lenden ne <u>RIVLERESIM.</u>**

## 3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vlera e parashikuar e projektit | 5.5 | 46732,00 euro per tri vite<br>Per vitin 2022 – 14,322 drejtoria e Arsimit dhe 1848 drejtoria e DKRS<br>Per vitin 2023- 13860 drejtoria e Arsimit dhe 1848 drejtoria e DKRS<br>Per vitin 2024 – 2025 -13860 drejtoria e Arsimit dhe 1848 drejtoria e DKRS | |
| | | Kërkesat e përshtatshmërisë: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| | | **1. Kërkesat përshtatëshmerisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, përkatësisht Nenit 65 pika 1,2,3,4, 4.9 dhe 5.** | **1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal.** |
| | | **2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit** | **2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik (vetem per OE fitues) - kopje. Jo me te vjeter se 90 dite.** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike** | **3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetem per OE fitues) – origjinal. Jo me te vjeter se 6 muaj.** |
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | 7.1 & 7.2 | **Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| | | **1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;** | **1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);** |
| | | **2. Rexhistrimi i numrit fiskal** | **2. Kopja e numrit fiskal** |
| | | **3. Rexhistrimi në TVSH** | **3. Kopje e Rexhistrimit në TVSH** |
| | | **4.OE duhet te jete i certifikuar me ISO 45001-2018 - Aktivitete primare te telekomunikacionit kabllor , aktivitete e telekomunikacionit pa tela - ëirlees .** | **4.OE duhet te jete i certifikuar me ISO 45001-2018 - Aktivitete primare te telekomunikacionit kabllor , aktivitete e telekomunikacionit pa tela - ëirlees - kopje** |
| | | **5. OE duhet te deshmoj se ka leje te operimit ( Vendim ) te leshuar nga ARKEP ( Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektonike dhe Postare )** | **5. OE duhet te deshmoj se ka leje te operimit ( Vendim ) te leshuar nga ARKEP ( Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektonike dhe Postare ) - kopje** |
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **Kapaciteti teknik dhe professional:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | 1.Të paraqitët stafi që do të angazhohet në ketë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional , menaxheri i projektit duhet te jete bachelor i shkencave kompjuterike i caktuar me nje vendim . Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 2 punonjës me pervoje pune minimumi dy vite ne lemin e internetit . | 1. Lista e stafit - Origjinal Për të gjitha kërkesat rreth stafit të mesem duhet të ofrohen dëshmitë kontratat kopje dhe deshmia e pervojes, për stafin profesional (bachelor i shkencave kompjuterike ) kontrata ose marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë në këtë projekt, kopja e Diplomës , CVI-ja - kopje |
| | | 2.Të paraqitën Kontratat e sherbimeve të natyrës se ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë min 20,000.00€ | 2. Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës së ngjajshme , kopje kontratave te bashkangjitura me ( raportet e pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave- njeren prej tyre ) ne 3 vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) , institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat. |
| | | 3.Caktimi i Menaxherit për këtë projekt | 2. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit për këtë projekt – origjinal . |

## 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PËR RISHQYRTIM)

VENDIM

I .Refuzohet si e papazuar kerkesa e operatorit ekonomik "N.T.SH." SKY - NET " kunder njoftimit per dhenje te autoritetit kontraktues "Mirembajtja dhe abonimi me internet per institucione shkollore dhe kulturore ne komunen e drenasit" me nr. 611-22-2980-2-2-1 dhe nr.i brendshëm: 611-22- 024-221 si e pabazuar .

OE ka paraqitur kerkesë për rishqyrtim te AK me datën 06.06.2022 kunder njoftimit për dhenje ne AK dhe refuzohet si e pabazuar per arsye se :

Duke u bazuar ne Ligjin per Prokurimin Publik , AK Komuna e Drenasit ka trajtuar ne menyre te barabarte te gjitha ofertat dhe ka vlersuar ne baze te kritereve ne njoftim per kontrate dhe ne doje te tenderit.
AK ka filluar vlersimin nga operatori me qmimin me te ulet " N.T.Sh SKY NET" ku ne baze te kerkese per sqarime te dates 02.05.2022 ju nuk i keni ofruar kopjet e kontrateve dhe sqarimet per qmimet e ulta (nen 30 % kane qene jo bindese per komisionin e vlersimit ) dhe bazuar ne nenet e posht cekura , arsyet e eleminimit:

18.23 Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

39.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtese në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomikë dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesat kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve ne pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtese të paraqitura.

Andaj duke u bazuar ne Rregullat dhe Udhezuesit e Prokurimit Publik ju jeni i papergjegjshem dhe kerkesajuaj eshte e pabazuar.

Kunder ketij vendimi keni te drejt ankese brenda 10 ditesh ne OSHP .

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

**Pretendimi nr.1**

Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës 210/22 kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka ofruar dëshmitë dokumentare të kërkuara për kryerje të punëve të nghjashme , më konkretisht sipas AK-së OE ankues nuk ka ofruar "kontrata" pëtr shërbimet e kryera, e po ashtu sipas AK-Klomisionit vlerësues sqarimet e ofruara nga OE sa i përket cmimeve jo normalisht të ulëta nuk kanë qenë bindëse për AK-në.

*"pas qasjes ne dokumenta dhe marrjen e dokumentacionit te ketije OE kemi verejtuar se ka gabime ne katalog dhe ne prezantimin e produkteve."*.

Sqarojmë fillimisht se pas anlizimit të dosjes së tenderit, nuk kemi gjetur kërkesa për katalogje apo pajisje të caktuara, dhe vlerësojmë se të njëjtat nuk mund të përdoren si arsyetim për eliminim të OE-ve derisa nuk kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit.

Sa i përket arsyes së eliminimit të OE për mungesë të kontratave, sqarojmë se kërkesa decidive në dosje të tenderit ka qenë si në vijim:

| | |
|---|---|
| 2.Të paraqitën Kontratat e sherbimeve të natyrës se ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë min 20,000.00€ | 2. Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës së ngjajshme , **kopje kontratave te bashkangjitura me ( raportet e pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave- njeren prej tyre** ) ne 3 vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) , institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat. |

Pas analizimit të ofertës së OE ankues, e po ashtu dhe sqarimeve të dhëna nga OE ankues, nuk kemi gjetur dëshmi-kopje të kontratave të cilat dëshmojnë kryejren e shërbimeve të ngjashme në vlerë 20,000€.

Me gjithë se mungesa e referencave në pajtim me nenin 68 par.3 të LPP-së, mund të plotësohet me dëshmi tjera në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, në rastin konkret mungojnë kopjet e kontratave, kërkesë kjo e renditur e para sa i përket dëshmive dokumentare.

Sa i përket arsyes së eliminimit për cmime jo normalisht të ulëta, AK pasi ka konstatuar se janë ploësuar kushtet parapara

sipas nenit 3 par.3.1 pika “i”, “ii” dhe “iii” të Rregullave për Tender jo Normalisht të Ulë, ka pranuar sqarime nga OE ankues sa i përket cmimeve, dhe me gjithë se OE ankues ka pranuar dhe ka kërkuar që ti rritet sigurimi i ekzekutimit , AK në janë përjgjigjur se sqarimet e dhëna ga OE nuk kanë qenë bindëse për AK-konkretisht komisioninin vlerësues.

Me gjithëse sipas rregullave për tender jo normalisht të ulët nuk thuhet shprehimisht se vetëm AK-të mund të vlerësojnë cmimet/tenderët jo normalisht të ulët, neni 4.6 i këtyre rregullave përcakton si në vijim.

*“4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:*

*4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose*

***4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, “Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet”, brenda dy dite nga data e vendimit. “***

Me gjthë se për neve si ekspert shqyrtues sqarimet e OE ankues sa i përket cmimeve janë bindëse, bazuar në dispozitën e lartëcekur konsiderojmë se kjo qështje mbetet në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, andaj i mbetet panelit shqyrtues të marr vendim përfundimtar lidhur me këtë qështje.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore të OE ankues janë pjesërisht të bazuara.

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që vërtetohet vendimi i AK-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Drenas.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - “Sky Net”

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr: 210/22
Datum: 03.08.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---

**PSH.nr 210/22**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej z. Vedat Poterqoi-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: **"Sky Net"**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe abonimi me internet për institucione shkollore dhe kulturore në Komunën e Drenasit", me nr. të prokurimit: 611-22-2980-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Drenasit, më datën: 29. 07. 2022, mori këtë:

## VENDIM

I. **Refuzohet,** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik: **"Sky Net"**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe abonimi me internet për institucione shkollore dhe kulturore në Komunën e Drenasit", me nr. të prokurimit: 611-22-2980-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Drenasit.

II. **Mbetët në fuqi,** vendimi i AK- Komuna e Drenasit për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe abonimi me internet për institucione shkollore dhe kulturore në

Komunën e Drenasit", me nr. të prokurimit: 611-22-2980-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Drenasit.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Sky Net", refuzohet, i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Sky Net", ka parashtruar ankesë me nr: 210/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe abonimi me internet për institucione shkollore dhe kulturore në Komunën e Drenasit", me nr. të prokurimit: 611-22-2980-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Drenasit, duke pretenduar që AK ka vepruar në kundërshtim me:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:
Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë DESHMI DHE FAKTE

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21. 06. 2022,

ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 01. 07. 2022, në raportin e ekspertizës ka sqaruar se:

**Pretendimi nr.1**

Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës 210/22 kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka ofruar dëshmitë dokumentare të kërkuara për kryerje të punëve të ngjashme , më konkretisht sipas AK-së OE ankues nuk ka ofruar "kontrata" për shërbimet e kryera, e po ashtu sipas AK-Komisionit vlerësues sqarimet e ofruara nga OE sa i përket çmimeve jo normalisht të ulëta nuk kanë qenë bindëse për AK-në.

*"pas qasjes ne dokumente dhe marrjen e dokumentacionit te këtij OE kemi vërejtur se ka gabime ne katalog dhe ne prezantimin e produkteve.".*

Sqarojmë fillimisht se pas analizimit të dosjes së tenderit, nuk kemi gjetur kërkesa për katalogje apo pajisje të caktuara, dhe vlerësojmë se të njëjtat nuk mund të përdoren si arsyetim për eliminim të OE-ve derisa nuk kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit.

Sa i përket arsyes së eliminimit të OE për mungesë të kontratave, sqarojmë se kërkesa decidive në dosje të tenderit ka qenë si në vijim:

| | |
|---|---|
| 2.Të paraqitën Kontratat e shërbimeve të natyrës se ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë min 20,000.00€ | 2. Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës së ngjashme , **kopje kontratave te bashkangjitura me ( raportet e pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave-njërën prej tyre** ) ne 3 vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) , institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat. |

Pas analizimit të ofertës së OE ankues, e po ashtu dhe sqarimeve të dhëna nga OE ankues, nuk kemi gjetur dëshmi-kopje të kontratave të cilat dëshmojnë kryerjen e shërbimeve të ngjashme në vlerë 20,000€.

Me gjithë se mungesa e referencave në pajtim me nenin 68 par.3 të LPP-së, mund të plotësohet me dëshmi tjera në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, në rastin konkret mungojnë kopjet e kontratave, kërkesë kjo e renditur e para sa i përket dëshmive dokumentare.

Sa i përket arsyes së eliminimit për çmime jo normalisht të ulëta, AK pasi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet e parapara sipas nenit 3 par.3.1 pika "i", "ii" dhe "iii" të Rregullave për Tender jo Normalisht të Ulë, ka pranuar sqarime nga OE ankues sa i përket çmimeve, dhe me gjithë se OE ankues ka pranuar dhe ka kërkuar që ti rritet sigurimi i ekzekutimit, AK në janë përgjigjur se sqarimet e dhëna nga OE nuk kanë qenë bindëse për AK-konkretisht komisionin vlerësues.

Me gjithësi sipas rregullave për tender jo normalisht të ulët nuk thuhet shprehimisht se vetëm AK-të mund të vlerësojnë çmimet/tenderët jo normalisht të ulët, neni 4.6 i këtyre rregullave përcakton si në vijim.

*"4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:*

*4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose*

*4.6.2 **Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit. "***

Me gjithë se për neve si ekspert shqyrtues sqarimet e OE ankues sa i përket çmimeve janë bindëse, bazuar në dispozitën e lartcekur konsiderojmë se kjo çështje mbetet në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, andaj i mbetet panelit shqyrtues të marr vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore të OE ankues janë pjesërisht të bazuara.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që vërtetohet vendimi i AK-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04 korrik 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë 05 korrik 2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues me datën 06 korrik 2022 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-

në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datën: 29 korrik 2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Përfaqësuesi i OE-së z. Leku i cili deklaroj: "Po dmth ato qe kanë kërkuar këto kërkesat qe ka pas komuna unë po mendoj qe i kemi plotsu te gjitha edhe kërkesa e tyne ka qenë për kontratat e klientëve me shfaq ne këtë lajmin e njëjtë, dëshmi ma e mirë se faturimi dhe pranimi i pagesës ne bankë për lajmin e njëjtë se di qe ka gjithashtu i kanë edhe kuponat fiskal te skanuar dhe kanë librin në shitje i cili është i dorëzuar ne ATK.

Kryetari i panelit shqyrtues z. Poterqoi deklaroj: "Kanë kërku AK informacione shtesë lidhur me proceset e pranimit nga personat privat"
Përgjigjja e OE "Nuk kam nga për kuponat fiskal"
Kryetari i panelit shqyrtues bëri pyetje direkte "A ki kontrate me persona privat"
OE: "Përgjigje jo nuk kam"
"Janë edhe faturat kur e kanë kërku ata shtesë ja kom dërgu faturat shtesë, i njëjti përfitues ka bërë shkelje asnjë pik nuk ja ka përputh i njëjtit OE për Fati net. OE unë qëndrojmë prapa ankesës time"
Ne vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit te AK-së z. Hajdini i cili deklaroj: "Jam ushtrues detyre e mbështes çdo vendim qe e kemi marr lidhur me këtë rast te jetë ne fuqi ai vendimi jonë ne nuk jemi bind me sqarimet e ofruara edhe na e mbështesim këta na jemi ne rregull d.m.th. Qëndroni prapa vendimit".

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Halili i cili deklaroj: "Unë pas dëgjimit te palëve nuk pas ndonjë arsyeje me ndryshu mendimin qe e kam dhanë ne raport sa i përket kërkesës se dosjes se tenderit për kontrata te shërbimeve te natyrës se ngjashme ne tre vitet e fundit për 20.000 euro, dëshmi dokumentare janë kërkuar kopjet e kontratave me raporte te

pranimeve ose referenca njëra prej tyre. OE e ka ofrua një listë prej 85 faqeve me pagesa te klientëve mirëpo nuk ka ofru as kontrata as raporte te pranimit as referenca. Eksperti shqyrtues unë qëndroj mbrapa ekspertizës".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Lidhur me Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës 210/22 kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka ofruar dëshmitë dokumentare të kërkuara për kryerje të punëve të ngjashme , më konkretisht sipas AK-së OE ankues nuk ka ofruar "kontrata" për shërbimet e kryera dhe po ashtu sipas AK-Komisionit vlerësues sqarimet e ofruara nga OE sa i përket çmimeve jo normalisht të ulëta nuk kanë qenë bindëse për AK-në. Paneli shqyrtues. Paneli shqyrtues në bazë të ofertës së paraqitur të OE ankues nuk ka hasur në kontrata të bashkangjitura me raporte ose procese të pranimeve, ashtu siç është kërkuar në Njoftim për Kontratë/Dosje të Tenderit, këtë e ka konfirmuar edhe OE ankues gjatë seancës kryesore dëgjimore, andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar. Ndërsa, sa i përket trajtimit të çmimit abnormalisht të ulët, Paneli Shqyrtues këtë pretendim e vlerëson si pjesërisht të bazuar sepse OE ankues ju ka përgjigjur kërkesës së AK-së, ku ka ofruar sqarime dhe ka kërkuar që të rritet sigurimi i ekzekutimit.

Andaj, Paneli shqyrtues e mbështet mendimin e ekspertit dhe konstaton se autoriteti kontraktues ka vepruar konform nenit 59 dhe 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me
kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetar i PSH-së

Z. Vedat Poterqoi

---

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna e Drenas

1x1 OE "Sky Net"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 252/22
Datë/Datum. 25.08.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

---

**PSH.nr.252/22**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Peterqoi – Kryetar, znj. Nita Bejta – Referuese , z. Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Fidan Hasaj B.I."– Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: "Arhiko.ing O.P."-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës – Ri-tenderim", me nr. të prok: 611-22-5452-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK- Drenas", më datën: 25.08.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Fidan Hasaj B.I."– Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës – Ri-tenderim", me nr. të prok: 611-22-5452-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK- Drenas".

**II.ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës – Ri-tenderim", me nr. të prok: 611-22-5452-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK- Drenas", dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

**III**. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Fidan Hasaj B.I."– Deçan, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI** .Obligohet operatori ekonomik ankues: "Fidan Hasaj B.I."– Deçan, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: "Fidan Hasaj B.I."– Deçan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 04.07.2022 me nr. 252/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës – Ri-tenderim", me nr. të prok: 611-22-5452-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK- Drenas", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 61 parag. 6, B57 Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët, neni 3parag. 3.1, 69, si dhe nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 39.8 i RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 25.07.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Fidan Hasaj B.I."– Deçan,

**Sqarim hyrës:** Autoriteti kontraktues Komuna Gllogoc, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës -shërbim, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët.

**Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Fidan Hasaj" B.I.**

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes sqarojmë se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ndërlidhen me arsyetim të eliminimit të ofertës së OE ankues nga ana e AK-së, dhe zbatim të gabuar të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, përkatësisht nenit 3 të këtyre rregullave paragrafi 3.1 dhe nenin 61 të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues potencohet në ankesë. Sqarojmë se fillimisht autoriteti kontraktues me datë 22.06.2022 i ka dërguar OE ankues Letrën Standarde te kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, ku AK ka kërkuar nga OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, qe të jepe një zbërthim të detajuar të pozicioneve veç e veç të pjesëve relevante të tenderit e cila përfshin një shpjegim të çmimit të ulët sipas Ligjit të Prokurimit Publik neni 61 LPP-së. Kurse, OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, me dt. 22.06.2022, i është përgjigjur sqarimeve të AK-së, me një analizë financiare të shpenzimeve për ketë projekt.

AK- Komuna Gllogoc, nuk është bindur me sqarimet e prezantuara nga OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, dhe nëpërmjet B42 Letrës Standarde për tenderuesit e eliminuar ka njoftuar operatorin ekonomik "Fidan Hasaj" B.I me arsyetimin e eliminimit si në vijim:

•1.Sqarimet e prezantuara për çmime nuk janë bindëse për arsye se AK me formularin për çmime te ulëta B-41 ka kërkuar zbërthim te detajuar te çdo pozicioni ne paramase ndërsa ju keni prezantuar vetëm shpenzimet e firmës për ketë projekt nuk keni prezantuar analizën e pozicioneve. Oferta juaj është 20117 euro me e ulet se vlera e planifikuar dhe 17862 euro me e lire se oferta e dyte qe janë çmime ekstremisht te lira.

•2. CV e menaxherit te kontratës është kërkuar te jete e skanuar nga origjinali, ju keni prezantuar kopje.

•3. CV e Inxhinierit te ndërtimtarisë është kërkuar e skanuar nga origjinale ju keni prezantuar te nënshkruar me nënshkrim elektronik.

Bazuar në sqarimet e dhëna si më lartë, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK -Komuna Gllogoc, ka kërkuar nga OE ankues "Fidan Hasaj" B.I informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët për të shpjeguar çmimet e ofruara sipas Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët. Ekspertja sqaron se sipas Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, autoritetit kontraktues i lejohet që të kërkoj sqarime për çmimet e ofruara nga operatorët ekonomik në dy rrethana. Në rrethanën e parë, AK mund të kërkoj sqarime kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenit 3.1 të rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët.

Në rrethanën e dytë, AK mund të kërkoj sqarime kur ka dilema apo mëdyshje për çmimet e ofruara edhe sipas nenit 3.2 të rregullave për tender jo-normalisht të ulët edhe nëse nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 3.1. Për më shumë referoju nenit 3.2 si më poshtë:

□ 3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së. Pra neni 3.2 i këtyre Rregullave i jep kompetencë AK-së që të kërkoj sqarime për çmimet e ofruara çdo herë kur AK ka mëdyshje se nuk janë ofruar çmimet e tregut. Po ashtu edhe nenin 61 i LPP-së ka përcaktuar se kur një operator ekonomik e dorëzon një tender që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të nenit 61 të LPP-së. Për më shumë referoju nenit 61 të LPP-së, si më poshtë:

**Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

2.1.ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

2.3.çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

2.4.origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen.

6. KRPP-ja nxjerr akt nënligjor për rregullimin në hollësi për përcaktimin e çmimit jo-normalisht të ulët. Në rastin konkret, AK i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik konform nenit 61 të LPP-së dhe nenit 3.2 të Rregullave për tender jo normalisht të ulët. OE ka dhënë përgjigjet sipas kërkesës së AK-së por autoriteti kontraktues nuk është bindur me shpjegimet të cilat i ka dhënë OE në lidhje me çmimet e ofruara. Pra pas marrjes së shpjegimeve, AK sipas nenit 4.6.1 ka vlerësuar që sqarimet apo shpjegimet e dhëna nuk mjaftojnë dhe e ka refuzuar tenderin, ku neni 4.6.2 ka përcaktuar:

4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit.

Ekspertja konsideron se AK ka ndjekur rregullat e përcaktuara në nenin 61 të LPP-së dhe Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët. Parashtruesi i ankesës përmes sqarimeve të dhëna pran AK-së të datës 22.06.22, insiston se kontratën do ta realizoi dhe qëndron pas çmimeve të ofruara dhe kompania do ta ketë edhe fitimin e sajë të mjaftueshëm, mirëpo AK nuk është bindur lidhur me këto sqarime të operatorit ekonomik dhe është në diskrecion të autoritetit kontraktues nëse bindet apo jo sepse AK para se të inicioj një aktivitet të prokurimit ka për obligim që të hulumtoj tregun dhe të siguroj informatat e nevojshme për produktet apo shërbimet të cilat i prokuron. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pikës së dytë dhe të tretë të eliminimit të OE ankues "Fidan Hasaj" B.I se "CV e menaxherit te kontratës është kërkuar te jete e skanuar nga origjinali, ju keni prezantuar kopje" dhe "CV e Inxhinierit te ndërtimtarisë është kërkuar e skanuar nga origjinale ju keni prezantuar te nënshkruar me nënshkrim elektronik". Ekspertja shqyrtuese sqaron se parashtruesi i ankesë në ofertë ka prezantua kopje CV e menaxherit te kontratës të z. Kushtrim Berisha dhe CV e Inxhinierit te ndërtimtarisë z. Enver Gashi. Pra AK nëse ka pas dilema lidhur me CV ka mundur të kërkoj sqarim shtesë dhe lejohet ofrimi i sqarimeve për situatë të tillë konform nenit 72 të LPP-së dhe nenit 39 të RRUOPP-së. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përfundimisht, sipas asaj që u tha si më lart, vlerësimi ynë është se për këtë procedurë të prokurimit Autoriteti Kontraktues -Komuna Gllogoc, i ka respektuar procedurat e parapara me LPP dhe RRUOPP-së, si dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të ulët, ku ka ndjekur procedurën inter partes sipas nenit 4 të Rregullave për tender jo normalisht të ulët por nuk është bindur me shpjegimet e ofruara nga OE. Andaj, duke pasur parasysh që AK nuk është bindur me sqarimet e dhëna nga OE, ekspertja vlerëson se AK ka vendosur sipas dispozitave të nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët përkatësisht nenit 4.6.2 të këtyre rregullave. Sa i përket pikës së dytë dhe tretë të eliminimit që ka të bëjë me CV e menaxherit të kontratës dhe CV e Inxhinierit të ndërtimtarisë, ekspertja konsideron se edhe nëse lënda do të kthehej në ri vlerësim për sqarime shtesë në lidhje me CV, përsëri nuk do të ndryshonte rezultati përfundimtar i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve pasi që AK e vlerëson tenderin e OE ankues si jo-normalisht të ulët.

## Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, të aprovohet pjesërisht si e bazuar, dhe ti lejohet AK-së, të procedoi tutje me aktivitetin e prokurimit, konform dispozitave të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.07.2022, me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 25.07.2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Fidan Hasaj B.I."– Deçan, me datë: 25.07.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 24.08.2022, pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:
Lidhur me pretendimin ankimor se autoriteti kontraktues Komuna e Gllogocit, ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së. Paneli shqyrtues e klasifikon si të bazuar këtë pretendim, për faktin se OE ankues në detaje ka ofruar të gjitha informacionet, shpjegimet dhe sqarimet lidhur me çmimin e ulët të ofruar, që për panelin shqyrtues këto shpjegime janë të bindshme dhe të mjaftueshme dhe AK, ka qenë dashtë të veproj konform nenit 61 të LPP-së, paragrafi 3, i cili citon: "*Pas marrjes*

*parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë."*

Shkeljen e kësaj dispozite e vërteton edhe fakti se AK, edhe pse përmes formularit B41, ka kërkuar nga OE ankues zbërthim të detajuar të çdo pozicioni, ndërsa, në njoftimin për eliminim të OE ankues, nuk e specifikon se për cilat pozicioneve shpjegimet e ofruara nuk janë të mjaftueshme dhe të bindshme për AK-në, por vetëm se "*Oferta e juaj është 20117 euro më e ulët se vlera e planifikuar dhe 17862 euro më e lirë se oferta e dytë që janë çmime ekstremisht të ulëta.*"

Kjo lenë të kuptohet se shpjegimet e ofruara nga OE ankues, AK nuk i ka trajtuar fare dhe nuk i ka marrë në konsideratë, ashtu siç nuk i ka marrë në konsideratë edhe pretendimet e tjera të OE ankues në Kërkesën për ri-shqyrtim drejtuar AK-së, me arsyen se *"pasi që çmimet nuk ishin bindëse për AK-në ne nuk kemi kërkuar sqarime shtesë për CV-në"*.

Paneli shqyrtues për pretendimet 2 dhe 3 të OE ankues, sa i përket CV-ve të inxhiniereve, e klasifikon të bazuar, ngase, Autoritetet Kontraktuese gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohen në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj: " *Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë...*" Po ashtu sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, "*të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*". Lidhur me kërkesat e parashtruara për kualifikimin e ofertuesve ( të lidhura me nenin 65-70 të LPP-së), AK, gjatë vlerësimit mund të kërkojë nga ofertuesi sqarim të tenderëve, por pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit.(Nenit 59.4 ,nenit 72 të LPP-së, dhe nenit 39 të RRUOPP-së).

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij Vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

_______________

z. Vedat Poterqoi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "KK-Drenas ",

1x1 OE - "Fidan Hasaj B.I." –Malishevë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 252/22
Datë/Datum. 25.07.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| *Majlinda Bedrolli* <br> *Ekspert shqyrtues* | *Data e autorizimit të ekspertit* <br> *14.07.2022* | *Data e dorëzimit të raportit* <br> *25.07.2022* | *Nr. i lëndës:* <br> *252/22* |
|---|---|---|---|

## 1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.07.2022, OE ankues **"Fidan Hasaj" B.I,** ka parashtruar ankesë me nr: **252/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik **"Arhiko.ing O.P " –Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Hartimi i proejkteve per nevoja te komunes –RITENDERIM",** me nr.të prokurimit**:** 611-22-5452-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Gllogoc.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur- shërbim, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët.
Vlera e parashikuar e kontratës: 35 000,00

Njoftimi për Kontratë i publikuar me datë 06.06.2022
Hapja e tenderit me datë 17.06.2022
Njoftimi mbi tenderuesin e pasuksesshëm me datë 30.06.2022
Njoftimi mbi vendimin e AK-s me datë30.06.2022
Kërkesa për rishqyrtim e datës 01.07.2022

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 04.07.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:
Neni 1 i LPP-së,
Neni 6 i LPP-së, paragrafi 1,
Neni 7 i LPP-së,
Neni 61 i LPP-së, paragrafi 6,
B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, neni 3, paragrafi 3.1,
Neni 69 i LPP-së,
Neni 72 i LPP-së,
Neni 39.8 RRUOPP-së

**DEKLARATA DETALE E ANKESES**

Ne si OE që kemi aplikuar në tenderin në fjalë dhe kemi kërkuar nga AK që të bëjë rishqyrtimin e vendimit të datës 30.06.2022, ku në bazë të këtij vendimi AK ka bërë shkeljen e Ligjit PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, konkretisht dispozitave të cekura më lartë, duke shpallur fitues kompaninë e cila ka ofertuar me çmim edhe njëherë më të lartë se oferta jonë!
Në bazë të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 30.06.2022, ne jemi eliminuar për pretendimet si më poshtë:

**Arsyet e eliminimit;**

*1.Sqarimet e prezantuara për çmime nuk janë bindëse për arsye se AK me formularin për çmime te ulta B-41 ka kërkuar zbërthim te detajuar te çdo pozicioni ne paramase ndërsa ju keni prezantuar vetëm shpenzimet e firmës për ketë projekt nuk keni prezantuar analizën e pozicioneve. Oferta juaj është 20117 euro me e ulet se vlera e planifikuar dhe 17862 euro me e lire se oferta e dyte qe janë çmime ekstremisht te lira.*

*2.CV e menaxherit te kontratës është kërkuar te jete e skanuar nga origjinali, ju keni prezantuar kopje.*

*3.CV e Inxhinierit te ndërtimtarisë është kërkuar e skanuar nga origjinale ju keni prezantuar te nënshkruar*

*me nënshkrim elektronik.*

**Pika nr.l:** AK me datë 22.06.2022 ka bërë kërkesë (për informata mbi tenderët jo- normalisht të ulët), për mendimin tonë, kjo kërkesë ka qenë e jashtë ligjshme! Po e theksojmë kërkesë e jashtë ligjshme me qenë se në bazë të Nenit 61 të LPP-s, paragrafit 6, më konkretisht Rregullave për Tenderët Jo-Nornialisht të Ulët, nenit 3 të këtyre rregullave, paragrafi 3.1, kërkohet të plotësohen tre kushte për të eliminuar një ofertues për çmimin Jo-normalisht të ulët! Ne po i paraqesim më poshtë këto tre kushte ashtu siç parashihet me rregulla dhe Ligj:

*3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:*

*i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të Përgjegjshëm;*

*ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;*

*iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.*

Në nenin 3, konkretisht paragrafin 3.1 thuhet që duhet të përmbushën të gjitha kushtet e mëposhtme! Ne konstatojmë se 2 kushtet e para plotësohen, ndërsa theksojmë se nuk plotësohet kushti i tretë, ku kërkohet decidivisht që janë dorëzuar të paktën 3 tender!

Sa për rikujtim, në këtë proces të prokurimit, kemi marrë pjesë vetëm dy ofertues, pra janë dorëzuar vetëm 2 tenderë, me këtë rast nuk plotësohet kushti për të na eliminuar për shkak të çmimit jo-normalisht të ulët. Me këtë veprim, AK ka shkelur Nenin 61 i LPP-s, paragrafin 6 dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, neni 3, paragrafi 3.1.

**Eliminimi për pikën nr. 1 nuk është i bazuar!**

**Pika nr.2:** Sa i përket CV-së, menaxherit të projektit, nëse e shikojmë qartë, ajo vërehet shuma qartë se është e skanuar nga fletët origjinal të prezantuar nga vet inxhinieri, ku ky i fundit edhe i ka nënshkruar! Ne nuk e kuptojmë se si ju keni konstatuar se CV qenka kopje!? Ky pretendim i juaji është i pa saktë, për mendimin tonë tendencioz, dhe shumë i pa arsyeshëm, me qenë se Inxhinieri, këtë rast menaxheri i përcaktuar nga ne si OE, ka një bagazh dhe një profesionalizëm të madh në natyrën e punës sikur kjo në këtë projekt, dhe nuk mendojmë se mund të na eliminoni për arsye kaq minore!

**Pika nr.3:** Sa i përket CV-së inxhinierit të ndërtimtarisë, ne deklarojmë se CV e inxhinierit është nënshkruar nga vetë inxhinieri, nënshkrimi është kryer në letër dhe pastaj është skanuar nga origjinali. Edhe për këtë pikë, ne mendojmë se pretendimi juaj është i pa saktë dhe i pa arsyeshëm!

Sa i përket pikave 2 dhe 3 të arsyetimit të eliminimit tonë nga gara, mendojmë se arsyetimet e AK-s nuk qëndrojnë, dhe edhe nëse keni pasur mëdyshje për origjinalitetin e dokumenteve (CV- ve), AK ka pasur mundësi që të kërkoni sqarime shtesë në bazë të Nenit 72 i LPP-s dhe Nenit 39.8 RRUOPP-s, ku thuhet që:

CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e

kërkuara, AK nuk mund të vendos

Mund të kërkohen informata **sqaruese 69**

Siç shihet edhe në tabelë, AK ka mundur që të kërkoj informata shtesë, por që një gjë të tillë nuk e ka bërë, na ka eliminuar në pikat 2 dhe 3 për arsye që nuk qëndrojnë!
Me veprimin e AK-s, duke na eliminuar neve si OE me çmim më të lirë, ne mendojmë se ka shkelur Nenin 1 të LPP-s, Nenin 6 të LPP-s, paragrafi 1 dhe Nenin 7 të LPP-s, duke shpërblyer me kontratë OE me çmimin më të lartë, në vlerë prej 32,745.00 Euro, me këtë rast AK nuk ka marrë për bazë nenin 6 të LPP-s, duke i shkaktuar humbje ekonomike të panevojshme buxhetit të Komunës së Drenasit, me këtë rast duke mos pasur barazi në trajtim, AK ka shkelur nenin 7 të LPP-s.
Në vendimin e datës 04.07.2022, mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 01.07.2022, AK ka arsyetuar vendimin mbi refuzim në nenin 3.2 të Rregullave për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët, ku me këtë rast ne mendojmë se ka bërë shkelje të nenit 3.1, ashtu siç kemi paraqitur më lartë!

Në pikën 2 të arsyetimit nga AK kemi një përgjigje të pa bazuar, ku thonë se me qenë se çmimet nuk ishin bindëse, ne nuk kemi kërkuar sqarime shtesë për CV! Ne mendojmë se AK është e detyruar që në bazë të LPP-s dhe rregullave në fuqi, të bëjë vlerësimin e drejt, duke u bazuar në ligj e jo në bindje siç e kanë dhënë arsyetimin në pikën 2! Nëse kanë tentuar të paraqesin pikat 2 dhe 3 në vendimin mbi eliminim si shkelje, atëherë është dashtë që pa marrë parasysh bindjeve të tyre, të kërkojnë sqarime shtesë sipas B47.

Kërkojmë nga OSHP, si organ shtetëror për mbrojtjen e ligjshmërisë, që bazuar në Nenin 1 të LPP-s dhe bazuar në të dhënat e paraqitura më lartë të APROVONI si të bazuar Ankesën tonë, të anuloni vendimin e AK-s të datës 30.06.2022 dhe të detyroni AK-n që të respektoj dispozitat ligjore dhe procedurën t'a kthej në RIVLERËSIM.

## 3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Kërkesat e përshtatshmërisë:<br>**1. Kërkesat përshtatëshmerisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L- 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, përkatësisht Nenit 65 pika 1,2,3,4, 4.9 dhe 5.** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>**1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal.** |
| | | **2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit** | **2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve jo me e vjeter se 90 ditë (vetem per OE fitues) - kopje.** |
| | | **3.Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike** | **3.Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike jo me vjeter se 6 muaj apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetem per OE fitues) – origjinal apo e noterizuar.** |
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | 7.1 & 7.2 | Profesionalna podobnost<br>**1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>**1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit** |
| | | **2.Rexhistrimi i numrit fiskal** | **2.Kopja e numrit fiskal – kopje** |
| | | **3.Çertifikata e TVSH-së** | **3.Kopja e TVSH-së** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **4. OE duhet të dëshmoj së është i çertifikuar me ISO 9001 valid.** | **4. OE duhet të dëshmoj së është i çertifikuar me ISO 9001 valid- kopje** |
| | | **5.OE duhet të dëshmoj së është i çertifikuar me ISO 31000 valid.** | **5.OE duhet të dëshmoj së është i çertifikuar me ISO 31000 valid- kopje** |
| Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare | 8.1 & 8.2 | **Ekonomski i finansijski kapacitet**<br>**1.Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi të knaqëshme Autoritetit kontraktus së qarkullimi vjetor i OE gjatë periudhes( nga njoftimi për kontratë për përiudhën e shkuar trevjeqare) ka qene jo me pak se 50,000.00€ ( ne ratë të konzerciumit, lideri duhet të këtë vlerën min 60% të kërkesës).** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>**1.Kopje e noterizuar e raporteve financiare për tri vitet e fundit të çertifikuara nga një kompani e licencuar për auditim( kontroll). Se pak dy nga tri vitet e kërkuara bilanci duhet të jëtë pozitiv. Të gjithë antarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmin e kërkuar.** |
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **Tehničke i profesionalne mogućnosti**<br>**1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në fushën e projektimit dhe mbikqyrjes (nga njoftimi për kontratë për përiudhën e shkuar trevjeçare) në vlerën prej të gjitha së bashku jo më pak së 35,000.00€.** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>**1.Një list të projekteve te relaizuar origjinale e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekt të përfunduara lista duhet ti ketë këto të dhëns Titulli i kontratës, Investitori dhe të dhënat e personit kontaktues, data e fillimit të kontraës, data e përfundimit të projektit, përshkrimi e projekit dhe detyrave, roli e kompanisë ofertuse në zbatimin e kontratës( lider apo partner).Për çdo projekt qe është shënuar duhet referencat kopje e noterizuar (për investitor privat duhet ti bashkangjitet leja ndërtimit kopje e noterizuar).** |
| | | **2. Të paraqitët stafi që do të angazhohet në ketë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional.** | **2. Lista e stafit – Origjinal** |
| | | **3. Menaxher i projektit duhet te jete Inxh.dipl. ark. ose ndert. ( min 5 vjet nga diplomimi )kopja e diplomes e noterizuar.** | **3. Eksperinca ne 5 vite e fundit ne detyren e Arkitektit, min.5projekte me vlere te pergjithshme te projektit jo me te vogel se 35,000.00€. Projektet te prezantoen ne CV origjinale dhe te nënshkruar nga vet eksperti, te bashkangjiten referenca nga investitori, kopje te noterizuara. Vrejtje Menaxheri i proejktit nuk duhet te jete i futut ne pozita tjera te kërkura.** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **4.Nje Inxh.dipl. arkitektures ( min 5 vjet nga diplomimi )kopja e diplomes e noterizuar.** | **4. Eksperinca ne 5 vite e fundit ne detyren e Arkitektit, min.5projekte me vlere te pergjithshme te projektit jo me te vogel se 35,000.00€. Projektet te prezantoen ne CV origjinale dhe te nënshkruar nga vet eksperti, te bashkangjiten referenca nga investitori, kopje te noterizuara** |
| | | **5.Nje Inxh.dipl. ndertimtaris ( min 5 vjet nga diplomimi )kopja e diplomes e noterizuar.** | **5. Eksperinca ne 5 vite e fundit ne detyren e proejktusit dhe mbikqyresit te rrugve, min.5projekte me vlere te pergjithshme te projektit jo me te vogel se 35,000.00€. Projektet te prezantoen ne CV origjinale dhe te nënshkruar nga vet eksperti, te bashkangjiten referenca nga investitori, kopje te noterizuara.** |
| | | **6. Nje Inxh.dipl. gjeodezis ( min 5 vjet nga diplomimi )kopja e diplomes e noterizuar.** | **6. Eksperinca ne 5 vite e fundit ne detyren e matjeve gjeodezike min.5projekte me vlere te pergjithshme te projektit jo me te vogel se 35,000.00€. Projektet te prezantoen ne CV origjinale dhe te nënshkruar nga vet eksperti, te bashkangjiten referenca nga investitori, kopje te noterizuara.** |
| | | **7.Nje Inxh.dipl. hidroteknikes ( min 5 vjet nga diplomimi )kopja e diplomes e noterizuar.** | **7. Eksperinca ne 5 vite e fundit ne detyren e projektimit te dhe mbikqyrjes te Hidro instalimeve ne dertime te ulta dhe te larta min.5 projekte me vlere te pergjithshme te projektit jo me te vogel se 35,000.00€. Projektet te prezantoen ne CV origjinale dhe te nënshkruar nga vet eksperti, te bashkangjiten referenca nga investitori, kopje te noterizuara.** |
| | | **8.Nje Inxh.dipl. elektrikes ( min 5 vjet nga diplomimi )kopja e diplomes e noterizuar.** | **8. Eksperinca ne 5 vite e fundit ne detyren e projektimit te dhe mbikqyrjes te instalimeve elektrike min.5 projekte me vlere te pergjithshme te projektit jo me te vogel se 35,000.00€. Projektet te prezantoen ne CV origjinale dhe te nënshkruar nga vet eksperti, te bashkangjiten referenca nga investitori, kopje te noterizuara.** |
| | | **10.Metodologjia e projektimit** | **10. Softëer te licencuar per projektim plateformen BIM( Revit ose ArchiCad( Licenca ne emer te OE te deshmohet me kopje te noterizuar dhe flet pages).** |

## 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 30.06.2022, është konstatuar si në vijim: AK- Komuna Gllogoc, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik "Arhiko.ing O.P" -Prishtinë, në vlerë totale të ofertës 32 745,00 euro.

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

**Sqarim hyrës:** Autoriteti kontraktues Komuna Gllogoc, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës -shërbim, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët.

**Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Fidan Hasaj" B.I.**

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes sqarojmë se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ndërlidhen me arsyetim të eliminimit të ofertës së OE ankues nga ana e AK-së, dhe zbatim të gabuar të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, përkatësisht nenit 3 të këtyre rregullave paragrafi 3.1 dhe nenin 61 të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues potencohet në ankesë.

Sqarojmë se fillimisht autoriteti kontraktues me datë 22.06.2022 i ka dërguar OE ankues Letrën Standarde te kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, ku AK ka kërkuar nga OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, që të jepe një zbërthim të detajuar të pozicioneve veç e veç të pjesëve relevante të tenderit e cila përfshin një shpjegim të çmimit të ulët sipas Ligjit të Prokurimit Publik neni 61 LPP-së.

Kurse, OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, me dt. 22.06.2022, i është përgjigjur sqarimeve të AK-së, me një analizë financiare të shpenzimeve për ketë projekt.

AK- Komuna Gllogoc, nuk është bindur me sqarimet e prezantuara nga OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, dhe nëpërmjet B42 Letrës Standarde për tenderuesit e eliminuar ka njoftuar operatorin ekonomik "Fidan Hasaj" B.I me arsyetimin e eliminimit si në vijim:

- *1.Sqarimet e prezantuara për çmime nuk janë bindëse për arsye se AK me formularin për çmime te ulta B-41 ka kërkuar zbërthim te detajuar te çdo pozicioni ne paramase ndërsa ju keni prezantuar vetëm shpenzimet e firmës për ketë projekt nuk keni prezantuar analizën e pozicioneve.* ***Oferta juaj është 20117 euro me e ulet se vlera e planifikuar dhe 17862 euro me e lire se oferta e dyte qe janë çmime ekstremisht te lira.***
- *2.CV e menaxherit te kontratës është kërkuar te jete e skanuar nga origjinali, ju keni prezantuar kopje.*
- *3.CV e Inxhinierit te ndërtimtarisë është kërkuar e skanuar nga origjinale ju keni prezantuar te nënshkruar me nënshkrim elektronik.*

Bazuar në sqarimet e dhëna si më lartë, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK -Komuna Gllogoc, ka kërkuar nga OE ankues "Fidan Hasaj" B.I informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët për të shpjeguar çmimet e ofruara sipas Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët. Ekspertja sqaron se sipas Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, autoritetit kontraktues i lejohet që të kërkoj sqarime për çmimet e ofruara nga operatorët ekonomik në dy rrethana.

Në rrethanën e parë, AK mund të kërkoj sqarime kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenit 3.1 të rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët.

Në rrethanën e dytë, AK mund të kërkoj sqarime kur ka dilema apo mëdyshje për çmimet e ofruara edhe sipas nenit 3.2 të rregullave për tender jo-normalisht të ulët edhe nëse nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 3.1. Për më shumë referoju nenit 3.2 si më poshtë:

- 3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët **për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave,** autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Pra neni 3.2 i këtyre Rregullave i jep kompetencë AK-së që të kërkoj sqarime për çmimet e ofruara çdo herë kur AK ka mëdyshje se nuk janë ofruar çmimet e tregut. Po ashtu edhe nenin 61 i LPP-së ka përcaktuar se kur një

operator ekonomik e dorëzon një tender që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të nenit 61 të LPP-së. Për më shumë referoju nenit 61 të LPP-së, si më poshtë:

**Neni 61**
**Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

   2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

   2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

   2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

   2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

4. **Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.**

5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen.

6. KRPP-ja nxjerr akt nënligjor për rregullimin në hollësi për përcaktimin e çmimit jonormalisht të ulët.

Në rastin konkret, AK i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik konform nenit 61 të LPP-së dhe nenit 3.2 të Rregullave për tender jo normalisht të ulët. OE ka dhënë përgjigjet sipas kërkesës së AK-së por autoriteti kontraktues nuk është bindur me shpjegimet të cilat i ka dhënë OE në lidhje me çmimet e ofruara.
Pra pas marrjes së shpjegimeve, AK sipas nenit 4.6.1 ka vlerësuar që sqarimet apo shpjegimet e dhëna nuk mjaftojnë dhe e ka refuzuar tenderin, ku neni 4.6.2 ka përcaktuar:

4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

*4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm,* **të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë**; ose

*4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton,* **të refuzoj tenderin dhe,** ne përputhje me nenin 61 te LPP-se **të njoftoj KRPP**, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "***Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet***", brenda dy dite nga data e vendimit

Ekspertja konsideron se AK ka ndjekur rregullat e përcaktuara në nenin 61 të LPP-së dhe Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët. Parashtruesi i ankesës përmes sqarimeve të dhëna pran AK-së të datës 22.06.22, insiston se kontratën do ta realizoi dhe qëndron pas çmimeve të ofruara dhe kompania do ta ketë edhe fitimin e sajë të mjaftueshëm, mirëpo AK nuk është bindur lidhur me këto sqarime të operatorit ekonomik dhe është në diskrecion të autoritetit kontraktues nëse bindet apo jo sepse AK para se të inicioj një aktivitet të prokurimit ka për obligim që të hulumtoj tregun dhe të siguroj informatat e nevojshme për produktet apo shërbimet të cilat i prokuron. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pikës së dytë dhe të tretë të eliminimit të OE ankues "Fidan Hasaj" B.I se *"CV e menaxherit te kontratës është kërkuar te jete e skanuar nga origjinali, ju keni prezantuar kopje" dhe "CV e Inxhinierit te ndërtimtarisë është kërkuar e skanuar nga origjinale ju keni prezantuar te nënshkruar me nënshkrim elektronik"*. Ekspertja shqyrtuese sqaron se parashtruesi i ankesë në ofertë ka prezantua kopje CV e menaxherit te kontratës të z. Kushtrim Berisha dhe CV e Inxhinierit te ndërtimtarisë z.Enver Gashi. Pra AK nëse ka pas dilema lidhur me CV ka mundur të kërkoj sqarim shtesë dhe lejohet ofrimi i sqarimeve për situatë të tillë konform nenit 72 të LPP-së dhe nenit 39 të RrUOPP-së. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përfundimisht, sipas asaj që u tha si më lart, vlerësimi ynë është se për këtë procedurë të prokurimit Autoriteti Kontraktues -Komuna Gllogoc, i ka respektuar procedurat e parapara me LPP dhe RrUOPP-së, si dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të ulët, ku ka ndjekur procedurën inter partes sipas nenit 4 të Rregullave për tender jo normalisht të ulët por nuk është bindur me shpjegimet e ofruara nga OE. Andaj, duke pasur parasysh që AK nuk është bindur me sqarimet e dhëna nga OE, ekspertja vlerëson se AK ka vendosur sipas dispozitave të nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët përkatësisht nenit 4.6.2 të këtyre rregullave .

| |
|---|
| Sa i përket pikës së dytë dhe tretë të eliminimit që ka të bëjë me CV e menaxherit të kontratës dhe CV e Inxhinierit të ndërtimtarisë, ekspertja konsideron se edhe nëse lënda do të kthehej në ri vlerësim për sqarime shtesë në lidhje me CV, përsëri nuk do të ndryshonte rezultati përfundimtar i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve pasi që AK e vlerëson tenderin e OE ankues si jo-normalisht të ulët. |
| |
| |

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues "Fidan Hasaj" B.I, të aporovohet pjesërisht si e bazuar, dhe ti lejohet AK-së, të procedoi tutje me aktivitetin e prokurimit, konform dispozitave të LPP-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - Komuna Gllogoc.

- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Fidan Hasaj" B.I

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 353/21
Datë/Datum. 25.07.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEË BODY**

---

Psh. nr.353/2021

Bordi i Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik, në bazë të nenit 5, nenit 105, nenit 106 si dhe nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe 104 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L -031, në përbërje znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, z. Agon Ramadani- Anëtar, znj. Kimete Gashi- Anëtare dhe znj. Nita Bejta Cerkini- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës me numër protokolli 353/21 të parashtruar nga operatori ekonomik (në tekstin si më poshtë OE) N.T "FER PETROLL" me adresë Fshati Terstenik - Drenas , Bordi i OSHP-së më datë: 12 korrik 2022, mori këtë:

## V E N D I M

I. <u>Hudhet si jashtë afatit për shqyrtim,</u> ankesa e operatorit ekonomik: N.T "FER PETROLL" me adresë Fshati Terstenik - Drenas , ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull: "Kanalizimi i ujërave te zeza në fshatrat, Terstenik I dhe II Verboc dhe Shtuticë, Baicë, Krajkovë, Damanek dhe Shtrubullovë projekt dy vjeçar " Lot 1 dhe 2 me numër të prokurimit: 611-21-235-5-2-1 dhe numër te brendeshem:611-21-004-521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues (në tekstin si më poshtë AK ) Komuna Gllogoc.

II. Konform nenit 118 të LPP-së OE N.T "FER PETROLL" me adresë Fshati Terstenik - Drenas, i kthehet tarifa sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

III. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.T "FER PETROLL" me adresë Fshati Terstenik - Drenas, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 27.04.2021, me nr. të protokollit 353/2021, kundër vendimit të AK-së –Njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit me titull: "Kanalizimi i ujërave te zeza në fshatrat, Terstenik I dhe II Verboc dhe Shtuticë, Baicë, Krajkovë, Damanek dhe Shtrubullovë projekt dy vjeçar " LOT 1 dhe 2, me numër të prokurimit: 611-21-235-5-2-1 dhe numër te brendeshem:611-21-004-521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK Komuna Gllogoc.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se nga data 01. 04. 2021 ka funksionuar pa Bordin për shkak se atij paraprak i ka kaluar mandati ligjor për shqyrtim sipas kompetencave të parapara me ligj, dhe rrjedhimisht nuk ka qenë e mundur që të krijohen panelet shqyrtuese për marrjen e një vendimi përfundimtar ashtu siç është e paraparë me nenin 117 të LPP-së lidhur me nenin 5 të po këtij ligji, si dhe nenit 104 të Ligjit për Procedurë Administrative.

Anëtarët e Bordit të OSHP-së pas analize të të gjithë situatës në tërësi dhe diskutimeve të shumta, përparësive për shqyrtim dhe mos shqyrtim të ankesave që janë pranuar gjatë kohës sa Bordi ka qenë jo funksional, në mbledhjen e mbajtur me datën 12 korrik 2022, me shumicë

votash konstatuan se ankesat e parashtruara nuk mund të shqyrtohen për faktin se kanë kaluar afatet ligjore për shqyrtim dhe të njëjtat janë jashtë afatit për shqyrtim.

Bordi i OSHP-së duke u bazuar në nenin 104 të Ligjit për Procedurën Administrative ku thuhet: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, vlerëson se pas kalimit të të gjitha afateve ligjore për shqyrtim ashtu siç parashihet në LPP në nenet 114 115 dhe 117 që përcakton afatet e mundshme deri të marrja e vendimit përfundimtar sa i përket shqyrtimit të një ankese, qëllimi i shqyrtimit të ankesave të grumbulluara është bërë i pamundur dhe i kotë.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore afati i përgjithshëm deri te nxjerrja e një vendimi përfundimtar është 34 ditë si dhe OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij. Andaj, Bordi i OSHP-së, duke u bazuar në të gjitha këto dispozita ligjore, kalimin e afateve ligjore dhe pamundësisë për të nxjerr një vendim përfundimtar nga paneli shqyrtues i OSHP-së, gjithmonë duke pasur parasysh interesin publik, vlerëson se shqyrtimi i këtyre ankesave, do të ishte në kundërshtim me ligjin.

Marrë parasysh mos ekzistencën e organit te shkallës së dytë, në këtë rast të Bordit të OSHP-së, sipas nenit 124, paragrafi 6.1 të LPPA-së, bordi ka konsideruar se palët kanë pas mundësin e shfrytëzimit të mjetit juridik, të padisë, për realizimin e pretendimeve të tyre si dhe marrjen e një vendimi meritor nga Gjykata. Për më tepër, të njëjtat kanë pasur mundësinë të ushtrojnë bashkë me padi edhe kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit sipas nenit 22 të LKA-së pranë Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative.

Meqë ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, rrjedhimisht kemi edhe kontrata te nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, pastaj disa autoritete kontraktuese këto aktivitete te prokurimit të cilat janë objekt i ankesës nuk i kanë në planin buxhetor të këtij viti andaj është e pamundur të bëhet edhe zotimi i mjeteve që është kusht për nënshkrim të kontratave publike.

Bordi si rrethanë tjetër ne marrjen e këtij vendimi ka marrë parasysh edhe ngritjen e konsiderueshëm të çmimeve, fakt ky që është i njohur botërisht, andaj konsiderojmë se mund të mos ketë interes nga operatorët ekonomik të nënshkruhen kontratat që janë objekt i ankesës.

Bordi i OSHP-së konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

**Kryetarja e OSHP-së**

z. Vjosa Gradinaj Mexhuanaj

-----------------------------

**Anëtarët:**

z. Vedat Poterqoi

-----------------------

z. Agon Ramadani

---------------------

Znj. Kimete Gashi

---------------------

Znj. Nita Bejta Çerkini

---------------------

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gllogocit;

1x1 OE N.T "FER PETROLL" me adresë Fshati Terstenik - Drenas;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 356/22
Data/Datum: 14.10.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

----Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**PSH. nr. 356/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Znj.Kimete Gashi–Kryetare, Z. Vedat Poterqoi-Referues, Z.Agon Ramadani–Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i OE "Labinot M.Krasniqi B.I", "Toni Ingjinjering" sh.p.k dhe "Mirusha Company" Shpk-Gllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregulllimi i infrastruktures trotuarit dhe ndriqimit publik ne Koumunen e Drenasit-proejkt dy vjeçar - Ritenderim" me nr. të prokurimit: 611-22-5551-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Gllogoc, me datën 07.10.2022 mori këtë:

## VENDIM

**I. APROVOHET** si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik OE "Labinot M.Krasniqi B.I", "Toni Ingjinjering" sh.p.k dhe "Mirusha Company" Shpk-Gllogoc, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 18.08.2022 me numër të protokolit 356/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Rregulllimi i infrastruktures trotuarit dhe ndriqimit publik ne Koumunen e Drenasit-projekt dy vjeçar - Ritenderim" me nr. të prokurimit:611-22-5551-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Gllogoc.

**II. ANULOHET** Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e grupit të OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Me 08.06.2022, Autoriteti Kontraktues – Komuna Gllogoc ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregulllimi i infrastruktures trotuarit dhe ndriqimit publik ne Koumunen e Drenasit-proejkt dy vjeçar - Ritenderim" me nr. të prokurimit:611-22-5551-5-2-1.

Me datën 05. 08. 2022, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës sa i përket aktivitetit të prokurimit, ndaj të cilit grupi i OE ankues me 09.08.2022, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK me vendim të datës 12.08. 2022.

Me 18.08.2022 grupi i OE ankues "Labinot M.Krasniqi B.I", "Toni Ingjinjering" sh.p.k dhe "Mirusha Company" Shpk-Gllogoc, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 356/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 08.09.2022,
Raporti i Ekspertit
Përgjigje në Pretendimi nr.l
Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ne eliminon ne këtë aktivitet te prokurimit lidhur me Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit .
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2 të FDT-së, si ne vijim:

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| *l.Pasqyrat financiare te audituara per tri vitet e fundit.* | *l.Kopjet e pasqyrave financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyratpërkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit - ( te bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit)- PER* |

Lideri i grupit te operatoreve ekonomik - Labinot M Krasniqi (NNP "TONI") ka ngarkuar ne platformën elektronike e- prokurimi, ka ofruar/dorëzuar Raportin e pasqyrove te audituara për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nga kompania " ECP & CONTO" Sh.p.k. duke j bashkangjitur Certifikatën (licence) me nr. 19 te datës 01.09.2016 te notrizuar nga noteri z. Selatin D. Shahini me LRP. Nr. 15865/2022 te datës: 07.07.2022, andaj AK - komisioni i vlerësimit me rastin e eliminimit te GOE ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56 par. 3 të LPP-së, ku thotë: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e Tenderit"., si dhe nenin 41.11 te RRUOPP-së, ku thotë: "Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e Tenderif'. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr, 2
Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK na eliminon nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimet se: Grupi i operatoreve ekonomik nuk ka arritur te plotësoj këtë kriter pasi qe autorizimin nga prodhuesi nuk e ka te noterizuar nga origjinali (z njëjti nuk ka arritur te paraqes asnjë marrëveshje ne mes te Grupit te Operatoreve Ekonomik dhe Prodhuesit LEDEUROPA me seli ne Austri) sipas kërkesës se Autoriteti Kontraktues.
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| *4.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katallog ne përputhje me standartet Evropjane dhe kompatibil me ndriçuesin e ofruar , katalogu të dorëzohet ne dosje të Tenderit* | *4.Autorizim nga prodhuesi per Pupat ndriques te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrëveshje me Prodhuesin marrëveshja duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Prodhuesi ku mundet me përdor OE me konfirmim te prodhuesit.* |

prokurimit, bazuar ne Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.1 & 7.2 të FDT-së, si ne vijim:

Lideri i GOE NNP "TONI" - Negrovc, Gllogoc, ka dorëzuar katalogun për artikuj me specifikim - përshkrim teknik

detal, si dhe Autorizimin nga Prodhuesi LEDEUROPA për trupat ndriçues te lëshuar me date:05.07.2022, i cili nuk është i noterizuar, po reshte nënshkruar nga prodhuesi, si dhe nuk është i vulosur nga prodhuesi, ku thotë, po citoj:

"Autorizojn [NNP "TONI" Negrofc, Gllogoc] për te ofruar dhe shitur ne Kosove dritat LED teprodhuara nga ne nen Markën LED Europa. Ky formular autorizim është i vlefshëm për 3 vjet duke filluar nga data e lëshimif. Andaj duke u bazuar ne analizën si me lartë, ne raste se AK - Komisioni i vlerësimit dyshon ne vërtitësin e këtij dokumenti - autorizimit, atëherë mund te veproj duke marr për baze nenin 39.8 të RRUOPP-se, Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, po citoj:

| Problemi | Si të veprohet? | Neni i LPP-së |
|---|---|---|
| Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar | Mund të kërkohen informata sqaruese | Neni 66 |

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3
Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK na eliminon ne këtë aktivitet te prokurimit lidhur me Verifikimin e standardit ISO 50001 2018
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| *6. Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , IS039001 2012,* | 6. Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , IS039001 2012, IS045001 2018 , *ISO 50001 2018 - kopje te noterizuara* |

ne Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.1 & 7.2 të FDT-së, si ne vijim:
Anëtari i GOE "Toni Ingjenjering" Sh.p.k. ka dorëzuar/ofruar certifikatën ISO 50001 : 2018 te lëshuar me date: 23.06.2022 nga AQRA Certifikatën doo, noterizuar nga noteri z. Halil Rrukiqi me LRP. Nr. 7273/2022, te datës 07.07.2022, andaj nëse AK - Komisioni i vlerësimit dyshon ne vërtitësin e saj, atëherë mund te veproj duke marr për baze nenin 72 dhe nenin 59 par. 2 të LPP-së, ose/apo nenit 52 par. 7 të LPP-së, sepse aty ne këtë certifikatë sqarohen mundësit e verifikimit si dhe përmes ëeb te dhënë ne këtë certifikatë ISO 50001 : 2018. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.
Përgjigje në Pretendimi nr. 4
Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se: Nuk e plotësohet ky kriter qe i njëjti ka bashkangjitur si inxhinier te elektroteknikes z. Besim Terziu. Me diplome universitare ne emër te Besim Terziqit, ndërsa ne kuadër te dokumentacionit (CV-se) ku verifikohet aspekti i përvojës se punës është paraqitur ne emër te Imri Besim Terziu-t.
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *3. Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes, apo bachelor minimumi 3 vite përvojë pune nga diplomimi ne udhëheqje e projektit ne teren. Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja dhe marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.* | *3.Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja , deshmit e përvojës ose marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit* |

ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si ne vijim:

Lideri i grupit te operatoreve ekonomik NNP "TONI" ka prezantuar menaxherin e projekt me vendim z. Nazif Nazifi, Inxh. i Dipl. i Elektroteknikes, si dhe inxh. e dip. te elektroteknikes z. Besim Terziu, ku ka ofruar Diplomën, CV Para-kontratën, te gjitha te noterizuar nga noteri z. Halil Rukiqi dhe ne te gjitha këto dokumente te vërtetuar nga noteri, kopje identike me origjinalin e diplomës, vërtetmi i nënshkrimit për kontratën dhe CV në të gjithë këto dokument te është numëri personal: 1012291244 dhe është emri: Besim Terziu, si dhe data e lindjes: 09.06.1972, qe do te thotë se

behet fjale për një person, mirëpo për çdo dyshim nga AK - Komisioni i vlerësimit ka mundur te veproj duke marr për baze nenin 72 dhe nenin 59 par. 2 të LPP-së, dhe te sigurohet se behet fjale për te njëjtin person apo ndryshon. Gjithashtu, Antari i grupit "Toni Ingjinjerin" Shpk ka prezantuar z. Afrim Fejza - inxh. dipl. te elektroteknikes, duke bashkangjitur diplomën, CV dhe para kontratën te notorizuar nga noeteri z. Halil Rrukiqi, duke ofruar tre (3) inxh. te dipl. te elektroteknikes. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigie në Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ne kundërshtim te plote me dispozitat ligjore te LPP, përkatësisht nenit 65 paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 te LPP-së, ka pranuar një deklarate nen betim nga OE "BM Group" Shpk pa titull te tenderit dhe pa numër te prokurimit, çka do te thotë se OE "BM Group" Shpk, është dashur te eliminohet qe ne fazën e përzgjedhjes. Sepse deklarata ne dosje te tenderit e ka titullin dhe numrin e prokurimit, por deklarata nen betim e dorëzuar nga "BM Group" Shpk nuk e ka.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka dorëzuar Deklaratën nen betim te nënshkruar dhe te vulosur, mirëpo përshkrimin ne Header dhe Footer, nuk janë ashtu siç ka përcaktuar AK ne dosje te tenderit (deklrates nen betim nga OE i rekomanduar për dhënie te kantatës i mungon), me poshtë po ju prezantoj te dyja si ne vijim:







Prandaj, duke marr për baze se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është ne diskrecion te AK - Komisionit te vlerësimit, i cili e ka mund te trajtoj sipas nenit 59 par. 4 pika (i) te LPP-se, po citoj: "përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne jjalë"", apo/ose sipas nenit 47.20 dhe 47.21 te RRUOPP-se. Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE "BM Group" Shpk mund te konstatohet se OE ne ijale ka ofruar katalog me specifika teknike, mungon deklarata e konfirmiteti nga kompania CREE për trupa ndriçues, për te cilin katalog nuk ka autorizim, kurse AK ka kërkuar Autorizim nga prodhuesi apo marrëveshje me prodhuesin, marrëveshja duhet te jete e nënshkruar dhe e vulosur nga prodhuesi ku mund te me përdor OE me konfirmim te prodhuesit, por OE "BM Group" Shpk i ka bere autorizim vetvete çka do te thotë se përveç se është e pa pranueshme është edhe ne kundërshtim me kërkesat e AK. I mungon raporti për specifika teknike për trupa ndriçues nga kompania prodhuese ne këtë rast "BM Group" Shpk ku deklaron se është prodhues, por ne te vërtetë nuk ekziston, prandaj veprimet e AK janë ne kundërshtim te plote me dispozitat ligjore për faktin se OE "BM Group" Shpk është dashur te eliminohet qe ne fazën e përzgjedhjes.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.1 & 7.2 të FDT-së, si ne vijim:

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| 4.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katallog ne përputhje me standartet Evropiane dhe kompatibil me ndriçuesin e ofruar , katalogu të dorëzohet ne dosje të Tenderit | 4.Autorizim nga prodhuesi për trupat ndriçues te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrëveshje me Prodhuesin marrëveshja duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Prodhuesi ku mundet me përdor OE me konfirmim te prodhuesit. |

OE i rekomanduar per dhënie te kontratës ("BM Group" Sh.p.k.) ka ngarkuar ne platformën elektronike dorëzuar/prezantuar Autorizim nga "BM Group" SHPK me NRB 810839251 te noterizuar nga noetri z. Zyfer Aliu me LRP.nr. 8937/2022, me date: 07.08.2022, mirëpo ashtu siç e dimë Republika e Kosovës nuk pjese e EU, kurse kërkesa e FDT-se ka qene qe autorizimi duhet jete nga prodhuesit e EU (Eurpian Union), gjithashtu ka prezantuar një katalog,

Prandaj, AK - komisioni i vlerësimit ka vepruar ne kundërshtim me nenin nenin 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si tëpërgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderif'. nenin 7 par. 2 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik". Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigie në Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Mungon Plani Dinamik, OE "BM Group" Shpk nuk e ka ofruar planin dinamik edhe pse plani ka qene i paraparë edhe ne dosje te tenderit, sepse ka qene kusht qe duhet plotësuar nga OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK gjate përgatitjes se dosjes se tenderit si dokument themelore për përgatitjen e tenderëve, plani dinamik nuk është përcaktuar tek kriteret e përzgjedhjes, por është përcaktor tek Pjesa II Përshkrimi i çmimeve - paramasa dhe parallogari, ku është kërkuar, po citoj: 'Plani dinamik përfshin 70 ditë PUNE (50 ditë pune për vitin 2022 dhe 20 ditë pune për vitin 2023 dhe 20 ditëpune)", dhe OE i rekomanduar për dhënie e ka nënshkruar dhe vulosur paramasen ku është pajtuar me planin dinamik te përcaktuar ne ditë punë (edhe pse nuk e ka ofruar një plan dinamik për këtë AP). Plani dinamik është kusht i implementimit te kontratës dhe secili operatore ekonomik është i obliguar ta respektoj afatet kohore për implementimin e kontratës. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Prctendimi nr. 8

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Mungon Licenca e Auditorit, kurse ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit ky ka qene kusht administrativ qe duhet te plotësohet, kurse OE "BM Group" Shpk nuk e ka ofruar këtë dëshmi, prandaj është dashur qe OE ne fjale te eliminohet ne fazën e përzgjedhjes.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit,

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *l.Pasqyrat fmanciare te auditura për tri vitet e fundit.* | *l.Kopjet e pasqyrave financiare te auditura për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit per pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit - (te* ***bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit)- PER LIDERIN*** |

bazuar ne ne Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2 të FDT-së, si ne vijim:

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk e ka prezantuar(ngarkuar ne platformën elektronike) se bashku me raportet e auditimi edhe kopjen e noterizuar te licencës se auditimit, ashtu siç është kërkuar ne tek kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiar ne dosje te tenderit, andaj AK - Komisioni i vlerësimit atëherë mund (ka qene i obliguar) te veproj duke marr për baze nenin 39.8 të RRUOPP-se, Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, po citoj:

| Problemi | Si të veprohet? | Neni i LPP- |
|---|---|---|
| Mungon licenca | Mund të kërkohen informata sqaruese | Neni 66 |

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr, 9

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, Mungon CV e inxhinierit Gëzim Karaxha, kurse CV dhe kontrata e inxhinierit Arben Mulaku, janë te pa notreizuara ne kundërshtim te plote me kërkesat e AK, te parapara ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, prandaj është dashur qe OE "BM Group" Shpk te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së,** si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
| --- | --- |
| *3. Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes, apo baçhelor minimumi 3 vite përvojë pune nga diplomimi ne udhëheqje e projektit ne teren . Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja dhe marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.* | *3.Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja , dëshmitë e përvojës ose marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit* |

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar z. Gezim Karaxha - Bach. i shkenc. te inxh. elektrike, duke bashkangjitur Diplomën te noterizuar, Kantatën me kohe te pacaktuar, mirëpo mungon CV-ja (nuk është bashkangjitur ne platformën elektronikë), gjithashtu ka prezantuar z. Arben Mulaku - Bach. i Shkenc. Te Inxh. elektrike, duke bashkangjitur, Diplomën te noterizuar, Kontratën me kohe te pacaktuar, si dhe CV-në. Bazuar ne kërkesën e përcaktuar ne FDT sikurse kam prezantuar me lart, kontrata dhe CV-ja nuk janë kërkuar te noterizuar, ndërsa marrëveshja nëse stafi profesional nuk janë ne marrëdhënie te punës se përhershme, është kërkuar te ceket titulli dhe te jete e noterizuar, kurse stafi i profesional ne fjale janë prezantuar kontrata me kohe te pacaktuar (qe do te thotë janë te punësuar me kontratë te pacaktuar). Kurse sa i përketë CV-ja e cila mungon për z. Gezim Karaxha, AK - komisioni i vlerësimit është ka mundur dhe ka qene i obliguar te veproj duke marr për baze nenin 39.8 të RRUOPP-se, Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, po citoj:

| Problemi | Si të veprohet? | Neni i LPP-së |
|---|---|---|
| CV-ja e kërkuar nuk është | Mund të kërkohen informata sqaruese | Neni 69 |

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 10

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Mungon deklarata për specifikacion teknik, është kërkesë e dosjes se tenderit dhe është dashur me patjetër te plotësohet. Prandaj OE "BM Group" Shpk është dashur te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, njedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK gjate përpilimit te dosjes se tender si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve, nuk është kërkuar lek kriteret e përzgjedhjes, si dhe Aneksi 1 te FDT-se, nuk ka pas ndonjë specifimim teknik qe OE do te duhej te plotësonte. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 11

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, nuk ka ofruar Skip-bager, mungon kamionta me kiper sipas Librezës se qarkullimit, sipas dosjes se tenderit, por ka ofruar me zinxhire, ne kundërshtim te plotë me kërkesat e AK, te paraqitura ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, prandaj është dashur qe OE BM Group" Shpk te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si ne vijim:

| Kërkesat: | **Evidencat:** |
|---|---|
| 6.Të paraqitën pajisjet raportet për mjetet - stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Pajisje te domosdoshme) Dy autokorpë për intervenim në lartësi të ndryshme, një Kamionë me kran, një Kamionet kiper pesha 2-4 ton, një Skip — bager | *6.Listën e mjetet-pajisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD - i doganor, ose kontrata mbi qiramarrjen e noterizuar, ose kontratë mbi shit-blerje ose faturëfLista duhet vërtetuar nga Operatori Ekonomik)* |

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar kamionet kiper me librezën e qarkullimit me tabela: 01-762-MT ne emër te OE "BM Group" SHPK , si dhe ka prezantuar një faturë te blerës me emërtim: Eskavator i perdorur JCB 3CX4 TL si dhe një faturë te blerjes me emërtim: Eskavator me zingjirë marka TIP R 914 HDSL, marr për baze natyrën e punëve dhe mundësin e kombinimit te pajisjeve, pajisjet e tilla këto pajisje janë ekuivalente dhe plotësojnë kërkesën e AK te përcaktuar ne dosje te tenderit. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 12

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, mungon deklarata për garancionin e trupave ndriçues për dy vite është kërkesë e dosjes se tenderit dhe është dashur me patjetër te plotësohet. Prandaj OE BM Group" Shpk është dashur te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK gjate përgatitjes se dosjes se tenderit si dokument themelore për përgatitjen e tenderëve, deklarata për garancionin e trupave ndriçues nuk është përcaktuar tek kriteret e përzgjedhjes, por është kushte administrative tek KVK dhe është kusht i implementimit te kontratës dhe secili operatore ekonomik është i obliguar ta respektoj periudhën garantuese te defekteve sipas afatet kohore për garancinë e ekzekutimit te punimeve. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr, 13

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE BM Group" Shpk sipas LPP-se nuk duhet te trajtohet fare i përgjegjshëm dhe nuk do te duhej fare te kalonte kriteret e përzgjedhjes, për vlerësim te çmimeve. Por te OE BM Group Shpk, kemi hasur ne çmime manipulative. Poz. 46 janë kërkuar 12000m' kurse çmimi i ofruar nga

OE ne fjale është 3€/m' kurse ne treg çmimi është rreth 1.40€/m' Poz. janë kërkuar 33OOOm' kurse çmimi i ofruar nga OE ne fjale është 3€/m' kurse ne treg është rreth 0.65 - 0.75€/m'

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, GOE ankues ka përmendur pozicionet ne paramas dhe parallogari duke pretenduar se janë çmime manipulative, por nuk ka ofruar asnjë prove apo dëshmi qe e mbështet këtë pretendim, prandaj është përgjegjësi dhe ne diskrecion te autoritetit kontraktues qe gjate procesit te vlerësimit te tenderëve te trajtoj dhe analizoj çmimin apo te konsiderohet si çmim jo normalisht I ulet apo çmimi jo I tregut ne pajtim me nenin 61 te LPP-se, ne mënyrë qe ta bëjë ekzaminimin, vlerësimin , dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave te kualifikimit te specifikuara ne njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh

kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK - komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 56, 59, 60, 72 të LPP-së, dhe nenin 39.8 te RRUOPP-së, andaj Eshtë përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.
Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e GOE akues të aprovohen të bazuar, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK(vendimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.
Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast GOE Ankues "Labinot M.Krasniqi B.I", "Toni Ingjinjering" sh.p.k dhe "Mirusha Company" Shpk-Gllogoc është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues përderisa AK nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datën: 30.09.2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedure, në vazhdim sqaron:

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e parë të GOE Ankues, se AK e eliminon ne këtë aktivitet te prokurimit lidhur me Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit si dhe çertifikatën e auditorit të cilën OE Ankues e ka paraqitur të vitit 2016. PSH konstaton se ky pretendim është i qëndrushëm për faktin se është kërkuar vetëm kopje e licencës të noterizuar dhe jo që ajo të jetë valide dhe e specifikuar me ndonjë vit përkatës.

Lidhur me pretendimin **e dytë** të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, se AK e ka elimiuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimet se: Grupi i operatoreve ekonomik nuk ka arritur te plotësoj këtë kriter pasi qe autorizimin nga prodhuesi nuk e ka te noterizuar nga origjinali (z njëjti nuk ka arritur te paraqes asnjë marrëveshje ne mes te Grupit te Operatoreve Ekonomik dhe Prodhuesit LEDEUROPA me seli ne Austri) sipas kërkesës se Autoriteti Kontraktues si dhe sa i përketë pretendimit **të gjashtë** të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, Paneli Shqyrtues konstaton se Kërkesa e parashtruar në Dosje të tenderit me nr.4 është në disproporcion me Dëshminë e kërkuar dokumentare, andaj për vendosje në këtë aktivitet e merr për bazë vetëm Kërkesën.

| | |
|---|---|
| 4.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katallog ne perputhje me standartet Evropjane dhe kompatibil me ndriquesin e ofruar , katalogu të dorzohet ne dosje të Tenderit | 4.Autorizim nga prodhuesi per trupat ndriques te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrveshje me Prodhuesin marrveshja duhet te jetë e nenshkruar dhe e vulosur nga Prodhusi ku mundet me perdor OE me konfirmim te prodhuesit. |

Fig.1 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pika 4.

Kështu që gjatë rivlerësimit të dëshmohet se produktet e ofertuara nga OE ofertues a janë sipas katallogut dhe sipas standardeve EU, përderisa mos të merrën për bazë të vlerësimit as autorizimi dhe as marrëveshja për asnjë Operator Ekonomik Tenderues.

Lidhur me pretendimin e tretë të operatorit ekonomik ankues, se AK e ka eliminuar ne këtë aktivitet te prokurimit lidhur me Verifikimin e standardit ISO 50001 2018, Paneli Shqyrtues konstaton se GOE ankues Toni Ingjenjering" Sh.p.k. ka dorëzuar /plotësuar certifikatën ISO 50001 : 2018 te lëshuar me date: 23.06.2022 nga AQRA Certifikatën doo, noterizuar nga Noteri z. Halil Rrukiqi me LRP. Nr. 7273/2022, te datës 07.07.2022 po ashtu edhe certifikatë ISO 50001 : 2018 GOE ankues e ka të dorëzuar.

Lidhur me pretendimin e katërt të operatorit ekonomik ankues, se AK i ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se nuk plotësohet kriteri i përcaktuar duke aluduar në mos përputhje të dokumentacionit në emër të inxhinierit te elektroteknikes z. Besim Terziu. PSH konstaton se lideri i grupit te operatoreve ekonomik NNP "TONI" ka prezantuar menaxherin e projekt me vendim z. Nazif Nazifi, Inxh. i Dipl. i Elektroteknikes, si dhe inxh. e dip. te elektroteknikes z. Besim Terziu, ku ka ofruar Diplomën, CV Para- kontratën, te gjitha te noterizuar nga noteri z. Halil Rukiqi dhe ne te gjitha këto dokumente te vërtetuar nga noteri, kopje identike me origjinalin e diplomës, vërtetmi i nënshkrimit për kontratën dhe CV në të gjithë këto dokument te është numëri personal: 1012291244 dhe është emri: Besim Terziu, si dhe data e lindjes: 09.06.1972, qe do te thotë se behet fjale për një person. Andaj pretendimi i ngritur nga GOE ankues është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e pestë të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, se ka pranuar një deklarate nen betim nga OE i rekomandurar per kontrate, pa titull te tenderit dhe pa numër te prokurimit, PSH sqaron se në ofertën OE të rekomanduar për kontratë është bashkangjitur deklaratën nën betim, siç është përcaktuar në dosjen e tenderit, me të dhëna si emri i OE, adresa e plotë, emri dhe pozita, nënshkrimi, data, e vulosur në emër të operatorit ekonomik, dhe përmbajnë te gjitha elementet e nevojshme. Mos plotësimi i shënimeve ne Header dhe Footer siç pretendon OE ankues nuk është pengesë që do ta bënte dokumentin/deklaratën jo valide. Andaj pretendimi i OE ankues është i paqëndrueshëm në ketë pikë.

Lidhur me pretendimin e shtatë të Operatorit Ekonomik ankues, se Mungon Plani Dinamik, nga OE i rekomanduar duke pretenduar se plani ka qene i paraparë edhe ne dosje te tenderit. PSH lidhur me këtë pretendim ia fal besimin përgjigjes së ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimin e tetë të operatorit ekonomik ankues, se Mungon Licenca e Auditorit, PSH konstaton se në ofertën e dorëzuar nga OE i rekomanduar mungon Licenda e Auditorit përderisa ka qenë kushtë administrativ që duhet të plotësohet nuk i është bashklidhur ofertës si dokument. Andaj PSH konstatkon se ky

pretendim është i qëndrueshëm dhe obligon AK që të veprojë në bazë të dispozitave ligjore nga neni 72 i LPP-së.

Lidhur me pretendimin e nëntë të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, se OE të rekomanduar i mungon CV e inxhinierit Gëzim Karaxha, kurse CV dhe kontrata e inxhinierit Arben Mulaku, janë te pa noterizuara, PSH merr për bazë përgjigjen e raportit shqyrtues të ekspertit.

Lidhur me pretendimin e dhjetë të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, se Operatorit Ekonomik të rekomanduar i Mungon deklarata për specifikacion teknik dhe si e tillë është kërkesë e dosjes se tenderit dhe është dashur me patjetër te plotësohet edhe për këtë pretendim PSH merr për bazë përgjigjen e raportit shqyrtues të ekspertit. Andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e njëmbëdhjetë të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, se OE i rekomanduar nuk ka ofruar Skip-bager,si dhe mungon kamionta me kiper sipas Librezës se qarkullimit, sipas dosjes se tenderit, por ka ofruar me zinxhire, ne kundërshtim te plotë me kërkesat e AK, te paraqitura ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, PSH konstaton se Operatori Ekonomik se ky pretendim është i qëndrueshëm . Andaj PSH konstaton se AK duhet të veproj komform dispozitave ligjore të nenit 72 dhe të shpjegoj në mënyrë decidive ekuivalencën.

Lidhur me pretendimin e dymbëdhjetë të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, mungon deklarata për garancionin e trupave ndriçues, PSH ia fal besimin sqarimit të dhënë në raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e trembëdhjetë të parashtruar nga operatori ekonomik ankues, se OE i rekomanduar ka ofruar çmime manipulative, konstaton se pretendimi i ngritur nga OE Ankues është i paqëndrueshëm për shkak se Operatori Ankues nuk ka ofruar fakte dhe argumente apo ndonjë dëshmi të cilën e mbështet këtë pretendim.

Andaj , bazuar në sqarimet e detajuara për secilin pretendim të ngritur nga Operatori Ankues PSH konstaton se anulohet Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim .
Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesuese e Panelit e Shqyrtues
Znj. Kimete Gashi

______________________

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.
Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – KK KAMENICË;
1x1 OE- "Global Holding" SH.P.K –Prishtinë;
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 356/22
Data/Datum. 08.09.2022
PRISHTINË - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| *Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues* | *Data e autorizimit të ekspertit:* **30.08.2022** | *Data e dorëzimittë raportit:* **08.09.2022** | *Nr. i lëndës:* **356/22** |
|---|---|---|---|

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **18.08.2022**, grupi OE ankues: **(Labinot M. Krasniqi B.I.) N.N.P."TONI" Sh.p.k.& "Toni Ingjinjering" Sh.p.k. & "Mirusha Company" Sh.p.k. – Gllogoc,** ka parashtruar ankesë me nr.: **356/22**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës)**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rregulllimi i infrastruktures trotuarit dhe ndriqimit publik ne Koumunen e Drenasit-proejkt dy vjeçar - Ritenderim"** me nr. të prokurimit: **611-22-5551-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna Gllogoc.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **356.646,00 €**
***Shënim:*** *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: N.N.P. "TONI" – Gllogoc

*(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

Pretendojmë se AK – Komuna e GLLOGOCIT, përmes vendimit për refuzimin e kërkesë për rishqyrtim ka bere shkelje te dispozitave te;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për prokurim Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (ne tekstin e mëtejmë do ti referohemi LPP-se) dhe atë;
- Neni 1, Qëllimi, pika 1 dhe 2
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, pika 1, 2 dhe 6
- Neni 7, Barazia ne trajtim/Jo-diskriminimi, pika 1
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave pika 1, par. 1.1 dhe 1.2
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika 1 dhe 4
- Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës pika 1, par. 1.1

II. Dispozitat e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te prokurimit publik (ne tekstin e mëtejmë do te i referohemi RRUOPP) dhe atë;
- Neni 41, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika 1; 5; 6; 11; 12

III. Ligji Nr. Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. (ne tekstin ne vijim do ti referohemi si LPKRA)
- Neni 5, Klasifikimi i ndërmarrjeve pika 2
- Neni 9, Raportimi i makro ndërmarrjeve

IV. Udhëzuesi 01/2020 për raportim financiar vjetore te mikro ndërmarrjeve.
- Klasifikimi klasa II.

**Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:**

E kundërshtojmë ne tërësi vendimin e AK, lidhur me vendimin për refuzimin e Kërkesës për ri-shqyrtim, dhe letrës standarde B42, për faktin se vendimi i AK për refuzimin e kërkesës, ka nje mal parregullsie, sepse është **qartësisht i pa bazuar.**

Ne vijim do te shkoqitim një nga një pretendimet e AK:

**E para:** AK na eliminon nga Aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se:

- Grupi i Operatoreve Ekonomik ka paraqitur pasqyra financiare ne kundërshtim me Nenin 17 Afatet kohore për dorëzim dhe publikim i pasqyrave financiare (ku specifikohet qarte: *1. Pasqyrat financiare te shoqërive tregtare qe auditohen ne pajtim me SNA-te dhe ne pajtim me nenin 7, paragrafi 1., dhe neni 8, paragrafi 1., te këtij ligji, dorëzohen dhe publikohen ne KKRF dhe një kopje dorëzohet ne ministrin përkatëse për trageti dhe industri, jo mevone se me 30 prill te vitit vijues. 2. Pasqyrat financiare te konsoliduar qe auditohen ne pajtim me SNA-te dhe ne pajtim me nenin 10 paragrafi1., te këtij ligji, dorëzohen ne KKRF jo me vone se data 30 Qershore te vitit vijues/* **te gjitha pasqyrat financiare lidhur me kompaninë liderë ne konsorcium janë paraqitur ne një kohë jashtë këtij afati, konkretisht me shume se 2 vite vonese)** te Ligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, ligji ky i publikuar ne Gazetën Zyrtare te Republikës se Kosovës / nr. 03/19 Prill 2018.

Po ashtu pas kontrolleve ne KKRF respektivisht ne linkun https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,103 me asnjë nga tre vitet e fundit kompania Lider ne këtë konsorcium nuk ka paraqitur raportet e auditimit.

Sqarim1. Lideri i konsorciumit, ka ngritur pyetje ne kohen kur e ka pasur hapësirën e për sqarime shtesë, ku lidhur me kriterin e pasqyrave financiare ka marr sqarimet e arsyeshme pse Autoriteti Kontraktues ka vendosur te paraqet këtë kriter (gjë qe jeni pajtuar dhe ju si OE), pasi qe nuk keni vazhduar me ankese ne OSHP dhe mbi kriteret e njëjta keni aplikuar, Pranoni sqarimet se njëra nga arsyet pse jeni shpallur si GOE i papërgjegjshëm është:

- **Rezultate:** Andaj sqarimet e paraqitura nga ana juaj mund te jene si argumente te mira ne shkallen e para hapjes se ofertave, mirëpo këtu nuk keni plotësuar kriterin e paraqitur ne DT, se Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit. **1.Kopjet e pasqyrave financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit - ( te bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit )- PER LIDERIN.** Sqarimet tjera te paraqitura nga ana e juaj si forme e shkeljeve janë te paraqitura ne Ligj, dhe si Autoritet Kontraktues nuk kemi mundësi ti ndryshojmë ligjet te cilat janë te votuara ne Kuvendin e Kosovës.

Faktet e rastit:
III.2.3) Kapaciteti ekonomi dhe financiar:
**Kërkesa: 1.***Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit .*
**Dëshmia: 1** *1.Kopjet e pasqyrave financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit - ( te bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit )- PER LIDERIN*

Pretendojmë se AK me vendimin e vet, ka bere shkelje te dispozitave te nenit 41, pika 2 te RRUOPP, **citojmë: Tenderuesi nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit ne baze te ndonjë kërkesë apo kriteri qe nuk është i specifikuar ne njoftimin e kontratës / dosje te tenderit.**

AK ne kundërshtim me këtë nen dhe përtej kërkesave te parapara ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, na eliminon me arsyetimin se PF te audituara nuk janë dorëzuar me kohe Këshillin Kosovar për Raportim, **arsyetim qartazi arbitrare.**
Nuk është detyre, e as kërkesë e AK se kur duhet te dorëzohen PF ne KKRF. Janë organet tjera te cilat mund te merren me afatin e dorëzimit te PF, nëse këto pasqyra ne kete forme janë dorëzuar jashtë afatit, por prap po e ri potencojmë se neve na obligon Ligji Nr. LIGJI Nr. 06/L-032 Për KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM, dhe





S.B

PF sipas ligjit ne fjale përgatiten dhe dorëzohen ne KKRF dhe ATK sipas klasifikimit dhe nën klasifikimit te ndërmarrjeve. PF te audituara janë dorëzuar ne AK, sipas kërkesave te AK dhe ne pajtim me kërkesat e **dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate,** (shih faktet e rastit) dhe mbi bazën e kësaj kërkese te AK, e cila ka qene kërkesë diskriminues ne i kemi përgatitur PF te Audituara, duke bashkangjitur edhe **kopjen e noterizuar Licencën e Auditorit.**

Vlen re ceket se **PF te AUDITUARA, paraqesin pamje te drejte dhe te vërtet, ky është OPINIONI I AUDITORIT**, prandaj ky është edhe qëllimi i ligjit ne fjalë.
Për me tepër AK, e ka te pa qarte se Ligji për Kontabilitet dhe raportim financiarë nuk na obligon neve qe te hartojmë pasqyra te AUDITUARA.
Kërkesa e AK te parapara ne njoftimi për kontrate dhe dosje te tenderit, për këtë pike ka qene ne kundërshtim te plote me LPKRFA, për faktin se vlera e parashikuar e punëve për këtë projekt ka qene 356,646.00 € dhe AK sipas LPP-se, nëse do te kërkonte qarkullimin ne tri vitet e fundit nuk e ka te drejte te kërkojë me shume se dyfishi i vlerës se planifikuar e qe ne këtë rast do te ishte 713,292.00 €, ku për çdo vit qarkullimi (për tri vite) do te duhej te ishte 237,764.00 € dhe bazuar ne kërkesat e LPKTFA, biznesi ne fjale klasifikohet si mikro dhe ndërmarrje kategoria II.
Neni 5, Klasifikimi i ndërmarrjeve pika 2, citojmë: *Mikro-ndermarrjet janë ndërmarrje te cilat nuk kalojnë kufijtë e se paku dy (2) nga kriteret e me poshtme:*
*2.1. pasqyra e pozitës financiare prej treqind e pesëdhjetë mije euro (350,000.00 €);*
*2.2. qarkullimi neto prej shtate qind mije euro (700,000.00 €); dhe*
*2.3. numri mesatare i te punësuarave gjate vitit financiar: dhjete (10).*

Po ashtu, bazuar edhe ne Udhëzuesin 01/2020 për raportimet financiare vjetore te mikro ndërmarrjeve, si dhe bazuar ne planifikimin e buxhetit te AK, biznesi edhe m etej **nen-klasifikohet:**

1) **Mikro ndërmarrjet e klasës II, qarkullimi (50,000.00 – 300,000.00)**

Sipas këtij klasifikimi te bazuar ne LIGJI Nr. 06/L-032 për KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM, biznesi ne fjale obligohen te përgatisin **vetëm:**

- *I. Pasqyrën e pozitës financiare*
- *II. Pasqyrën e te ardhurave*
- *III. Pasqyrave financiare ti bashkëngjiten edhe deklaratën e pajtueshmërisë.*

**Citojmë:***Pasqyrat financiare duhet te nënshkruhen nga (i) drejtori ekzekutiv dhe nga ii) drejtori financiare ose kontabilisti i certifikuar,* çka do te thotë se Ligji ne fjalë nuk e obligon OE qe pasqyrat te jene te nënshkruara nga kontabilisti i certifikuar e lere më të rishkruara apo edhe te AUDITUARA.
**Kërkesë qartazi Arbitrare e AK!**

Duke u bazuar ne kërkesat Ligjore te LPRFK dhe duke u bazuar ne piken 1; 2 dhe 6 te nenit 7 te LPP-se, qartazi mund te konstatohet se kriteri i vendosur nga AK ka qene ne kundërshtim edhe me dispozitat e cekura me larte, prandaj ne me te drejt dhe ne pajtim me kërkesat Ligjore, kemi kërkuar sqarime shtesë qe kërkesa ne fjale te largohet nga dosja e tenderit. **Prove: sqarimi shtese i datës 17.06.2022.**
AK nuk e ka larguar këtë kriter dhe ne, është dashur qe patjetër te bëjmë auditimin e PF te AUDITUARA, vetëm sipas kërkesave te AK, e qe DOREZIMI I PF TE AUDITUARA ne AK-KK Gllogoc, është ne tërësi sipas kërkesave te AK, për me tepër e qe vlen te ceket, sepse është me rendësi qe PF te AUDITUARA, dhe pa u mbështetur ne kërkesat Ligjore kane kosto jashtëzakonisht shume, por kërkesa ka qene kriter i përzgjedhjes dhe me patjetër qe kemi qene te obliguar te përgatisim PF nga një kompani e AUDITIMT, vetëm për AK dhe vetëm e vetëm qe te jemi te kompletuar gjate dorëzimit te dosjes se tenderit. Nuk kemi kërkuar nga AK KK Gllogoc qe te beje ndryshime ne LKPKRF, por po kërkojmë qe te interpretohet drejte. Ne rastin konkret interpretimi i Ligjit ne fjale nga AK është tërësisht i gabuar.
Prandaj, vendimi i AK është qartazi i pa bazuar, është arbitrar dhe është përtej kërkesave te RUOPP përkatësisht nenit 41.2. Dhe si i tille është i pa pranueshëm dhe ne kundërshtim ne tërësi me argumentet e cekura me larte te cilat janë qartësisht te bazuara ne dispozita ligjore, sepse ne i kemi dorëzuar te kompletuara PF te AUDUTUARA ne AK ne pajtim te plote me kërkesat e NJK deh DT.

**E dyta:** AK na eliminon nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimet se: Grupi i operatoreve ekonomik nuk ka arritur t eplotesoj kete kriter pasi qe autorizimin nga prodhuesi nuk e ka te noterizuar nga origjinali (*i njëjti nuk ka arritur te paraqes asnjë marrveshje ne mes te Grupit te Operatoreve Ekonomik dhe Prodhuesit LEDEUROPA me seli ne Austri*) sipas kërkesës se Autoriteti Kontraktues. I njëjti ka paraqitur nje autorizim per shitje dhe ofrim mirëpo jo per projektin





S.B

lidhur me Rregullimi i infrastrukturës trotuarit dhe ndriqimit publik ne Komun e Drenasit – projekt dy vjeçar – Ritenderim me numër te prokurimit: 611-22-5551-5-2-1 dhe 611-22-048-5-2-1. **Lidhur me kete kriter edhe vet operatori ekonomik e ka pranuar se nuk eshte i noterizuar pasi qe ka paraqitur nje deklarat nen betim**

**Arsyetimi ne vendimin për refuzimin e kërkesë për Ri-shqyrtim:**

- **Rezultat:** Autorizimi thekson qarte se është një autorizim për shitje dhe ofrim.
- **Rezultate:** Ne këtë Autorizim paraqitet një deklaratë nga Lideri i Grupit ku edhe vet e paraqet qe është i panoterizuar.

**Sqarimi 3.** Autoriteti Kontraktues, Komuna Gllogoc qëndron prapa Njoftimit mbi vendimin e AK edhe ne argumentet tjera lidhur me kriterin 6, se grupi i operatoreve ekonomik Labinot M. Krasniqi; Toni Ingjinjering; Mirusha Company Shpk Kosova Gllogc, Negroc, 13050, Negrovc, nuk e plotëson: 6. Certifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015, ISO 39001 2012, ISO 45001 2018, ISO 50001 2018 dhe dëshmitë për këtë kriter është kërkuar: 6. Certifikata për sistemin e menaxhimit te kualitetit ISO 9001 2015, ISO 39001 2012, ISO 45001 2018, ISO 50001 2018 – kopje te noterizuara.

**Faktet e rastit:**
**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**
**Kërkesa:** 4. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katallog ne përputhje me standardet Evropiane dhe kompatibil me ndriçuesin e ofruar , katalogu të dorëzohet ne dosje të Tenderit
**Dëshmia:** 4. Autorizim nga prodhuesi për trupat ndriçues te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrëveshje me Prodhuesin marrëveshja duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Prodhuesi ku mundet me përdor OE me konfirmim te prodhuesit.

Pretendojmë se AK me vendimin e vet, ka bere shkelje te dispozitave te nenit 41, pika 2 te RRUOPP, **citojmë:***Tenderuesi nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit ne baze te ndonjë kërkesë apo kriteri qe nuk është specifikuar ne njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.*
AK ne kundërshtim me këtë nen dhe përtej kërkesave te paraqitura ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit, na eliminon me arsyetimin se autorizimi nuk është i definuar për projektin me titull dhe numër te tenderit dhe nuk është i noterizuar.

Nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate një kërkesë e tillë, prandaj vendimi është i pa bazuar, tendencioz i pa drejte dhe ne kundërshtim te plote me dispozitat e nenit 41 pika 2 e RRUOPP.
Për me tepër edhe qe duhet te ju behet me dije AK, se dëshmitë dokumentare e kërkesës ne fjale ka qene APO, qe do te thotë se marrëveshja me prodhuesin është nënshkruar, vulosur nga prodhuesi dhe ku mund te përdorë OE me konfirmim nga Prodhuesi. Prandaj nuk ka qene obligative qe te jete e noterizuar Autorizimi, për faktin se vet AK ka kërkuar **APO,** nëse do te ishte **DHE/EDHE**, atëherë ne ishim pajtuar me këtë konstatim dhe si te tille nuk do te merreshim fare me procedura te ankimimit. Por jemi ne te drejtën tonë dhe procedurat e ndjekjes se kësaj te drejte do ti shfrytëzojmë ne çdo shkalle te ankimimit.
Për me tepër Autorizimi i dhënë për kompaninë tonë duke përfshirë edhe katalogun nga prodhuesi LEDEUROPA, me seli ne Austri, është ne pajtueshmëri te plote me kërkesat e AK, sepse është konfirmuar dhe ri konfirmuar ngase i vetmi OE i autorizuar për Kosovës nga Kompania LEDEUROPA, është vetëm Labinot M. Krasniqi B.I. – NNP "TONI" Drenas. Prandaj e kundërshtojmë ne tërësi këtë pretendim te AK, sepse është qartësisht i pa bazuar, i pa mbështetur ne dispozita ligjore, diskriminues, i pa drejt dhe arbitrarë.

**E treta:** AK na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se:

Janë verifikuar te gjitha ISO standardet e paraqitura (ku Certifikatat ISO 9001 2015, ISO 39001 2012, dhe ISO 45001 2018, janë verifikuar dhe janë ne përputhje me kërkesën dhe afatet kohore te validitetit), ndërsa dokumenti ISO 50001 2018 dokument ky i lëshuar nga AQRA Certification doo me seli ne Beograd, si autoritet e kemi pasur te pamundur verifikimin e rregullt sic behet m ete gjitha ISO-te tjera, i vetmi verifikim i këtij dokumenti është përmes një e-maili te paraqitur ne web-faqen www.aqracertifvation.rs . Po ju njoftojmë se si autoritet përmes kontrollit te ISO standardeve ne web-faqen www.verifviso.com, me numër e Certifikatës SR.80.074 te datës 23.06.2022 nuk ka asnjë certifikatë valide dhe as ne emrin e kompanisë tuaj (AK për ISO standardet tjera te verifikuara nuk e ka përdorur këtë platforme te verifikimit)



S.B

**Arsyetimi ne vendimin për refuzimin e kërkesë për ri-shqyrtim:**

- GOE nuk ka arritur te plotësoj kriterin e verifikimit te ISO Standard 50001 – 2018, sa qe as ne sqarimet dhe kërkesën për rishqyrtim nuk paraqet as një detaj te verifikimit, si autoritet kontraktues e kemi pasur te pamundur verifikimin e një ISO standardi ne Beograd (si autoritet ju kemi njoftuar) se te gjitha ISO standardet tjera janë verifikuar.
  - **Rezultate:** GOE ne kërkesën për rishqyrtim, nuk jep asnjë detaj mbi verifikimin e ISO 50001 2018, sa qe ne komentet e tije se mund te identifikohet ISO 9001 – 2015 dhe jo ai i cili është hedhur poshtë nga autoriteti. Pra, as edhe ne kërkesën për rishqyrtim GOE nuk jep asnjë dokument qe fakton verifikimin e këtij dokumenti.

**Faktet e rastit:**

**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**

**Kërkesa** 6.Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , ISO39001 2012, ISO45001 2018 , ISO 50001 2018

**Dëshmia** 6.Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , ISO39001 2012, ISO45001 2018 , ISO 50001 2018 - kopje te noterizuara

Pretendojmë se AK është i pa drejt për faktin se Dokumenti ne fjale ISO 50001 – 2018, është kopje e noterizuar nga origjinali ka vlefshmëri dhe është ne pajtim te plote me kërkesat e AK. AK është ne kundërshtim te plote me LPP-ne, nenin 7 pika 1, citojmë: *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo – diskriminuese dhe do te veproj ne mënyrë transparente.* AK ne rastin konkret, edhe pse nuk ka mundur te verifikoj një dokument te tille e qe kjo është si pasoje e jo profesionalizimit te tyre, te paktën kane edhe një e-mail si alibi qe dokumenti ISO 9001 2015, është ne emër te kompanisë, ka validitet dhe është ne pajtueshmëri me kërkesat e parapara ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate, prandaj edhe oferta jone duhet te trajtohet ne mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese. Prandaj edhe kundërshtojmë ne tërësi këtë pretendim te AK, sepse është qartësisht i pa bazuar i pa mbështetur ne dispozita ligjore, i pa drejt dhe arbitrare dhe përtej kërkesave te parapara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit.

**E katërta:** AK na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se:
Nuk e plotësohet ky kriter qe i njëjti ka bashkangjitur si inxhiner te elektroteknikes z. Besim Terziu. Me diplome universitare ne emër te Besim Terziqit, ndërsa ne kuadër te dokumentacionit (CV-se) ku verifikohet aspekti i përvojës se punës është paraqitur ne emër te Imri Besim Terziu-t.

**Arsyetimi ne vendimin për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim:**

- GOE edhe ne sqarimet shtese te paraqitura ne kërkesën për rishqyrtim, nuk jep asnjë detaj lidhur me komentet e autoritetit kontraktues për problemet lidhur me nuk plotësohet ky kriter pasi qe i njëjti ka bashkangjitur si inxhinier te elektroteknikes z. Besim Terziu. Me diplomë universitare ne emër te besim Terziqit, ndërsa ne kuadër te dokumentacionit (CV-se) ku verifikohet aspekti i përvojës se punës është paraqitur ne emër te Imri Terziu-t.
  - Rezultate: Autoriteti kontraktues Komuna e Gllogocit (Drenasit) nuk është autoritet i cili bene verifikimin e dokumentacioneve te paraqitura nga ana e kompanive ofertuese, për faktin se OE ofertues duhet te kenë njohuri bazike mbi këto sqarime, nëse një person e ka ndryshuar Mbiemrin nuk është një ndryshim i lehët, e i cili do te duhej te argumentohej ne aspektin e plotësimit te dokumentacionit bazë.

**Faktet e rastit:**

**III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**Kërkesa:** 3.*Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes, apo bachelor minimumi 3 vite përvojë pune nga diplomimi ne udhëheqje e projektit ne teren . Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja dhe marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.*

**Dëshmie** 3.*Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja , dëshmitë e përvojës ose marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.*

Pretendojmë se AK është i pa drejt sa i përket trajtimit te dokumenteve te inxhinierit Besim Terziu apo Terziqit, sepse është i njëjti person dhe kjo është lehët e verifikushme ne çdo forme, për faktin se është banor i Republikës se Kosovës, ka numrin identifikues dhe ka kronologji se si ka ndryshuar mbiemrin nga Terziqi ne Terziu. Kjo është detyre dhe obligim ligjore i AK qe ne përputhje me nenin 72 te LPP-se te kërkoj informata sqaruese ne rastet kur ka paqartësi, prandaj ky veprim i AK përbën shkelje te nenit 72 te LPP-së.





S.B

Për me tepër është e pa pranueshme dhe ne kundërshtim me dispozitat e nenin 41 pika 2 te RRUOPP, citojmë: *Tenderuesi nuk do te diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit ne baze te ndonjë kërkesë apo kriteri qe nuk është specifikuar ne njoftimin për kontrate / dosje tenderit.*
Sepse AK ne njoftimin per kontrate dhe dosje te tenderit ka kërkuar minimum dy (2) inxhinier te elektros, kurse ne kemi ofruar tre (3), ku inxh. i trete i elektros është ne listën e stafit punues te Toni Inxhinjering shpk qe është ne konsorcium , ka kontratën ne emër te projektit ka diplomën, CV-in dhe te gjitha te noterizuar nga vet inxhinieri, d.m.th. për këtë pike ne kemi ofrua përtej kërkesave te AK. Dhe te gjithë inxhinieret pa përjashtim janë te kompletuar sipas kërkesave te AK me diplomë, kontrate, CV apo marrëveshje te gjitha te noterizuara dhe me titull te tenderit. Prandaj edhe kundërshtojmë ne tërësi këtë pretendim te AK, sepse është qartësisht i pa bazuar, i pa mbështetur ne dispozita ligjore, i pa drejt dhe arbitrarë.
Dhe si përfundim sa i përket B42, Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, vijmë ne përfundim se AK pa drejtësisht na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit, pa drejte me dashje me vetëdije te plote, ka një qellim te caktuar dhe si rjedhoje dhe për përfitime personale apo ne favore te një pale tjetër e qe nga veprimet e tij dëmton rend buxhetin e varfër te KK Gllogoc, sepse e shpërblen OE "BM Group" Shpk, i cili është operator i papërgjegjshëm dhe i cili ka dukshëm çmimin më të lartë se ne.

**Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: B58 – Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 05.08.2022. Ne vijim do te shkoqitim një nga një pretendimet tona sa i përket vendimit te AK dhe refuzimit te kërkesës për ri-shqyrtim:**

E kundërshtojmë ne tërësi vendimin e AK, lidhur me letrën standarde B58, për faktin se vendimi i AK për dhënie te kontratës është i pa drejt dhe ne kundërshtim te plote me LPP-ne dhe dokumentacionin dytësorë te KRPP-se. Me date 08.09.2022, kemi kërkuar qasje ne dokumente te tenderuesit te propozuar për kontratë dhe pas pranimit te këtyre dokumenteve dhe analizimit te tyre kemi konstatuar se AK me vetëdije te plote shpërblen me kontrate OE "BM Group" Shpk i cili është **i pa përgjegjshëm** ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se, nenit 60 pika 1.1, **citojmë:***Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik qe ka dorëzuar*, **par. 1.1. citojmë**: *tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ulet.*
Pas analizimit te dokumentacionit te kompanisë se propozuar për dhënie te kontratës, kemi hasur shume parregullsi dhe dokumentacionin ne kundërshtim te plote me kërkesat e AK te parapara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit. Dhe si rrjedhoje ne konsiderojmë shkelje te LPP-se nenit 1 Qëllimin, pika 2 citojmë: 2. *Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*
Ne vijim do ti shoshitim te gjitha argumentet dhe provat bindëse, për secilin konstatim faktik te dosjes se OE "BM Group" Shpk te shpërblyer me kontrate.

**E para: E gjetura**
**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**
**Kërkesa:** Kon formë Ligjit mbi Prokurim Publik Ligjit Nr. 04/L-042 për prokurim publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht nenit 65 pika 1, 2, 3, 4, 4.9 dhe 5.
**Dëshmia:** Deklarata nen betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.... siç është e cekur ne Pjesën, do te dorëzohet ne forme te Aneksit te gjithë pjesëmarrësit – origjinal

AK ne kundërshtim te plote me dispozitat ligjore te LPP, përkatësisht nenit 65 paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 te LPP-së, ka pranuar një **deklarate nen betim** nga OE "BM Group" Shpk **pa titull te tenderit dhe pa numër te prokurimit**, çka do te thotë se OE "BM Group" Shpk, është dashur **te eliminohet qe ne fazën e përzgjedhjes**. Sepse deklarata ne dosje te tenderit e ka titullin dhe numrin e prokurimit, por deklarata nen betim e dorëzuar nga "BM Group" Shpk nuk e ka. Prandaj komisioni i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit me këtë veprim ka bere shkelje serioze te LPP-se, 1 Qëllimin e LPP-së, pika 1 dhe 2 te LPP-se, sepse nga ky veprim i OE nuk dihet se për cilin aktivitet te prokurimit ka nënshkruar një deklaratë nen betim.





S.B

**Arsyetimi i AK sa i përket te gjeturës tonë.**
**Pretendimi 1.**
**Paraqitur për:**Deklaratën ne betim

- **Sqarimi:** Deklarata nen betim është e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania ofertuese me datën dhe kohen kur ka aplikuar ne procedurën: **Rregullimi i infrastrukturës trotuarit dhe ndriçimit publik neKomunën e Drenasit – projekt dy vjeçare – Ritender, me numër te prokurimit: 611-22-5551-5-2-1.**

**Pretendimi: I bazuar**
Nuk është e vërtetë se Deklarata nën betim e nënshkruar nga OE "BM Group" Shpkështë metitull dhe numër te tenderit, për me tepër nuk është e vërtet qe edhe data ne deklaratës nën betim figuron me datën e hapjes, sepse ne deklarate ne betim data është me 08.07.2022, kurse hapja është me 13.07.2022 **(provëdeklarata ne betim).** Prandaj Vendimi i AKështë ne kundërshtime dispozitat e LPP-se përkatësisht nenit 65 paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3.

**E dyta: E gjetura**
**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**
**Kërkesa:** 4. *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog ne përputhje me standardet Evropiane dhe kompatibil me ndriçuesin e ofruar , katalogu të dorëzohet ne dosje të Tenderit*
**Dëshmia:** 4. *Autorizim nga prodhuesi për trupat ndriçues te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrëveshje me Prodhuesin marrëveshja duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Prodhuesi ku mundet me përdor OE me konfirmim te prodhuesit.*

AK ne kundërshtim te plotë me dispozitat ligjore te LPP, përkatësisht nenit 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrëseve dhe Dhënien e Kontratave, pika 1 par. 1.1. citojmë: *së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.*
Nga dëshmitë dokumentare te ofruara nga OE "BM Group" Shpk mund te konstatohet se OE ne fjale ka ofruar katalog me specifika teknike, mungon deklarata e konfirmiteti nga kompania CREE për trupa ndriçues, për te cilin katalog **nuk ka autorizim**, kurse AK ka kërkuar Autorizim nga prodhuesi apo marrëveshje me prodhuesin, marrëveshja duhet te jete e nënshkruar dhe e vulosur nga prodhuesi ku mund te me përdor OE me konfirmim te prodhuesit, por OE "BM Group" Shpk i ka bere autorizim vetvete çka do te thotë se përveç se është e pa pranueshme është edhe ne kundërshtim me kërkesat e AK. I mungon raporti për specifika teknike për trupa ndriçues nga kompania prodhuese ne këtë rast "BM Group" Shpk ku deklaron se është prodhues, por ne te **vërtetë nuk ekziston**, prandaj veprimet e AK janë ne kundërshtim te plote me dispozitat ligjore për faktin se OE "BM Group" Shpk është dashur te eliminohet qe ne **fazën e përzgjedhjes**.

**Arsyetimi i AK s ai perket te gjetures tone.**

- **Sqarimi: Mbeshtetur ne dokumentacionin e paraqitur nga kompania BM Group Shpk dhe kontrollat ne dokumentacionin e ARBK-se, shihet qarte se i njejti ka te drejten e prodhimit (pranoni sqarimet):**

| | | |
|---|---|---|
| 2711 | Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve | Tjera |
| 2712 | Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike | Tjera |
| 2720 | Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve | Tjera |
| 2731 | Prodhimi i kabllove të fibrave optike | Tjera |
| 2732 | Prodhimi i telave dhe kabllove të tjera elektrike dhe elektronike | Tjera |
| 2733 | Prodhimi i pajisjeve elektroinstaluese | Tjera |
| 2740 | Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit | Tjera |
| 2751 | Prodhimi I pajisjeve elektrike shtepiake | Tjera |
| 2752 | Prodhimi i pajisjeve joelektrike shtëpiake | Tjera |
| 2790 | Prodhimi i pajisjeve te tjera elektrike | Tjera |
| 2931 | Prodhimi i pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet motorike (të transportit) | Tjera |





S.B

Nga arsyetimi i AK, mund te konstatohet se AK, është tërësisht ne kundërshtim me kërkesat e parapara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit, sepse ka kërkuar autorizim nga prodhuesi, kurse ne këtë vendim ofron një liste te aktiviteteve te biznesit te cilat janë veprimtari te regjistruara ne Agresionin për regjistrimin te bizneseve dhe asgjë nuk ka te beje me autorizimin e kërkuar. Për me tepër AK me vendimin për refuzimin te kërkesës për rishqyrtim lehtësisht mund te konstatohet se AK e luan rolin e avokatit te kompanisë "BM Group" Shpk, për faktin se neve pa drejtësisht për shkak te autorizimit ne eliminon edhe pse ne jemi 100% ne pajtueshmëri me kërkesat e AK, kurse ne anën tjetër ne kundërshtim te plotë me dispozitat e LPP-se, neni 7, pika 1 citojmë: *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.* Arsyetohet me dëshmi nga web faqja e ARBK-se, qe ne mënyrë absolute nuk ka te beje me kërkesat e AK, te parapara ne NJK dhe DT. Prandaj AK ne rastin konkret përdorë standarde te dyfishta dhe atë brenda te njëjtës procedure, prandaj vendimi i AK është i pranueshëm, i pa drejt dhe ne kundërshtim me dispozitat ligjore te cekura më lartë.

**E treta: E gjetura**
**Mungon Plani Dinamik**, OE BM Group Shpk nuk e ka ofruar planin dinamik edhe pse plani ka qene i paraparë edhe ne dosje te tenderit, sepse ka qene kusht qe duhet plotësuar nga OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet.
**Arsyetimi i AK sa i përket te gjeturës tonë.**
**Paraqitur për:** Planin dinamik

- **Sqarimi:** ***Asnjë nga kriteret e përzgjedhjes dhe përcaktimit nuk e paraqet se plani dinamik është kriter qe përcaktohet apo zgjedhe një operatore ekonomik. E veçanta e Planit Dinamik është te paraqitet para nënshkrimit te kontratës (dhe dihet se ky projekt është dy vjeçare) dhe se paramas është e atille saqë plani dinamik është realizim brenda planit dinamik. Plani dinamik dhe dinamika e punëve përcaktohet ne bazë kërkesave dhe menaxherit te kontratës.***

Edhe pse plani dinamik dhe dinamika e punëve është me rendësi te përcaktohet nga OE, por një dokument i nënshkruar dhe vulosur te lista e çmimeve nga "BM Group" Shpk mund te pranohet si dokument, prandaj mendojmë se një pretendim i tille ne kërkesën për ri-shqyrtim nuk ka qene kriter i përzgjedhjes dhe ne këtë faze te ankese një pretendim te tillë e eliminojmë dhe ne këtë rast e pranojmë arsyetimin e AK.

**E katërta: E gjetur**
**Mungon Licenca e Auditorit,** kurse ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit ky ka qene kusht administrativ qe duhet te plotësohet, kurse OE "BM Group" Shpk nuk e ka ofruar këtë dëshmi, prandaj është dashur qe OE ne fjale te eliminohet ne fazën e përzgjedhjes.
**Arsyetimi i AK sa i përket te gjeturës tonë.**
**Paraqitur për: Licencën e Auditorit**

- **Sqarimi:** ***Ky dokumentacion është lehtë i verifikuar, pasi qe kompania ne fjale i ka te paraqitura edhe dokumentacionet e saj ne KKRF dhe si te tilla ka edhe një licence te kompanisë ku janë kryer auditimet e pasqyrave financiare.***

**Pretendimi: I pabazuar**
AK ne kundërshtim te plotë me dispozitat LPP-se, neni 7 pika 1 citojmë: *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.* AK arsyetohet me faktin se dokumentacioni i kompanisë se Auditimit është i verifikushem ne KKRF sa i përket Licencës. Këtë verifikim te licencimit te auditoreve dhe Kontabilisteve te licencuar e dimë te gjithë se ku dhe si mund te verifikohet, por kërkesa ka qene: (te bashkëngjitet **kopje e noterizuar e Licencës se Auditimit**) – PER LIDERIN, (prove: PF te audituara nga BM Group" Shpk), prandaj nga veprimet e AK me te drejt mund te konstatohet se AK përdorë standarde te dyfishta ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se, përkatësisht nenit 7 për shkak te trajtimit te pa barabartë dhe si te tille e kundërshtojmë ne tërësi arsyetimin e AK, sepse qartësisht është i pa bazuar.

**E pesta: E gjetura**
**Mungon CV e inxhinierit Gëzim Karaxha, kurse CV dhe kontrata e inxhinierit Arben Mulaku,** janë te pa notreizuara ne kundërshtim te plote me kërkesat e AK, te parapara ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, prandaj është dashur qe OE "BM Group" Shpk te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.
**Arsyetimi i AK s ai përket te gjeturës tonë.**
**Paraqitur për: CV e Inxhiniereve dhe Kontrata**

- **Sqarimi:** Te gjitha kontratat dhe CV e stafit te kërkuar janë konforme dokumentacionit te kërkuar nga ana e AK





S.B

**Pretendimi: I pabazuar**
Nuk është e vërtet se CV e **inxhinierit Gezim Karaxha, kurse CV dhe kontrata e Inxhinierit Arben Mulaku**, janë te noterizuara (provë CV dhe Kontrata). Nuk është e vërtet qe janë ne pajtueshmëri me dokumentacionin e kërkuar nga AK, sepse AK ne njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit ka kërkuar si dëshmi dokumentare: **Kontrata ose marrëveshja paraprake e noterizuar për angazhimin e tije (me titull te projektit) ne këtë projekt, Diplomat e noterizuara dhe CV-ja kopje**, çka do te thotë se kjo ka qene kërkesë e përzgjedhjes, ku vet AK ka kërkuar një dokument te tille. Prandaj arsyetimi i AK është qartësisht i pa drejt dhe ne kundërshtim me vet kërkesat e parapara nga AK ne NJK dhe DT.

**E gjashta: E gjetura**
Mungon deklarata për specifikacion teknik, është kërkesë e dosjes se tenderit dhe është dashur me patjetër te plotësohet. Prandaj OE BM Group" Shpk është dashur te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.
**Arsyetimi i AK sa i përket te gjeturës tonë.**
**Paraqitur për: Deklaratën e Specifikimeve Teknike**

- **Sqarimi: Asnjë nga kriteret e përzgjedhjes dhe përcaktimit nuk e paraqet se Deklarata e Specifikimeve teknike (kjo rregullohet ne Aneksin 1, te formularët standard), por qe nuk është kriter qe përcakton apo përzgjedhë një operatore ekonomik.**

**Pretendimi: I pabazuar.**
Deklarata për specifikime teknike është edhe elementi kryesore ne dosjen te tenderit, sepse është kërkesë e LPP-se, përkatësisht neni 28 te Ligjit, prandaj një deklarate e tille duhet me patjetër qe te nënshkruhet nga OE, për faktin se kjo është kërkesë e Ligjit, prandaj arsyetimi i AK është qartësisht i pa bazuar.

**E shtata: E gjetura**
Nuk ka ofruar **Skip-bager** sipas dosjes se tenderit, por ka ofruar me zinxhirë, ne kundërshtim te plotë me kërkesat e AK, te paraqitura ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, prandaj është dashur qe OE BM Group" Shpk te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

**E teta: E gjetura**
**Mungon kamionta me kiper sipas Librezës se qarkullimit,** OE "BM Group" Shpk, diçka tjetër ka ofruar ne foto sa i përket kamionetës, kurse ne libreze te qarkullimit figuron kamionët dubell kabine ne kundërshtim te plotë me kërkesat e AK, prandaj është dashur qe OE BM Group" Shpk te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.
**Arsyetimi i AK sa i përket te gjeturës tonë.**
**Pretendimi 7 dhe 8.**
**Paraqitur për: Pajisjet SKIP dhe Kiper**

- **Sqarimi: Te gjitha pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktues janë ne përputhje me pajisjet e paraqitura nga operatori ekonomik BM Group shpk, SKIP-i është ekuivalent me ekskavatorin me zingjirë (por qe kompania ne dokumentacionin e përgjithshëm ka edhe ekskavatorë te tjerë plotësues e ekuivalent). Ndërsa lidhur me Kiper është i njëjti me atë se çfarë është ofruar ne foto dhe ne librezë.**

**Pretendimi: I pabazuar**
Nuk është i vërtetë arsyetimi i AK, sepse ne NJK dhe DT ka kërkuar: *Të paraqitën pajisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Pajisje te domosdoshme) Dy autokorpë për intervenim në lartësi të ndryshme, një Kamionë me kran , një Kamionët kiper pesha 2-4 ton, një Skip – bager. Prandaj AK ka tejkaluar kompetencat e veta, për faktin se ne kërkesat NJK dhe DT* nuk e ka paraparë **ekuivalent**, por kërkesa ka qene saktësisht e specifikuar, prandaj me te drejt kemi konstatuar nga dëshmitë dokumentare se OE "BM Group" Shpk, nuk i posedon këto pajisje dhe si i tille është ne kundërshtim te plote me kërkesat e AK dhe kriteret e përzgjedhjes.

**E nënta: E gjetura**
**Mungon deklarata për gradacionin e trupave ndriçues për dy vite** është kërkesë e dosjes se tenderit dhe është dashur me patjetër te plotësohet. Prandaj OE BM Group" Shpk është dashur te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.
**Arsyetimi i AK sa i përket te gjeturës tonë. Pretendimi 9. Paraqitur për:** Deklaratën e garancisë te trupave ndriçues Sqarime: Asnjë nga kriteret e përzgjedhjes dhe përcaktimit nuk e paraqet deklaratën e garancionit te trupave ndriçuese është kriter qe përcaktohet apo zgjedhe një operatore ekonomi. Ju aludoni ne atë se çfarë është paraqitur ne kushtet e veçanta ne dosje te tenderit, vet fakti se ky dokument nuk mund te rregullohet me, i bije qe OE ka gatishmëri te garancisë dy vjeçare (ashtu siç është kërkuar ne: piken 13.1 te përmirësimi i defekteve). **Pretendimi: I pabazuar**





S.B

Nuk është e drejt qe AK, KK Gllogoc te luaj rolin e avokatit te kompanisë, por është e obliguar te respektoj ne tërësi dispozitat ligjore, sepse nuk mundet AK te jete aq i sigurt se OE do te ofroje garancinë dy vjeçare, sepse një deklarate e tillë për gradacionin nuk është plotësuar gjate fazës se aplikimit, prandaj AK ka bere shkelje sepse ka pranuar një dokument qe nuk e plotëson kriteret e kërkuara dhe si i tille është dashur te eliminohet ne fazën e përzgjedhjes.

**E dhjeta: E gjetura**

Edhe pse OE BM Group" Shpk sipas LPP-se nuk duhet te trajtohet fare i përgjegjshëm dhe nuk do te duhej fare te kalonte kriteret e përzgjedhjes, për vlerësim te çmimeve. Por te OE BM Group Shpk, kemi hasur ne çmime manipulative.

**Këtë e argumentojmë me dy pozicione si ne vijim:**

Poz. 46 janë kërkuar 12000m' kurse çmimi i ofruar nga OE ne fjale është 3€/m' kurse ne treg çmimi është rreth 1,40€/m' Poz. janë kërkuar 33000m' kurse çmimi i ofruar nga OE ne fjale është 3€/m' kurse ne treg është rreth 0.65 – 0.75€/m' **Arsyetimi i AK sa i përket te gjeturës tonë.**

**Paraqitur për: Përshkrimin e çmimit**

- Sqarime: Autoriteti kontraktues Komuna Gllogoc do te realizoj te gjithë kontratën me titullin "Rregullimi i infrastrukturës trotuarit dhe ndriçimit publik ne Komune e Drenasit – projekt dy vjeçare - Ritenderim", me numër të prokurimit: 611-22-5551-5-2-1, me te gjitha çmimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik te propozuar për kontrate dhe se është kompetence e Menaxherit te Kontratës ekzekutimi konform paramasës. Nuk është përgjegjësi e AK kontrollimi i çmimeve te tregut, por qe është kompetence qe oferta financiare e paraqitur nga kompania e përgjegjshme te jete nen limitin financiar te lejuar (vlerën e parashikuar te kontratës), te mos këtë gabime aritmetikore (e cila paramas nuk ka gabime aritmetikore).

Pretendimi ynë ka qene dhe mbetet se janë ofruar çmime manipulative, për pozicionet e cekura me larte, nuk ka qene pretendimi ynë qe ka gabime aritmetikore, këtë duhet ta ketë te qartë AK, sepse pretendimi i ynë është i bazuar ne argumente, për faktin se behet fjale për dy pozicione te ngjashme, ndërsa me dallime te mëdha sa i përket çmimeve. Këtë e argumentojmë sepse kompania jone është e specializuar ekskluzivisht vetëm për projektet e tilla dhe jo vetëm te ngjashme por ne projektet te njëjta, prandaj e konsiderojmë se është oferte me çmime manipulative.
Është përgjegjësi e plotë e AK te hulumtoj dhe analizoj çmimet e tregut, sepse e ka obligim ligjore sipas LPP-se, përkatësisht **nenit 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**. Prandaj arsyetimi i AK është tërësisht i pa drejt dhe i pa bazuar.
Bazuar ne te lartcekurat, zyrtaret përgjegjës te AK, gjate vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimin e tenderit, kanë bërë një mori shkeljesh te dispozitave te LPP-së, ne njërën anë na eliminojnë nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit ne kundërshtim te plotë me dispozitat ligjore dhe pse jemi te **përgjegjshëm** ne kuptim te dispozitave ligjore te LPP-së, kurse ne anën tjetër AK shpërblen me kontrate OE "BM Group" Shpk si te përgjegjshëm ne kundërshtim te plotë me dispozitat ligjore te LPP-së.
AK me vendimin e vet për te eliminuar ofertën e GOE N.N.P. "Toni"& N.P.T. "Toni Ingjinjering" Sh.p.k. & "Mirusha Company" Sh.p.k. nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit me arsyetimin se tenderi i këtij kompanie është i papërgjegjshëm ne kuptim te dispozitave ligjore te LPP-se ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 6 te LPP-se.
Ne vijim po citojmë depozitat e nenit 6 paragrafi 1 te këtij ligji, citojmë: *Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*
Nëse i referohemi vendimit te autoritetit kontraktues do te shohim se çmimi i ofertuar i ofertës se GOE N.N.P. "Toni"& N.P.T. "Toni Ingjinjering" Sh.p.k. & "Mirusha Company" Sh.p.k., është **332,555.00 €** dhe është çmimi me i ulet ne raport me çmimin e OE te propozuar për kontrate te kompanisë BM group" shpk, i cili **është i papërgjegjshëm** dhe i cili është shpërblyer me kontrate ne vlere prej **345,111.00 €,** me qe rast AK me këtë veprim dëmton buxhetin e varfër te Republikës se Kosovës dhe te Komunës se Gllogocit, i cili buxhet përbehet nga taksat e qytetareve te komunës, demi qe do ti shkaktohet është ne shumen prej **12,556.00 euro.**
Duke pasur parasysh këto fakte, kërkojmë nga AK, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik qe ankesën tone ta trajtoj me pajtueshmëri me dispozitat ligjore te LPP-se, ta trajtoj ne pajtueshmëri te plote me kërkesat e parapara ne njoftim për kontrate dhe dosje tenderit. Sepse ankesa jone eshët tërësisht e bazuar me fakte dhe argumente. Shpresojmë dhe besojmë se OSHP-ja, se bashku me ekspertet shqyrtues te OSHP-se dhe me panelin shqyrtues do te analizoj te gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura ne këtë ankese dhe te nxjerr vendim meritore te bazuar ne fakte, sepse ne nuk po kërkojmë as me shume e as me pak por vetëm respektimin e dispozitave ligjore. Jemi ne te drejtën tone, **kemi ofruar çmimin me te ulet dhe jemi te përgjegjshëm. Dhe si përfundim:**

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), që:





S.B

- ✓ Te aprovoj ankesën te bazuar;
- ✓ Te anuloje vendimin e AK për dhënie te kontratës;
- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi te behet ne pajtim me LPP dhe Rregullat dhe RRUOPP.

Mbetemi me shprese se ankesa jone do te shqyrtohet pozitivisht.
Me nderime, ne emër te konsorciumit;,
Labinot Krasniqi

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK ), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues si dhe Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë plotesuar /shtuar me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

## KRITERET PËR VLERËSIM

*(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore*

### III.2.1) *Kërkesat e përshtatshmërisë* — *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| 1. Kërkesat përshtatëshmerisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L- 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, përkatësisht Nenit 65 pika 1,2,3,4, 4.9 dhe 5. | 1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal. |

### III.2.2) *Përshtatshmëria profesionale:* — *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| 4.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katallog ne perputhje me standartet Evropjane dhe kompatibil me ndriquesin e ofruar , katalogu të dorzohet ne dosje të Tenderit<br>6. Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , ISO39001 2012, ISO45001 2018 , ISO 50001 2018 | 4.Autorizim nga prodhuesi per trupat ndriques te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrveshje me Prodhuesin marrveshja duhet te jetë e nenshkruar dhe e vulosur nga Prodhusi ku mundet me perdor OE me konfirmim te prodhuesit.<br>6.Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , ISO39001 2012, ISO45001 2018 , ISO 50001 2018 - kopje te noterizuara |

### III.2.3) *Kapaciteti ekonomik dhe financiar:* — *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| 1.Pasqyrat financiare te audituara per tri vitet e fundit. | 1.Kopjet e pasqyrave financiare te audituara per tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit per pasqyrat perkatese nga nje Auditor i Licencuar ose ndonje kompani e auditimit - ( te bashkangjitet kopje e noterizuar e licences se Auditimit )- PER LIDERIN |

### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional — *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

| Kërkesat: | Evidencat: |
|---|---|
| 3. Nje Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes, apo bachelor minimumi 3 vite përvojë pune nga diplomimi ne udheheqje e projektit ne teren . Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja dhe marrveshje e noterizuar mes dy palve me titull te tenderit.<br>6. Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Dy autokorpë për intervenim në lartësi të ndryshme, nje Kamionë me kran , nje Kamionet kiper pesha 2-4 ton, nje Skip – bager | 3. Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja , deshmit e pervojes ose marrveshje e noterizuar mes dy palve me titull te Tenderit.<br>6. Listën e mjetet-paisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD – i doganor, ose kontrata mbi qiramarrjen e noterizuar, ose kontratë mbi shit-blerje ose faturë.(Lista duhet vërtetuar nga Operatori Ekonomik) |





S.B

## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

*Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim: (Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).*

GOE Labinot M. Krasniqi B.I. (NNP "TONI") nuk ka arrit te plotësoj këtë kriter pasi qe autorizimi nga prodhuesi nuk e ka te notrizuar nga origjinali (i njëjti nuk ka arritur te paraqes asnjë marrëveshje ne mes te Grupit te Operatoreve Ekonomik dhe Prodhuesit LEDEUROPA me seli ne Austri) sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktues. I njëjti ka paraqitur një autorizim për shitje dhe ofrim mirëpo jo për projektin lidhur me "Rregullimi i infrastrukturës trotuarit dhe ndriçimit publik ne Komunën e Drenasit-projekt dy vjeçar - Ritenderim" me nr. të prokurimit:611-22-5551-5-2-1 dhe 611-22-048-5-2-1. Lidhur me këtë kriter edhe vet operatori ekonomik e ka pranuar se nuk eshët i noterizuar pasi qe ka paraqitur një deklaratë nën betim Toni Ingjenierig; Mirush Company Shpk-
Janë verifikuar te gjitha ISO standardet e paraqitura (ku Certifikata ISO 9001 2015 , ISO 39001 2012, dhe ISO 45001 2018 janë verifikuar dhe janë ne përputhje me kërkesën dhe afatet kohore te validitetit), ndërsa dokumenti ISO 50001 – 2018 dokument ky i lëshuar nga AQRA Certification doo me seli ne Beograd, si autoritet e kemi pasur te pamundur verifikimin e rregullt siç bëhet me te gjitha ISO-te tjera, i vetmi verifikim i këtij dokumenti eshët përmes një e-maili te paraqitur ne web faqen www.aqracertification.rs. Po ju njoftojmë se si autoritet përmes kontrollit te ISO standardeve ne web faqen www.verifyiso.com me numrin e Certifikatës SR.80.074 te datës 23.06.2022 nuk ka asnjë certifikatë valide dhe as emrin e kompanisë suaj (AK për ISO standardet tjera te verifikuara nuk e ka përdorë këtë platforme për verifikim).
Grupi i operatoreve ekonomik Labinot M. Krasniqi B.I. (NNP "TONI"); Toni Ingjinering; Mirusha Company Shpk ka paraqitur pasqyra financiare ne kundërshtim me Nenin 17 afatet kohore për dorëzim dhe publikimi i pasqyrave financiare (ku specifikohet qarte: 1. Pasqyrat financiare te shoqërive tregtare qe auditohen ne pajtim me SNA-te dhe ne pajtim me nenin 7 paragrafi 1 dhe neni 8 paragrafi 1 i ketij Ligji, dorëzohen dhe publikohen ne KKRF dhe një kopje dorëzohet ne ministrin përkatëse për tregti dhe industri, jo me vone se 30 prilli te vitit vijues. 2. Pasqyrat financiare te konsoliduar qe auditohen ne pajtim me SNA-te dhe ne pajtim me nenin 10 paragrafi 1. Te këtij Ligji, dorëzohen ne KKRF jo me vone se datën 30 Qershor te vitit vijues / te gjitha pasqyrat financiare lidhur me kompani liderë ne konzorcium janë paraqitur ne një kohe jashtë këtij afati, konkretisht me shume se 2 vite vonese) te ligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiare dhe auditim, ligj ky i publikuar ne Gaztën Zyrtare e Republikës se Kosovës / nr. 3/19 Prill 2018.
Po ashtu pas kontrolleve ne KKRF respektivisht ne linkun https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1.103 asnjë nga tre vitet e fundit kompania Lider ne këtë konsorcium nuk ka paraqitur raportet e auditimit.
GOE Labinot M. Krasniqi B.I. (NNP "TONI"); Toni Ingjinering; Mirusha Company Shpk, Kosova Gllogoc Negrofc, 13050, NEGROFC, Kosove ne lidhje me Inxhinerin e Elektroteknikes, merr sqarimet:
Nuk e plotësohet ky kriter pasi qe i njëjti ka bashkangjitur si inxhinier te elektroteknikes z. Besim Terziu. Me diplome universitare ne emër te Besim Terziqit, ndërsa ne kuadër te dokumentacionit (CV-se) ku verifikohet aspekti i përvojës se punës është paraqitur ne emër te Imri Besim Terziu-t.

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden ne platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

*(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)*
///

## VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

*(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).*
///

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

*(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).*
///



S.B

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: N.N.P. "TONI" – Gllogoc

*- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:*

**Përgjigje në Pretendimi nr.1**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ne eliminon ne këtë aktivitet te prokurimit lidhur me *Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit* .

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare **neni 8.1 & 8.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *1.Pasqyrat financiare te audituara per tri vitet e fundit.* | *1.Kopjet e pasqyrave financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit - ( te bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit )- PER LIDERIN* |

Lideri i grupit te operatoreve ekonomik – Labinot M Krasniqi (NNP "TONI") ka ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurimi, ka ofruar/dorëzuar Raportin e pasqyrove te audituara për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nga kompania " ECP & CONTO" Sh.p.k. duke j bashkangjitur Certifikatën (licence) me nr. 19 te datës 01.09.2016 te notrizuar nga **noteri z. Selatin D. Shahini me LRP. Nr. 15865/2022** te datës: 07.07.2022, andaj AK – komisioni i vlerësimit me rastin e eliminimit te GOE ka vepruar ne kundërshtim me **nenin 56 par. 3 të LPP-së,** ku thotë: *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e Tenderit".*, si dhe **nenin 41.11 te RRUOPP-së,** ku thotë: *"Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e Tenderit".* Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 2**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK na eliminon nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimet se: Grupi i operatoreve ekonomik nuk ka arritur te plotësoj këtë kriter pasi qe autorizimin nga prodhuesi nuk e ka te noterizuar nga origjinali (*i njëjti nuk ka arritur te paraqes asnjë marrëveshje ne mes te Grupit te Operatoreve Ekonomik dhe Prodhuesit LEDEUROPA me seli ne Austri*) sipas kërkesës se Autoriteti Kontraktues.

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale **neni 7.1 & 7.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *4.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katallog ne përputhje me standartet Evropjane dhe kompatibil me ndriçuesin e ofruar , katalogu të dorëzohet ne dosje të Tenderit* | *4.Autorizim nga prodhuesi per trupat ndriques te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrëveshje me Prodhuesin marrëveshja duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Prodhuesi ku mundet me përdor OE me konfirmim te prodhuesit.* |

Lideri i GOE NNP "TONI" – Negrovc, Gllogoc, ka dorëzuar katalogun për artikuj me specifikim – përshkrim teknik detal, si dhe Autorizimin nga Prodhuesi LEDEUROPA për trupat ndriçues te lëshuar me date:05.07.2022, i cili nuk është i noterizuar, po reshte nënshkruar nga prodhuesi, si dhe nuk është i vulosur nga prodhuesi, ku thotë, po citoj: "*Autorizojn [ NNP "TONI" Negrofc, Gllogoc] për te ofruar dhe shitur ne Kosove dritat LED te prodhuara nga ne nen Markën LED Europa. Ky formular autorizim është i vlefshëm për 3 vjet duke filluar nga data e lëshimit*". Andaj duke u bazuar ne analizën si me lartë, ne raste se AK – Komisioni i vlerësimit dyshon ne vërtitësin e këtij dokumenti - autorizimit, atëherë mund te veproj duke marr për baze **nenin 39.8 të RRUOPP-se**, Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me **nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së**, po citoj:





S.B

| Problemi | Si të veprohet? | Neni i LPP-së |
|---|---|---|
| Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar | Mund të kërkohen informata sqaruese | *Neni 66* |

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 3**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK na eliminon ne këtë aktivitet te prokurimit lidhur me *Verifikimin e standardit ISO 50001 2018*

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale **neni 7.1 & 7.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *6.Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , ISO39001 2012, ISO45001 2018 , ISO 50001 2018* | *6.Çertifikata për sistemin e menaxhimit te kualiteti ISO 9001 2015 , ISO39001 2012, ISO45001 2018 , ISO 50001 2018 - kopje te noterizuara* |

Anëtari i GOE "Toni Ingjenjering" Sh.p.k. ka dorëzuar/ofruar certifikatën ISO 50001 : 2018 te lëshuar me date: 23.06.2022 nga AQRA Certifikatën doo, noterizuar nga noteri z. Halil Rrukiqi me LRP. Nr. 7273/2022, te datës 07.07.2022, andaj nëse AK – Komisioni i vlerësimit dyshon ne vërtitësin e saj, atëherë mund te veproj duke marr për baze **nenin 72 dhe nenin 59 par. 2 të LPP-së, ose/apo nenit 52 par. 7 të LPP-së,** sepse aty ne këtë certifikatë sqarohen mundësit e verifikimit si dhe përmes web te dhënë ne këtë certifikatë ISO 50001 : 2018. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 4**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se: Nuk e plotësohet ky kriter qe i njëjti ka bashkangjitur si inxhinier te elektroteknikes z. Besim Terziu. Me diplome universitare ne emër te Besim Terziqit, ndërsa ne kuadër te dokumentacionit (CV-se) ku verifikohet aspekti i përvojës se punës është paraqitur ne emër te Imri Besim Terziu-t.

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *3. Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes, apo bachelor minimumi 3 vite përvojë pune nga diplomimi ne udhëheqje e projektit ne teren . Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja dhe marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.* | *3.Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja , deshmit e përvojës ose marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit* |

Lideri i grupit te operatoreve ekonomik NNP "TONI" ka prezantuar menaxherin e projekt me vendim z. Nazif Nazifi, Inxh. i Dipl. i Elektroteknikes, si dhe inxh. e dip. te elektroteknikes z. Besim Terziu, ku ka ofruar Diplomën, CV Para-kontratën, te gjitha te noterizuar nga noteri z. Halil Rukiqi dhe ne te gjitha këto dokumente te vërtetuar nga noteri, kopje identike me origjinalin e diplomës, vërtetmi i nënshkrimit për kontratën dhe CV në të gjithë këto dokument te është **numëri personal: 1012291244** dhe është emri: **Besim Terziu,** si dhe data e lindjes: **09.06.1972,** qe do te thotë se behet fjale për një person, mirëpo për çdo dyshim nga AK – Komisioni i vlerësimit ka mundur te veproj duke marr për baze **nenin 72 dhe nenin 59 par. 2 të LPP-së,** dhe te sigurohet se behet fjale për te njëjtin person apo ndryshon. Gjithashtu, Antari i grupit "Toni Ingjinjerin" Shpk ka prezantuar z. Afrim Fejza - inxh. dipl. te elektroteknikes, duke bashkangjitur diplomën, CV dhe para kontratën te motorizuar nga noeteri z. Halil Rrukiqi, duke ofruar tre (3) inxh. te dipl. te elektroteknikes. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**





S.B

**Përgjigje në Pretendimi nr. 5**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ne kundërshtim te plote me dispozitat ligjore te LPP, përkatësisht nenit 65 paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 te LPP-së, ka pranuar një **deklarate nen betim** nga OE "BM Group" Shpk **pa titull te tenderit dhe pa numër te prokurimit**, çka do te thotë se OE "BM Group" Shpk, është dashur te **eliminohet qe ne fazën e përzgjedhjes**. Sepse deklarata ne dosje te tenderit e ka titullin dhe numrin e prokurimit, por deklarata nen betim e dorëzuar nga "BM Group" Shpk nuk e ka.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka dorëzuar Deklaratën nen betim te nënshkruar dhe te vulosur, mirëpo përshkrimin ne **Header dhe Footer**, nuk janë ashtu siç ka përcaktuar AK ne dosje te tenderit (deklrates nen betim nga OE i rekomanduar për dhënie te kantatës i mungon), me poshtë po ju prezantoj te dyja si ne vijim:


Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM



Prandaj, duke marr për baze se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është ne **diskrecion** te AK – Komisionit te vlerësimit, i cili e ka mund te trajtoj sipas **nenit 59 par. 4 pika (i) te LPP-se**, po citoj: *"përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë"*, apo/ose sipas nenit **47.20 dhe 47.21 te RRUOPP-se**. Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 6**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE "BM Group" Shpk mund te konstatohet se OE ne fjale ka ofruar katalog me specifika teknike, mungon deklarata e konfirmiteti nga kompania CREE për trupa ndriçues, për te cilin katalog **nuk ka autorizim**, kurse AK ka kërkuar Autorizim nga prodhuesi apo marrëveshje me prodhuesin, marrëveshja duhet te jete e nënshkruar dhe e vulosur nga prodhuesi ku mund te me përdor OE me konfirmim te prodhuesit, por OE "BM Group" Shpk i ka bere autorizim vetvete çka do te thotë se përveç se është e pa pranueshme është edhe ne kundërshtim me kërkesat e AK. I mungon raporti për specifika teknike për trupa ndriçues nga kompania prodhuese ne këtë rast "BM Group" Shpk ku deklaron se është prodhues, por ne te **vërtetë nuk ekziston**, prandaj veprimet e AK janë ne kundërshtim te plote me dispozitat ligjore për faktin se OE "BM Group" Shpk është dashur te eliminohet qe ne **fazën e përzgjedhjes**.



S.B.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale **neni 7.1 & 7.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *4.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katallog ne përputhje me standartet Evropiane dhe kompatibil me ndriçuesin e ofruar , katalogu të dorëzohet ne dosje të Tenderit* | *4.Autorizim nga prodhuesi për trupat ndriçues te ofruar ne oferte te jetë nga prodhuesit EU noterizuar nga Origjinali apo marrëveshje me Prodhuesin marrëveshja duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Prodhuesi ku mundet me përdor OE me konfirmim te prodhuesit.* |

OE i rekomanduar per dhënie te kontratës ("BM Group" Sh.p.k.) ka ngarkuar ne platformën elektronike dorëzuar/prezantuar Autorizim nga "BM Group" SHPK me NRB 810839251 te noterizuar nga noetri z. Zyfer Aliu me LRP.nr. 8937/2022, me date: 07.08.2022, mirëpo ashtu siç e dimë Republika e Kosovës nuk pjese e EU, kurse kërkesa e FDT-se ka qene qe autorizimi duhet jete nga prodhuesit e EU (Eurpian Union), gjithashtu ka prezantuar një katalog si ne vijim:

## Për ne

Bm Group është kompania e vetme në Kosovë që merret me prodhimin e produkteve të teknologjisë LED. Produktet tona i ofrojmë në dy versione: për ambient të brendshëm (zyra pune, shtëpi, etj.) dhe për ambient të jashtëm. Që nga themelimi e deri me tani, kemi ekzekutuar mbi 50 projekte të mëdha të ndriçimit të hapësirave të ndryshme, ku përfshihet ndriçimi në Aeroportin Kombëtar "Adem Jashari", ndriçimi publik në qytetin e Prishtinës, Gjilanit, Gjakovës, Prizrenit, Drenasit e Obiliqit.

Duke qenë se teknologjia e ndriçimit LED zhvillohet shpejt dhe vazhdimisht, me angazhimin tonë të pakursyer synojmë të qëndrojmë krahas këtij avancimi me produktet tona.
Në bashkëpunim me partnerët tanë, tashmë kemi rritur cilësinë e shërbimit duke shtuar jetëgjatësinë e produktit dhe duke ulur konsumin e energjisë.

Ndriçimi i mirë është më shumë se një dritë.
Ndriçimi i mirë jua rehaton mendjen e shpirtin dhe ju frymëzon për produktivitet më të madh.
Ndriçimi i mirë ngre nivelin e jetesës në qytetin tuaj duke jua dhuruar ndjesinë e sigurisë kudo në të.
Me Bm Group, ju hyni në një epokë të re të ndriçimit.




Prandaj, AK – komisioni i vlerësimit ka vepruar ne kundërshtim me nenin **nenin 59 par. 4 të LPP-së**, ku thotë: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*", **nenin 7 par. 2 të LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*". Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**





S.B

**Përgjigje në Pretendimi nr. 7**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se **Mungon Plani Dinamik**, OE "BM Group" Shpk nuk e ka ofruar planin dinamik edhe pse plani ka qene i paraparë edhe ne dosje te tenderit, sepse ka qene kusht qe duhet plotësuar nga OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK gjate përgatitjes se dosjes se tenderit si dokument themelore për përgatitjen e tenderëve, plani dinamik nuk është përcaktuar tek kriteret e përzgjedhjes, por është përcaktor tek Pjesa II Përshkrimi i çmimeve – paramasa dhe parallogari, ku është kërkuar, po citoj: "***Plani dinamik përfshin 70 ditë PUNE (50 ditë pune për vitin 2022 dhe 20 ditë pune për vitin 2023 dhe 20 ditë pune)***", dhe OE i rekomanduar për dhënie e ka nënshkruar dhe vulosur paramasen ku është pajtuar me planin dinamik te përcaktuar ne ditë punë (edhe pse nuk e ka ofruar një plan dinamik për këtë AP). Plani dinamik është kusht i implementimit te kontratës dhe secili operatore ekonomik është i obliguar ta respektoj afatet kohore për implementimin e kontratës. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 8**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se **Mungon Licenca e Auditorit,** kurse ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit ky ka qene kusht administrativ qe duhet te plotësohet, kurse OE "BM Group" Shpk nuk e ka ofruar këtë dëshmi, prandaj është dashur qe OE ne fjale te eliminohet ne fazën e përzgjedhjes.

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne ne Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare **neni 8.1 & 8.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *1.Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit.* | *1.Kopjet e pasqyrave financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit per pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit - ( te bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit )- PER LIDERIN* |

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk e ka prezantuar(ngarkuar ne platformën elektronike) se bashku me raportet e auditimi edhe kopjen e noterizuar te licencës se auditimit, ashtu siç është kërkuar ne tek kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiar ne dosje te tenderit, andaj AK – Komisioni i vlerësimit atëherë mund (ka qene i obliguar) te veproj duke marr për baze **nenin 39.8 të RRUOPP-se**, Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me **nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së**, po citoj:

| **Problemi** | **Si të veprohet?** | **Neni i LPP-së** |
|---|---|---|
| Mungon licenca | Mund të kërkohen informata sqaruese | *Neni 66* |

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 9**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, **Mungon CV e inxhinierit Gëzim Karaxha, kurse CV dhe kontrata e inxhinierit Arben Mulaku**, janë te pa notreizuara ne kundërshtim te plote me kërkesat e AK, te parapara ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, prandaj është dashur qe OE "BM Group" Shpk te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *3. Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes, apo bachelor minimumi 3 vite përvojë pune nga diplomimi ne udhëheqje e projektit ne teren : Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja dhe marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit.* | *3.Diploma e noterizuara, kontrata, cv-ja , dëshmitë e përvojës ose marrëveshje e noterizuar mes dy palëve me titull te tenderit* |





S.B

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar z. Gezim Karaxha – Bach. i shkenc. te inxh. elektrike, duke bashkangjitur **Diplomën te noterizuar**, Kantatën me kohe te pacaktuar, **mirëpo mungon CV-ja** (*nuk është bashkangjitur ne platformën elektronike*), gjithashtu ka prezantuar z. Arben Mulaku – Bach. i Shkenc. Te Inxh. elektrike, duke bashkangjitur, **Diplomën te noterizuar**, Kontratën me kohe te pacaktuar, si dhe CV-në. Bazuar ne kërkesën e përcaktuar ne FDT sikurse kam prezantuar me lart, kontrata dhe CV-ja nuk janë kërkuar te noterizuar, ndërsa marrëveshja nëse stafi profesional nuk janë ne marrëdhënie te punës se përhershme, është kërkuar te ceket titulli dhe te jete e noterizuar, kurse stafi i profesional ne fjale janë prezantuar kontrata me kohe te pacaktuar (qe do te thotë janë te punësuar me kontratë te pacaktuar). Kurse sa i përketë CV-ja e cila mungon për z. Gezim Karaxha, AK – komisioni i vlerësimit është ka mundur dhe ka qene i obliguar te veproj duke marr për baze **nenin 39.8 të RRUOPP-se**, Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me **nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së**, po citoj:

| **Problemi** | **Si të veprohet?** | **Neni i LPP-së** |
|---|---|---|
| CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar | Mund të kërkohen informata sqaruese | Neni 69 |

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 10**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se **Mungon deklarata për specifikacion teknik**, është kërkesë e dosjes se tenderit dhe është dashur me patjetër te plotësohet. Prandaj OE "BM Group" Shpk është dashur te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK gjate përpilimit te dosjes se tender si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve, nuk është kërkuar tek kriteret e përzgjedhjes, si dhe Aneksi 1 te FDT-se, nuk ka pas ndonjë specifimim teknik qe OE do te duhej te plotësonte. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 11**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, **nuk ka ofruar Skip-bager, mungon kamionta me kiper sipas Librezës se qarkullimit**, sipas dosjes se tenderit, por ka ofruar me zinxhire, ne kundërshtim te plotë me kërkesat e AK, te paraqitura ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit, prandaj është dashur qe OE BM Group" Shpk te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| *6.Të paraqitën pajisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Pajisje te domosdoshme) Dy autokorpë për intervenim në lartësi të ndryshme, një Kamionë me kran, një Kamionet kiper pesha 2-4 ton, një Skip – bager* | *6.Listën e mjetet-pajisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD – i doganor, ose kontrata mbi qiramarrjen e noterizuar, ose kontratë mbi shit-blerje ose faturë.(Lista duhet vërtetuar nga Operatori Ekonomik)* |

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar kamionet kiper me librezën e qarkullimit me tabela: 01-762-MT ne emër te OE "BM Group" SHPK , si dhe ka prezantuar një faturë te blerës me emërtim: Eskavator i perdorur JCB 3CX4 TL si dhe një faturë te blerjes me emërtim: Eskavator me zingjirë marka TIP R 914 HDSL, marr për baze natyrën e punëve dhe mundësin e kombinimit te pajisjeve, pajisjet e tilla këto pajisje janë ekuivalente dhe plotësojnë kërkesën e AK te përcaktuar ne dosje te tenderit. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 12**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, **mungon deklarata për garancionin e trupave ndriçues për dy vite** është kërkesë e dosjes se tenderit dhe është dashur me patjetër te plotësohet. Prandaj OE BM Group" Shpk është dashur te eliminohej ne fazën e përzgjedhjes.





S.B

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK gjate përgatitjes se dosjes se tenderit si dokument themelore për përgatitjen e tenderëve, deklarata për garancionin e trupave ndriçues nuk është përcaktuar tek kriteret e përzgjedhjes, por është kushte administrative tek KVK dhe është kusht i implementimit te kontratës dhe secili operatore ekonomik është i obliguar ta respektoj periudhën garantuese te defekteve sipas afatet kohore për garancinë e ekzekutimit te punimeve. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 13**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE BM Group" Shpk sipas LPP-se nuk duhet te trajtohet fare i përgjegjshëm dhe nuk do te duhej fare te kalonte kriteret e përzgjedhjes, për vlerësim te çmimeve. Por te OE BM Group Shpk, kemi hasur ne çmime manipulative. Poz. 46 janë kërkuar 12000m' kurse çmimi i ofruar nga OE ne fjale është 3€/m' kurse ne treg çmimi është rreth 1.40€/m' Poz. janë kërkuar 33000m' kurse çmimi i ofruar nga OE ne fjale është 3€/m' kurse ne treg është rreth 0.65 – 0.75€/m'

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, GOE ankues ka përmendur pozicionet ne paramas dhe parallogari duke pretenduar se janë çmime manipulative, por nuk ka ofruar asnjë prove apo dëshmi qe e mbështet këtë pretendim, prandaj është përgjegjësi dhe ne diskrecion te autoritetit kontraktues qe gjate procesit te vlerësimit te tenderëve te trajtoj dhe analizoj çmimin apo te konsiderohet si çmim jo normalisht I ulet apo çmimi jo I tregut ne pajtim me nenin 61 te LPP-se, ne mënyrë qe ta bëjë ekzaminimin, vlerësimin, dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave te kualifikimit te specifikuara ne njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar nenin 7, 56, 59, 60, 72 të LPP-së,** dhe **nenin 39.8 te RRUOPP-së,** andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së,** autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së,** pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e GOE akues **të aprovohen të bazuar,** dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK(*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim** duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

*Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:*

- *Autoritetit Kontraktues* – *Komuna Gllogoc*
- *Panelit Shqyrtues* – *OSHP*
- *Grupi OE ankues* – (NNP "TONI"); "Toni Ingjinering" Sh.p.k.; Mirusha Company Sh.p.k. – *Gllogoc*





S.B

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 417/22
Datë/Datum. 15.11.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**P.Sh. Nr.417/21**

Paneli Shqyrtues i Prokurimit**,** i emëruar nga OSHP sipas nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi-Referuese dhe Agon Ramadani - Anëtar, bazuar në neni 98, paragrafi 1, nenin 105, paragrafi 2, lidhur me nenin 99 paragrafi 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar) dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, duke vendosur sipas kërkesës së Komunës të Drenasit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik" parashikuar me nenin 99, paragrafi 2, i Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, e paraqitur me 02.06.2021 ndaj Operatorëve Ekonomik (OE) "DONITA SH.P.K ; N.P.T MALI-I", me seli në Mitrovicë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Inventarizimi i shkollave –faza e dyte" me numër të prokurimit 611-20-144-121, me 15 nëntor 2022, mori:

**V E N D I M**

**1. Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa e Komunës të Drenasit, e parashtruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 02.06.2021, (Nr. Protokolli 417/21), nën dyshimin për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik" e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

**A r s y e t i m**

Me 02.06.2021, Komuna Drenas në cilësinë e AK, ka dorëzuar në OSHP kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP, ndaj operatoreve si në vijim: "DONITA SH.P.K ; N.P.T MALI-I", me seli në Mitrovicë, me numrin unik të regjistrimit 810153841 dhe N.P.T. MALI-I me Numrin unik të regjistrimit 810201400, nën pohimin se ekziston dyshimi për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga ky operator ekonomik ashtu sikurse parashihet me nenin 99 par 2 të LPP.

Në kërkesën e cituar si më sipër AK-Komuna Drenas ka theksuar se, arsyeja e kërkesë tonë është se Grup i Operatorëve Ekonomik "DONITA SH.P.K ; N.P.T MALI-I" ka paraqitur dokument të falsifikuar vërtetimin tatimor me numër serik 1000721630 për operatorin ekonomik NPT MALI[1]

Majlinda Bajraktari B.I gjatë inplementimit të kontratës është vërejtur se ka mospërputhje në datën e prezantuar në sistem dhe në atë të verifikimit të ATK-së. Autoritetit kontraktues ka kërkuar nga ATK një interpretim të gjendjes faktike të këtij vërtetimi dhe pas verifikimit nga ATK është konstatuar që ky dokument nuk përputhet me gjendjen faktike të prezantuar nga grupi i operatoreve ekonomik i datës 20.10.2020, faktikisht pas verifikimit ky vërtetim me këtë numër serik është i datës 20.07.2020. Në bazë të kësaj konstatojmë që dokumenti është i falsifikuar nga grupi i operatorëve ekonomik. ZPP kërkon nga Organi Shqyrtuese i Prokurimit të vendos në listën e zeze Operatoret Ekonomik të lartcekura.
Sqarojmë, se në shkresat e lëndës janë të bashkangjitura edhe sqarimi nga ATK dhe vërtetimi i ATK-së i prezantuar nga grupi i operatorëve ekonomik të lartcekura. Në kërkesën për verifikim të autoritetit kontraktues të datës 31.05.2021, drejtuar Administratës Tatimore të Kosovës thuhet: Zyra e prokurimit ne dosjen e tenderit dhe ne njoftim për kontrate ka kërkuar nga Operatori ekonomik të dëshmojnë vërtetimin e ATK-jo me të vjetër se 90 ditë për projektin me nr. 611-20-114-121 dhe numrin e jashtëm 611-20-6905-121 me titull: "Inventarizimi i shkollave –faza e dyte".Grupi i operatoreve ekonomik "DONITA SH.P.K ; N.P.T MALI-I". Kërkojmë, nga ana e juaj që të na verifikoni gjendjen faktike të vërtetimit ne datën e prezantuar. Si dhe në attachment është bashkangjitur vërtetimi i Majlinda Bajraktari.

Administrata Tatimore e Kosovës me datë 01.06.2021, i është përgjigjur kërkesës për verifikim të Autoritetit Kontraktues Komuna Drenas, përkatësisht zyrës së prokurimit ku thuhet: Ashtu siç është kërkuar verifikuam Vërtetimin e bashkangjitur me numër serik: 1000721630 nga tatimpaguesi Majlinda Bajraktari B.I me NUI:810201400 dhe ID:1003942330, mirëpo si tillë ky vërtetim nuk është i njëjtë me dëshminë e gjeneruar nga sistemi (të bashkangjitur gjeni dëshminë e verifikimit nga sistemi ). Mospërputhja është në datën e gjenerimit të vërtetimit tatimor. Sipas, të dhënave ne sistem vërtetimi tatimor me nr. Serik 1000721630 është gjeneruar me datën 20.07.2020 e jo me datë 20.10.2020, siç është vërtetimi i bashkangjitur nga ana e juaj.

Vërtetimin tatimor të lëshuar nga ATK, ju mund ta verifikoni në çdo kohë duke klikuar ne linkun https://evertetimi.atk-ks.org/

Gjetjet e përshkruara nënkuptojnë faktin se veprimet e OE, në kuptimin se si janë përshkruar ato si më sipër, kanë të bëjnë me *paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik*, sikurse parashihet me nenin 99, paragrafi 2, të LPP dhe për ketë arsye, AK ka paraqitur në OSHP me 02.06.2021, kërkesë për inicimin e procedurës së diskualifikimit në kuptim të dispozitës së cituar si më sipër, për të cilën janë njoftuar të gjithë OE.

OSHP, ka konvokuar me 15 nëntor 2022, seancën dëgjimore me palë, dhe administrimin e provave të lëndës pa prezencën e palëve sepse nga shkresat e lëndës kishte prova të mjaftueshme që të merret vendimi përfundimtar.

Paneli Shqyrtues e klasifikon kërkesën si të pa bazuar sepse autoriteti kontraktues verifikimin e dokumentit së lartcekur (vërtetimin e ATK) ka qenë dashtë ta bëjë në kohën kur e ka pranuar këtë dokument dhe pastaj ta paraqes kërkesën tek OSHP. Tani pasi që AK Komuna e Drenasit është në

fazën e implementimit të kontratës, falsifikimin e këtij dokumenti mund ta paraqes tek organet tjera gjegjëse të hetuesisë.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës komerciale-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryetare e Panelit Shqyrtues

z. Vedat POTERQOI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Drenas
1x1 OE "DONITA SH.P.K ; N.P.T MALI-I"
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 727/22
Data/Datum. 09.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| *Eksperti shqyrtues* | *Data e autorizimit të ekspertit* | *Data e dorëzimit të raportit* | Nr. i lëndës: |
|---|---|---|---|
| ***Ilir Salihu*** | ***05.12.2022*** | ***09.12.2022*** | *727/22* |

## 1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.12.2022, OE **"Diamanti" sh.p.k**, Prishtinë, ka parashtruar ankesën me nr: **727/22**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit-Projekt dy vjeçar"** me nr. të prokurimit: **611-11-12335-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Gllogoc**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë për punë.

Kriteri për dhënie të kontratës ishte: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2. PRETENDIMET ANKIMORE

Në vazhdim janë paraqitur Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP nga OE ankues.

* * *

Fillimisht ju rikujtojmë se për këtë aktivitet të prokurimit kemi bërë kërkesë për informata shtesë me dt: 09.11.2022 dhe 14.11.2022, si dhe kerkesen per rishqyrtim me date 22.11.2022.

**Ku kemi kërkuar nga AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit projektin** në formë elektronike (PDF dhe DWG) në mënyrë që të jetë e detajizuar se në cilën pjesë do të behet ekzekutimi i punimeve në Gllogovc, gjegjësisht është e rëndësishëm për organizimin e planit dinamik, furnizimit të gypave, ofertës financiare si dhe për arsyje të mungesës së vizitës në terren.

Kryesisht nevojitet projekti i rrjetiti të shtrirjes të gypave PN 16 bar, si dhe ku keni planifikuar të vendosni këta gypa sepse është kufizuar tej mase konkurrenca dhe mundësia është shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit dhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik.

Vlene te ceket se ne paramase dhe parallogari **nuk jane parapare keto pozicione :**

a) Mungon pozicioni i germimit te punet e kyqjeve shtepijake (POS:IV) e cila fillimisht duhet germuar hapesira per vendosjen e pusetes shtepijake, pastaj te behet montimi i saj. **Si dhe mungon germimi tek gypi OD 25mm** per ekzekutimin e kyqjeve shtepijake , me gjatesi **L=2,000m`.**

b) Mungon pozicioni I Germimit Tek Instalimi I Gypave HDPE 100 RC TIP2 (Pos :V), ku ne kete kapitull jane parapare te behet furnizimi dhe montimi i gypave **OD 63mm, OD 140mm, OD 250mm**. Ku gjatesia totale e gypave eshte **L= 1,500m`** me Presion nominal PN 16 bar. **(Mungon pozicioni i germimit per gjatesit e larteceku r te gypave).**

Ku me këto kritere po e bëni të pamundur ofertimin edhe për OE me eksperience të madhe në këtë fushëveprim, sepse teknikisht dhe praktikisht eshte pamundur qe te behet vendosja e pusetave te kyqjeve shtepijake **(POS IV)** , vendosja e gypave **(POS V)** ne mungesen e pozicionit te germimit.

Në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, **AK-ja jep një sqarim ku thotë që nuk ka projekt të perpiluar, pasi qe nuk ka projekt te perpiluar per ekzekutimin e rrjetit te ujesjellesit ne kete aktivitet te prokurimit.**

1. Ju sqarojmë se AK ka inicuar këtë aktivitet të prokurimit, pa hartuar fillimisht një projekt. Me këtë veprim ju keni rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 19.17 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022, ku përcaktohet qartë *"Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtron, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes se tenderit. Gjithashtu* keni rënë në kundërshtim me LPP nr.28 Paragrafi 10: *Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit."*

   **Pra në këtë rast AK nuk e ka respektuar dispozitën e lartcekur, pasi që ka inicuar aktivitetin e prokurimit, pa ekzistuar një projekt ekzekutues.** Ju informojme se projektet hartohen me qellim qe te mos kete nevoje per ritenderim dhe pune shtese. Kjo jo vetem qe ka kosto shtese financiare per komunat,po shkakton edhe humbje te kohes me shtimin e procedurave.

Poashtu në kërkesën tjetër te Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pika 4 ka kërkuar :
**4. ISO 3834-2 2005 (Occupatiolnak helath and safety management system).**

2. E cila është kërkesë e pakuptimtë ose është bërë gabim teknik sepse **ISO 3834-2 2005** ka të bëjë me certifikate për saldimin me shkrirje të materialeve metalike, ndërsa përshkrim(Occupatiolnak helath and safety management system). Kërkohet **ISO 45001:2018** Sistemi I menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.

   Kemi kërkojmë nga AK të na sqaroj se qfarë ISO kërkohet në këtë kërkesë të pakuptimtë, sepse nëse kërkohet ISO për saldimin me shkrirje të materialeve metalike, duhet të largohet si kriter sepse projekti ka të bëjë me ndërtim të ujësjellësit me gypa PE, **ndërsa nëse ka dashur të kërkoj ISO për menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, duhet të përmisohet dosja duke kërkuar ISO 45001:2018 .**

   Në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, **AK-ja jep një sqarim** se eshte bere **gabim teknik**, mirepo tek formulari per korrigjim te gabimeve prap nuk eshte permiresuar dosja e tenderit.

Tek Kapaciteti teknik dhe profesional keni kërkuar si : **Dy (2) saldues te certifikuar**

3. Pas kerkeses per sqarim te dates 14.11.2022 AK ka kërkuar **Dy (2) salduses të certifikuar EN 9606/2012** kërkesë e cila nuk përkon me natyrën e punimeve.

   AK në këtë rast me këte kërkese ka rënë në kundërshtim me natyrën e projektit sepse **EN 9606/2012** është për saldim të materialeve metalike, ndërsa projekti ka bëjë me saldim I gypave PE që duhen të jenë sipas normave **EN 13067:2013 (Saldues i certifikuar per gypa PE),** kjo kërkesë është totalisht e panevojshme sepse askund në paramasë dhe në këtë projekt nuk parashihet të kryhen punime të me gypa të hekurit dhe rrjedhimisht kjo kërkesë nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e punimeve në këtë tender.
   Prandaj kemi kërkuar nga AK ta korrigjoj këtë kërkese tek dosja e tenderit duke kërkuar **saldus te certifikuar EN 13067:2013 (Saldues i certifikuar per gypa PE).** Ku ne pergjigjen e kerkeses per rishqyrtim ku AK eshte pergjigjur me *"Nuk jeni referuar njoftimit te fundit per kontrate"*. Ju sqarojme se siç eshte cekur me larte se tek njoftimi per kontrate nuk eshte permiresuar fare.

-Gjithashtu Kapaciteti teknik dhe profesional keni kërkuar si: **Një autobot për ujë min. 17,000L**

4. 
   Duke pranuar sqarimin nga ana e AK e dërguar me datë :21.11.2022 të cilën e ka cekur se në rast të paraqitjes së ujërave nëntokësor, kjo autobotë shërben për largimin e ujërave nëntokësor. Gjë që kjo nuk qëndron sepse në rast të paraqitjes së ujërave nëntokësore, për largimin e tyre përdoren pompat dhe jo mekanizmi i lartëcekur.
   Andaj një autobot për ujë min. 17,000L e cila është me kapacitet të mëdha (vëllimi i lartecekur nuk ka aspak efekt-ndikim në këtë aktivitet të prokurimit).
   Kërkesa është e pa nevojshme për vetë natyrën e punimeve që do te realizohen ne

këtë aktivitet. Ne kete aktivitet duke specifikuar min 17,000 lit, ne si kompani nuk e kontestojme Autoboten si kriter, mirepo e kontestojme sasine (vellimin) prej 17,000 litrave e cila eshte e panevojshme.

**Pra kërkojmë nga OSHP që kjo kërkese me këtë kapacitet të largohet sepse nuk ka nevojë për një autobotë e llojit të tillë dhe se natyrisht është kërkesë që e kufizon konkurrencën për këtë tender.**

Kërkojmë nga ana juaj që të analizoni në tërësi dosjen e tenderit dhe të detyrohet AK-ja te behen ndryshimet e nevojshme, konform kërkesave tona të cilat janë të bazuara në dispozita ligjore.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6.
Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".
Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur dhe natyrisht që mundësia e dëmtimit të buxhetit është shumë e madhe.
Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit*".

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

AK në këtë rast me këto kërkesa, nuk e ka pasur parasyshe nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se "*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*". Pra jo vetëm që po ju pamundësoni ofertimin operatorëve ekonomik të themeluar rishtazi në kundërshtim me nenin e lartcekur, por po ju pamundësoni ofertimin edhe OE me përvojë të madhe në këtë fushë.

AK me kërkesat e lartcekura të cilat ia keni përshtatur një OE të caktuar po e rrezikoni dëmtimin e buxhetit të shtetit, pasi që në momentin që përshtaten kërkesat atëherë OE të cilët i plotësojnë këto kërkesa do të ofertojnë me çmim shumë më të lartë, ashtu siç ka ndodhur në shumë raste.

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi këtij aktiviteti të prokurimit dhe qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë

*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që *"Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Gjithashtu pa dashur që këtë paralajmërim ta keqkuptoni, ju njoftojmë se këtë tender me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara ne e konsiderojmë tender **të kurdisur** dhe normalisht që nëse nuk ndryshohen kërkesat do të jemi të detyruar të bëjmë denoncime edhe në organet tjera të cilat i përkasin fushës penale.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

**VENDIM**

**APROVOHET,** si e bazuar ankesa e OE "**Diamanti SH.P.K**"- Prishtinë
**NDRYSHOHEN** Kerkesat qe u ceken me larte nga ana jone dhe pastaj te veprohet konform **nenit** 53, te LPP-se duke ndryshuar keto kritere diskriminuese dhe të kunderligjshme duke e permirsuar dosjen të njoftimit për kontratë dhe te mos favorizohet nje kompani ofertuese dhe te perjashtohet te gjithe te tjeret
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

3. FAKTET E RASTIT RELEVANTE PER PRETENDIMET E OE ANKUES

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | 7.1 & 7.2 | Përshtatshmëria profesionale:<br><br>**4. ISO 3834-2 2005 (Occupatiolnak helath and safety management system).** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**4. ISO 3834-2 2005 (Occupatiolnak helath and safety management system)- kopje** |
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | Kapaciteti teknik dhe professional:<br><br>**7. Dy (2) salduus te certifikuar .**<br>**10.Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) -**<br>**...**<br>**Një autobot për ujë min. 17,000L** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare*<br><br>**7.Kontrat e punes dhe Çertifika .**<br>**10.Lista e paisjeve – origjinal , për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje deshmi (kopjet e librezave- , fatura, DUD-i njera prej tyre ), që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytezimin e tyre me qera), kopje te kontratave per furnizim me asfalt dhe zhavor te bashkangjitura me qertifikaten e biznesit, nr fiskal ndersa per baze te asfaltit dhe zhavor Licence ose leje te leshuar nga Komisioni i Minierave- kopje)** |

## 4. VENDIMI I AK-së PER RISHQYRTIM DHE SQARIMET E OFRUARA PER OE

| | |
|---|---|
| Shkresë | 25.11.2022 |
| Nga: | ZPP GEZIM HAJDINI |
| PER: | DIAMANTI SH.P.K. |
| Lenda : | VENDIM |

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësur me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik ne Kosov,përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rrgullave për parashtrimin e kerkesave për Rishqyrtim per njoftim te Kontratës , Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë :

VENDIM

1.Refuzohet si e pabazuar kerkesa e operatorit ekonomik "DIAMANTI SH.P.K.." kunder njoftimit per kontrate të autoritetit kontraktues "Ndërtimi i kapaciteti të ujësjellsit - Projekt dy vjeçar" me nr 611-22-12335-5-2-1 dhe nr.i brendshëm: 611-22-097-521 si e pabazuar .

OE ka paraqitur kerkesë për rishqyrtim te AK me datën 22.11.2022 kunder njoftimit për kontrate në AK dhe refuzohet si e pabazuar per arsye se :

1. Autoriteti Kontraktues nuk posedon projektin pasi që nuk kemi hartuar projekt për ekzekutim të rrjetit të ujësjellësit duke qenë se neve si Autoritet Kontraktues na ndikon në kosto mirëpo kjo nuk do të thot që nuk janë të analizuara me kujdes të gjitha pozicionet në paramasë dhe parallogari.

2. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale -ISO 3834-2-ne është gabim tekonik kerkohet ISO 45001:2018 Sisetemin I menxhimit te shendeti dhe siguris ne pune.

3. Asnjë nga kriteret e parashikuara për këtë projekt nuk është diskriminues apo favorizues ndaj kompanive të caktuara, andaj është e pabazuar kërkesa juaj për inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv, pasi që një ndër pozitat që kompanitë certifikohen për siguri dhe shendet në punë është edhe stafi profesional i kompanisë që në këtë rast hyn edhe inxhinierat.

4. Kërkesa mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale-Dy saldues te certifikuar EN 9606/2012, për realizimin e këtij projekti janë të nevojshem salduesit e cekur ne DT. Nuk jeni referuar njoftimit te fundit perkontrat.

5. Kapaciteti teknik lidhur me paisjen autobot për ujë min. 17,000L nuk është kriter jashtë normave andaj kërkesa juaj është e pabazuar. Ky kapacitet i autobotit gjithashtu shërben për mbushjen apo testimin e gypave të ujësjellësit.

Kundër ketjë vendimi keni drejtë ankese në OSHP në afatë prej 10 ditë .

| | |
|---|---|
| Shkresë | 21.11.2022 |
| Nga: | ZYRA E PROKURIMIT - DRENAS<br>ZPP, GEZIM HAJDINI |
| Për: | Operatoret ekonomik |
| Lenda : | Kerkese per sqarime |

*PROJEKTI* **Ndërtimi i kapaciteti të ujësjellsit - Projekt dy vjeçar**

*Pergjigije ne pytjet e parashtruara*

Pytja Nr.1

Matjet gjeodezike do të kryhen për të gjitha pozicionet ku janë të përfshira: Kyqjet shtepijake, Instalimi i gypave HDPE 100RC tipi2, Punet e pusetave nga betoni (poz.IV,poz.V, Poz VI)

Sa i perket projektit per vendosjen e gypave, projekt te perpiluar nuk ka, mirëpo menaxheri cakton lokacionin dhe degzimet pas analizave te drejtoris duke u bazuar edhe ne kerkesat e banorve se ku eshte kerkesa ma e madhe për rrjet të ujësjellësit të ujit të pijëshëm.

Pytja Nr.2

Arsyja e implementimit per ndryshimin e materialit te pusetave eshte bere per arsyje sepse pusetat nga materiale PE jane me te pershtatshme per arsyje se:

-Jane rezistente ndaj temperaturave te ulta dhe te larta

-Pusetat PE janë 100% të papërshkueshme ndaj ujit, probabiliteti i rrjedhjes nuk egziston

- Pusetat PE kanë një peshë të reduktuar shumëfish më të lehtë se pusetat e betonit

-Thjeshtësia dhe lehtësia e instalimit të pusetave PE ka një pikë pozitive në krahasim me pusetat e betonit.

Me puseta PE montimi është shumë më i lehtë dhe më pak i kushtueshëm nuk është e nevojshme të përdoren makineri të rënda për transport ose për montim të tyre, e gjithë kjo mund të kryhet me maksimum me një ose dy punëtorë, që do të thotë ulje e kostos në krahasim me pusetat e betonit.

| | | |
|---|---|---|
| 4.2 | Furnizimi dhe montimi i pusets nga materiali PE ф800mm , duke perfshire termo mbrojtje dhe termo kapak, me te gjitha elementet percjellese sipas normave teknike. | copë |

Ne kete pozicione eshte bere nje gabim Teknik ku eshte dashur te jete puseta nga materiali PE me thellsi H800mm, ndersa per diameter ф500mm

*Forma e nje puseta nga PE me termo mbrojtje*



| Lartesia | Diametri | Materiali |
|---|---|---|
| H800 | Ф 500 | PE |

**Kompania duhet te jet e certifikuar me iso**

- ISO 3834-2:2005 (Occupatiolnak helath and safety management system).

Eshte si kriter i qendrushem sipas njesi kerkuse dhe qe eshte aplikuar edhe me heret. Fokusi parësor i zbatimit të këtij sistemi është parandalimi i çdo lloj lëndimi, sëmundjeje ose humbje jete të lidhura me punën.

- Një Inxhinier i Ndërtimtaris Drejtimi Konstruktiv Inxhinieri të jetë i Çertifikuar për Siguri dhe Shendet ne Punë

Çertifikimi i inxh. Nuk eshte kriter diskriminuse te asnje kompani, pasiqe ka ing te çertifikuar si dhe eshte si kriter i qendrushem.

- Dy saldus te çertifikuar kerkohen per EN ISO 9606-1/2012
- Nje minidamper me pesh max.3.0ton
- Nje autobot për ujë min. 17,000L – eshte e nevojshem per testimin e rrejti , pas perfundimit te projektit per pranim teknik do te testohet i gjith rrjeti , po ashtu ne rast te paraqitjes se ujrave nentoksor sherben per funksionin e largomit te ujrave.

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

Pretendimi ankimor themelor i OE "Diamanti" sh.p.k ka të bëj me inicimin e aktivitetit të prokurimit nga AK **pa e hartuar Projektin Ekzekutues.**
Ky pretendim i OE-së është konfirmuar nga vet AK në Vendimin e tij të datës 25.11.2022, përmes të cilit ka refuzuar Kërkesën për rishqyrtim të OE "Diamanti" sh.p.k.

Neni 28, paragrafi 10 i LPP-së përcakton që:

*"Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili **në mënyrë mandatore** duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. **Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.**"*

Një kërkesë e tillë është specifikuar më tej edhe në Nenin 19.17 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, i cili e definon projektin ekzekutues si në vijim:

*"Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtron, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen. [...]".*

Hartimi i Projektit ekzekutues përveç që është një obligim ligjor, ai do të ndihmonte AK në definimin e saktë të specifikimeve teknike, përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes që janë relevante me lëndën e kontratës dhe sqarimin e të gjitha paqartësive dhe dilemave që mund të shfaqen për OE-të në projekte të kësaj natyre.

Rrjedhimisht, pretendimi i OE "Diamanti" sh.p.k është i bazuar.

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| |
|---|
| Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për kontratë dhe aktiviteti i prokurimit të zhvillohet në pajtim me kërkesat e LPP-së dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik. |

Raporti i ekspertizës i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Gllogoc
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – Diamanti Sh.p.k.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 794/22
Data/Datum: 30.12.22
PRISHTINË - PR

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | | |
|---|---|---|---|
| *Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues* | *Data e autorizimit të ekspertit:* **27.12.2022** | *Data e dorëzimit të raportit:* **29.12.2022** | *Nr. i lëndës:* **794/22** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **22.12.2022**, OE ankues: **"PM Group" Sh.p.k. – Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **794/22**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës),** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rregulllimi i infrastruktures trotuarit dhe ndriqimit publik ne Koumunen e Drenasit-proejkt dy vjeçar - Ritenderim"** me nr. të prokurimit: **611-22-5551-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna Gllogoc.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **356.646,00 €**

***Shënim:*** *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është nxjerr 1 (një) vendim nga OSHP-ja. Vendimi PSH.nr. 356/22 të datës 14.10.2022*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "PM Group" Sh.p.k. – Prishtinë

*(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).*

**Si BM Group SH.P.K Prishtine, "Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Rezidencë L9," pn. 04/L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ne nenet e me poshtme:**

Neni 1. Qëllimi
Neni 7. Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminim
Neni 24. Zyrtaret e prokurimit gjate ushtrimit te aktivitetit te prokurimit
Neni 54. Njoftimi i Kandidateve dhe Tenderuesve te Eliminuar
Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

**Pretendojmë se ka shkelje edhe te Legjislacionit sekondar A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (rregulla këto mbi te cilat është rregulluar procedura e prokurimit " Rregullimi i infrastrukturës trotuarit dhe ndriçimit publik ne Komunën e Drenasit – projekt dy vjeçar – Ritenderim me numër 611-22-5551-5-2-1 shkeljet janë te paraqitura me poshtë:**

1. Fushëveprimi i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ
3. Qëllimi i Rregullave dhe Udhëzuesit
41. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
43. Njoftimi i Tenderueseve/Kandidateve

**Jemi te vetëdijshëm se nga data 01.11.2022 ekziston një rregullore e veçante e cila e ka shfuqizuar rregulloren e paraqitur me larte, por fakti qe procedura është e hapur me date 28.06.2022 si GOE shfrytëzojmë te drejtat ankimuese brenda AK duke u bazuar ne RrUOPP.**

Autoriteti Kontraktues – KOMUNA GLLOGOC, ka shkelur edhe dispozitat tjera te LPP-se dhe RrUOPP-së gjate dhe ne trajtimin e kërkesës për rishqyrtim; 108/A zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve, konkretisht piken 6 dhe 12.

**Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:**

**Detaj fillestar lidhur me ankim imin e BM Group Sh.p.k. Prishtine, Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Rezidencë L9, pn pranë OSHP-së.**

**Pretendimi numër 1.**

Bazuar ne formularin B58, njoftimin mbi vendimin e AK te datës 09.12.2022, ne si OE jemi klasifikuar si Operator Ekonomik i pasuksesshëm dhe arsyeja ne Letrën Standarde ishte se arsyeja pse ju është dhënë kontrata grupin e operatoreve ekonomik: Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove, ishte vetëm pse me Oferte ishin me te lire se sa Oferta e BM Group SH.P.K. Prishtine, "Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Rezidencë L9, pn.

1) Bazuar ne vendimin e OSHP-se me numër 356/22 te datës 14.10.2022, OSHP i rekomandon AK – Komuna Gllogoc qe procedurën ne fjale ta kthej ne rivlerësim dhe për 7 ose 8 pretendime te Grupit e Operatoreve Ekonomik: Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove lidhur me dokumentacionin e BM Gruop ShPK Prishtine Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Rezidencë L9, pn, rekomandon qe gjate rivlerësimit për këto 7/8 dokumente thekson qe duhet te na kërkohen përmes kërkesës për dokumente dhe sqarime shtese.
2) Komuna Gllogoc me vendimin e datës 09.12.2022, BM Group Shpk Prishtine, Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Rezidencë L9, pn. Shpalle si Operatore Ekonomik te pasuksesshëm (pra qe i plotëson te gjitha kriteret por vetëm problemi është çmimi) ani pse ne asnjë faze te rivlerësimit nuk na kërkohet asnjë dokument për plotësim (me qellim te përfundojmë me ketë status), pra AK dhe komisioni vlerësues këtu ka vepruar ne kundërshtim te plote me nenin 1 Qëllimin , nenin 7 Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminim dhe Nenin 24. Zyrtaret e prokurimit gjate ushtrimit te aktiviteteve te prokurimit.
3) Duke e pare këtë rezultat, kemi vërejtur se dokumentacioni është kontrolluar vetëm sa për ta mbyllur obligimin e vlerësimit, mirëpo jo ne përputhje me kriteret e përcaktuara ne dosje te tenderit (ku mbi këtë shqetësim se Operator Ekonomik) kemi ngritur kërkesën për rishqyrtim.
4) Ne kërkesën për rishqyrtim ku si Operator Ekonomik ngritëm 4 pretendime me detale e detale, Autoriteti Kontraktues (brenda pak kohës, pa kontrolluar fare dokumentacionin) e kthen përgjigjen se pretendimet janë te pabazuara, duke mos jap asnjë detaj pse janë te pa bazuara.

**Pretendimi numër 2.**

1) Bazuar ne formularin B58, Njoftimin mbi vendimin e AK te datës 09.12.2022, AK-Komuna Gllogoc e rekomandon për kontrate : Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove, ne kundërshtim te plote me nenin 54. Njoftimi i Kandidateve dhe Tenderuesve te Eliminuar, Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve te LPP-se dhe ne kundërshtim te plote me nenin 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve dhe 43. Njoftimi i Tenderueseve/Kandidateve, pranoni detajet pse një gjë e tillë ka ndodhur:
2) AK-Komuna Gllogoc, tenton te shpërblej me kontrate Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove, edhe pse ka vepruar ne kundërshtim me vet kriteret e përcaktuara ne formularin e dosjes se tenderit, shiko Pika 2 e kërkesave dhe përshtatshmërisë kërkon 2. Një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore e vendit te themelimit 2. Një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore e vendit te themelimit te operatorit ekonomik, se operatori ekonomik (vetëm për OE fitues) – kopje. Jo me te vjetër se 90 dite. Detajet e shkeljes:





S.B

1000939792

Name of Person: MIRUSHA COMPANY SH.P.K.

Personal Identification Number: 1003924480

Fiscal Number: 810317067

Municipality: KLINË

Date: 26.08.2022

Aplikim për Tender

*Bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga kompania e cila është ne konsorcium MIRUSHA COMPANY SH.P.K. ka dokument te lëshuar me date 26.08.2022 dhe ne rast se analizohet data kur AK – Komuna Gllogoc ka shpallur fitues suksesshëm* Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove, me date 09.12.2022 i bije se ky dokument është jashtë validitetit dhe se i njëjti i ka skaduar afati me date 26.11.2022. Këtu autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 24 pika 2 ku theksohet se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për te siguruar qe te gjitha aktivitetet e prokurimit te autoritetit te tille kontraktues te ekzekutohen ne përputhshmëri te plote me këtë ligj.

3) Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ne Drenas z. Gezim Hajdini (pavarësisht se e she një shkelje te plotë te dispozitave ligjore te LPP-së dhe Rregullave) i njëjti e kthen te pabazuar kërkesën për rishqyrtim te paraqitur nga ana jone.

**Pretendimi numer 3.**

AK – Komuna Gllogoc përmes Formularit B58 ka paraqitur si GOE te suksesshëm Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove, edhe pse ka vepruar ne kundërshtim me vet kriteret e përcaktuara ne formularin e dosjes se tenderit, shiko:

Kriteri numër 2. i Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare thekson se 2. OE te këtë një deklarate nga banka ose letër mbështetëse qe dëshmon se OE ka mjete te gatshëm ne xhirollogari dhe dëshmia kërkohet; Dokumenti te jete i skanuar nga origjinali i nënshkruar dhe i vulosur nga institucionet bankare ne vlere e projektit, ose dëshmi nga banka për qasje ne kredi apo limit kreditor te aprovuar.

1) Detaje te shkeljes: Përmes procesverbalit te komisionit vlerësues, te njëjtit paraqesin se dokumenti i paraqitur nga OE i rekomanduar plotëson kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktues. E veçanta te theksohet është se dokumenti i lëshuar nga banka nuk ka asnjë aprovim e as nuk thekson se ne llogarinë e kompanisë ka mjete financiare sipas dosjes, ashtu siç është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues ne formularin e dosjes se tenderit.

> Nëse subjekti juridik Subjekti Juridik N.N.P TONI (LABINOT M. KRASNIQI B.I)., kërkon mbështetje financiare lidhur me projektin/ tenderin e lartcekur banka do shqyrtojë financimin e tij, bazuar në procedurat e saj të brendshme.
>
> Kjo pjese është tërhequr nga dokumenti i Bankës/pra ka një shpropоrsion te plote mes asaj se çfarë është kërkuar dhe asaj çfarë ka paraqitur OE.





S.B

2) Komisioni vlerësues ka bërë tejkalim te kompetencave sepse te njëjtit është dashur te kërkojnë sqarime ne banke se i njëjti dokument a e plotëson kriterin e përcaktuar ne formularin e dosjes se tenderit.

**Pretendimi numër 4.**

AK – Komuna Gllogoc përmes formularit B58 ka paraqitur si GOE te suksesshëm Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove edhe pse ka vepruar ne kundërshtim me vet kriteret e përcaktuara ne formularin e dosjes se tenderit, shiko:

Kriteri numër 1. i kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare thekson 1. Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe 1. Kopje e pasqyrave financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit – (te bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit) – PER LIDERIN.

1) Detajet e shkeljes: Përmes procesverbalit te komisionit vlerësues, te njëjtit paraqesin se nuk janë kompetent (jo-kompetent) për këtë vlerësim. Pra, ata bijën ne kundërshtim me vetveten ku ne njërën ane theksojnë se nuk janë kompetent te vlerësimit dhe ne anën tjetër supozojnë se ky raport është i plotësuar dhe rekomandojnë GOE e njëjte për shpërblim me kontrate.
2) Komisioni Vlerësues ka bere tejkalim te kompetencave sepse te njëjtit është dashur te kërkojnë sqarime direkt nga KKRF për te pare nëse dokumenti i paraqitur a i plotëson kriteret e paraqitura ne dosjen e tenderit nga AK – Komuna Gllogoc.

BM Group Sh.P.K. Prishtinë "Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Rezidencë L9", paraqet se lidhur me përzgjedhjen e operatoreve ne fjale ka edhe shkelje tjera (por përderisa këto 4 pretendime) i kemi ngritur ne kërkesën për rishqyrtim (llogarisim se vetëm këto dokumente duhet te trajtohen nga eksperti shqyrtues i lendes).

**Pretendimi numër 5. Sqarim detal:**

Autoriteti kontraktues – KOMUNA GLLOGOC, ka shkelur edhe dispozita tjera te LPP-se dhe RrUOPP-se gjate dhe ne trajtimin e kërkesës për rishqyrtim; 108/A zgjedhja preliminarë e mosmarrëveshjeve, konkretisht piken 12.

1) AK gjate trajtimit te kërkesë për rishqyrtim/ ne vendimin e datës 15.12.2022 ka vepruar ne kundërshtim te plotë me piken 12 te nenit 108/A Zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve ku theksohet: 12. Kundërshtimit dhe vendimet e miratuara ne përputhje me paragrafët 8 dhe 10 te këtij neni, duhet te jene te arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, ne përputhje me këtë ligj, parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara, nëse ka ndonjë (pra, ky zyrtar duke keqpërdorur edhe detyrën e besuar, nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me pretendimet tona).

BM Group Sh.P.K. Prishtinë, Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Rezidencë L9, pn rekomandon qe kërkesa e jone te aprovohet si ne tërësi e bazuar dhe procedura e Rregullimi i infrastrukturës trotuarit dhe ndriçimit publik ne Komunën e Drenasit – projekt dy vjeçare – Ritenderim me numër te prokurimit: 611-22-5551-5-2-1.

1. Ne vendimin për rishqyrtim te ankesës/ te karakterizohet Ankesa – SI E BAZUAR
2. Kthimi i lendes ne RIVLERESIM
3. Gjate ri-vlerësimit ku kërkohen informacione ne Banke për dokumentin e liderit te GOE te rekomanduar, ju drejtohet me e-mail edhe KKRF-se nëse raportet janë ne përputhje me Ligjin dhe neve na u kërkohet informacionet sipas vendimit te OSHP-se.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK ), nuk janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktue (pasi qe tek ankesa ne OSHP ka shtuar edhe nenin 54 dhe 59 te LPP-se. si dhe nenin 1, 3 41 dhe 43 te RRUOPP-se), ndersa tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet e ankeses ne OSHP – është plotesuar /shtuar me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.





S.B

## KRITERET PËR VLERËSIM

*(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore*

| **III.2.1)** ***Kërkesat e përshtatshmërisë*** | ***Dëshmia e kërkuar dokumentare*** |
|---|---|
| 1. Kërkesat përshtatëshmerisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L- 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, përkatësisht Nenit 65 pika 1,2,3,4, 4.9 dhe 5. | 1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal. |
| 2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit | 2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik (vetem per OE fitues) - kopje. Jo me te vjeter se 90 dite. |
| 3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike | 3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetem per OE fitues) – origjinal. Jo me te vjeter se 6 muaj. |

| **III.2.3)** ***Kapaciteti ekonomik dhe financiar:*** | ***Dëshmia e kërkuar dokumentare*** |
|---|---|
| **Kërkesat:**<br>1. Pasqyrat financiare te audituara per tri vitet e fundit.<br><br>2. OE te kete nje deklarate nga banka ose leter mbeshtese qe deshmon se OE ka mjete te gateshme ne xhirollogari | **Evidencat:**<br>1. Kopjet e pasqyrave financiare te audituara per tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit per pasqyrat perkatese nga nje Auditor i Licencuar ose ndonje kompani e auditimit - ( te bashkangjitet kopje e noterizuar e licences se Auditimit )- PER LIDERIN<br><br>2. Dokumenti te jete i skanuar nga origjinali i nenshkruar dhe i vulosur nga institucionet bankare ne vlere e projektit , ose deshmi nga banka per qasje ne kredi apo limit kreditor te aprovuar . |

## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

*Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Tëpërshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).*

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

KOMISIONI I VLERSIMIT VERIFIKOJ TE GJITHA OFERTAT E OPERATOREVE EKONOMIK , KOMISIONI NE MENYRE UNANIME VENDOSI PER FITUES Grup i Operatorëve Ekonomik Labinot M. Krasniqi B.I.; TONI INGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K. I PERGJEGJSHEM ME CIMIM ME TE ULET 332,555.00 €

KRYESUESI DHE ANETARET E KOMISIONIT :

1. Fitim Veliqi
2. Ardian Gashi
3. Ksamil Ramadani

**Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit:** GEZIM HAJDINI

**Nënshkrimi:**

**data:** 02.12.2022





S.B

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden ne platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik ankues pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

*(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)*
///

## VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

*(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).*
///

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

*(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).*
///

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "PM Group" Sh.p.k. – Prishtinë

*- Ekperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:*

### Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK-Komuna Gllogoc, tenton te shpërblej me kontrate Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove, edhe pse ka vepruar ne kundërshtim me vet kriteret e përcaktuara ne formularin e dosjes se tenderit, shiko Pika 2 e kërkesave dhe përshtatshmërisë kërkon 2. Një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore e vendit te themelimit 2. Një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore e vendit te themelimit te operatorit ekonomik, se operatori ekonomik (vetëm për OE fitues) – kopje. Jo me te vjetër se 90 dite. Detajet e shkeljes:


MIRUSHA COMPANY SH.P.K.
1002924480
810317067
KLINË
26.08.2022
Aplikim për Tender

*Bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga kompania e cila është ne konsorcium MIRUSHA COMPANY SH.P.K. ka dokument te lëshuar me date 26.08.2022 dhe ne rast se analizohet data kur AK – Komuna Gllogoc ka shpallur fitues suksesshëm* Grupi i Operatoreve ekonomik Labinot M Krasniqi B.I. ; TONIINGJINJERING; MIRUSHA COMPANY SH.P.K., Kosova Gllogoc Negrofc, 13050. NEGROFC, Kosove, me date 09.12.2022 i bije se ky dokument është jashtë validitetit dhe se i njëjti i ka skaduar afati me date 26.11.2022. Këtu autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 24 pika 2 ku theksohet se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për te siguruar qe te gjitha aktivitetet e prokurimit te autoritetit te tille kontraktues te ekzekutohen ne përputhshmëri te plote me këtë ligj.





S.B

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat - Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik neni 6.4 **të FDT-së**, si ne vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| 2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit | 2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik (vetem per OE fitues) - kopje. Jo me te vjeter se 90 dite. |

Lideri i GOE me rastin kërkesë për sjelljen/dorëzimin e dokumenteve për GOE te rekomanduar për kontrate ka dorëzuar vërtetimin nga ATK te lëshuar me datës 26.08.2022 për anëtarin e grupit "Mirusha Company" Sh.p.k. (sikurse e ka prezantuar OE ankues ne ankesën e tij), andaj sqarimi nga ESH është si ne vijim: Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia "Vërtetimi nga ATK" dhe për të qenë "i pranueshëm" OE sipas **nenit 65 të LPP-së,** duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i "pranueshëm", ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë, Mirëpo evidenca e përcaktuar nga ZPP ne dosje te tenderit është ne disproporcion me kërkesën, andaj për vendosje ne këtë aktivitet te prokurimit duhet te merret vetëm kërkesa, pavarësisht kësaj teksti "Jo me të vjetër se 90 ditë" i përcaktuar nga AK – ZPP nuk ka baze ligjore, nuk e kuptoj arsyen çka ka dashtë, çfarë ka menduar, apo ka rrjedh gabim teknik, si do që të jetë kjo fjali është pjese e dosjes se tenderit, dhe OE mund te mos e kuptojnë drejt dhe kanë arsye te parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim, dhe ZPP ka qene i obliguar te pergjigjiet dhe te arsyetoj këtë pretendim te OE ankues dhe jo te heshte. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i pjesërisht i qëndrueshëm.**

**Përgjigje në Pretendimi nr. 2**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK tek Kriteri numër 2. i Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare thekson se 2. OE te këtë një deklarate nga banka ose letër mbështetëse qe dëshmon se OE ka mjete te gatshëm ne xhirollogari dhe dëshmia kërkohet; Dokumenti te jete i skanuar nga origjinali i nënshkruar dhe i vulosur nga institucionet bankare ne vlere e projektit, ose dëshmi nga banka për qasje ne kredi apo limit kreditor te aprovuar.

1) Detaje te shkeljes: Përmes procesverbalit te komisionit vlerësues, te njëjtit paraqesin se dokumenti i paraqitur nga OE i rekomanduar plotëson kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktues. E veçanta te theksohet është se dokumenti i lëshuar nga banka nuk ka asnjë aprovim e as nuk thekson se ne llogarinë e kompanisë ka mjete financiare sipas dosjes, ashtu siç është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues ne formularin e dosjes se tenderit.

> Nëse subjekti juridik Subjekti Juridik N.N.P TONI (LABINOT M. KRASNIQI B.I)., kërkon mbështetje financiare lidhur me projektin/ tenderin e lartcekur banka do shqyrtojë financimin e tij, bazuar në procedurat e saj të brendshme.
>
> Kjo pjese është tërhequr nga dokumenti i Bankës/pra ka një shproporsion te plote mes asaj se çfarë është kërkuar dhe asaj çfarë ka paraqitur OE.

Komisioni vlerësues ka bërë tejkalim te kompetencave sepse te njëjtit është dashur te kërkojnë sqarime ne banke se i njëjti dokument a e plotëson kriterin e përcaktuar ne formularin e dosjes se tenderit

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare **neni 8.1 & 8.2 të FDT-së**, si në vijim:

| **Kërkesat:** | **Evidencat:** |
|---|---|
| **2.OE te kete nje deklarate nga banka ose leter mbeshtese qe deshmon se Oe ka mjete te gateshme ne xhirollogari** | **2.Dokumenti te jete i skanuar nga origjinali i nenshkruar dhe i vulosur nga institucionet bankare ne vlere e projektit , ose deshmi nga banka per qasje ne kredi apo limit kreditor te aprovuar .** |





S.B

Bazuar ne raportin e raportin e rivlerësimit te datës 09.12.2022 AK – komisioni i vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar edhe këto kërkesa te FDT-se nga GOE i rekomanduar për kontrate ashtu edhe nga OE ankues, ku potencon se janë ne "pajtim" andaj vlerësimi është ne diskrecion te AK – komisionit te vlerësimit dhe ky komision nuk ka pas paqartësi për te kërkuar sqarime shtese, sikur te kishte do te vepronte sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

OE ankues ka prezantuar letër reference nga banka si në vijim:

Nëse klienti **"BM GROUP SHPK"** kërkon mbështetje financiare deri në shumën prej **500,000.00 EURO**, per projektin: **"Rregullimi i infrastruktures trotuarit dhe ndriqimit publik ne Koumunen e Drenasit-proejkt dy vjeçar - Ritenderim"** me numer te prokurimit: **611-22-5551-5-2-1**, ProCredit Bank do të konsiderojë financimin bazuar në kapacitetin e tij financiar pas analizës financiare të bërë nga analistët tanë të kredive.

Duke marr parasysh dokument e ofruara nga OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, si dhe pretendimi i OE ankues i cili nuk e sqaron/arsyeton/argumenton ne mënyrë te detajuar, pse ky dokument i dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontrate, nuk e plotëson kërkesën e AK te përcaktuar ne dosje te tenderit, por thotë po citoj: "*Kjo pjese është tërhequr nga dokumenti i Bankës/pra ka një shproporsion te plote mes asaj se çfarë është kërkuar dhe asaj çfarë ka paraqitur OE*", andaj është e pamundur nga eksperti shqyrtues te nxjerr një konstatim se ky kriter nuk është plotësuar nga GOE apo edhe nga OE ankues. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

## Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK tek Kriteri numër 1. i kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare thekson 1. Pasqyrat financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe 1. Kopje e pasqyrave financiare te audituara për tri vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë kompani e auditimit – (te bashkëngjitet kopje e noterizuar e licencës se Auditimit) – PER LIDERIN.

1) Detajet e shkeljes: Përmes procesverbalit te komisionit vlerësues, te njëjtit paraqesin se nuk janë kompetent (jo-kompetent) për këtë vlerësim. Pra, ata bijën ne kundërshtim me vetveten ku ne njërën ane theksojnë se nuk janë kompetent te vlerësimit dhe ne anën tjetër supozojnë se ky raport është i plotësuar dhe rekomandojnë GOE e njëjte për shpërblim me kontrate.
2) Komisioni Vlerësues ka bere tejkalim te kompetencave sepse te njëjtit është dashur te kërkojnë sqarime direkt nga KKRF për te pare nëse dokumenti i paraqitur a i plotëson kriteret e paraqitura ne dosjen e tenderit nga AK – Komuna Gllogoc.

**Eksperti shqyrtues sqaron,** se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne

Bazuar ne raportin e raportin e rivlerësimit te datës 09.12.2022 AK – komisioni i vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar edhe këto kërkesa te FDT-se nga GOE i rekomanduar për kontrate ashtu edhe nga OE ankues, ku potencon se janë ne "pajtim" andaj vlerësimi është ne diskrecion te AK – komisionit te vlerësimit dhe ky komision nuk ka pas paqartësi për te kërkuar sqarime shtese, sikur te kishte do te vepronte sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Prandaj këto pretendimi te ngritura nga OE ankues nuk janë të mbështetura nga prova dhe argumente andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

## Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Autoriteti kontraktues – KOMUNA GLLOGOC, ka shkelur edhe dispozita tjera te LPP-se dhe RrUOPP-se gjate dhe ne trajtimin e kërkesës për rishqyrtim; 108/A zgjedhja preliminarë e mosmarrëveshjeve, konkretisht piken 12.

1) AK gjate trajtimit te kërkesë për rishqyrtim/ ne vendimin e datës 15.12.2022 ka vepruar ne kundërshtim te plotë me piken 12 te nenit 108/A Zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve ku theksohet: 12. Kundërshtimit dhe vendimet e miratuara ne përputhje me paragrafët 8 dhe 10 te këtij neni, duhet te jene te arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, ne përputhje me këtë ligj, parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara, nëse ka ndonjë (pra, ky zyrtar duke keqpërdorur edhe detyrën e besuar, nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me pretendimet tona).





S.B

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e-prokurim ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me date 13.12.2022, ndërsa ZPP ka pezulluar aktivitetin e prokurimit ne platformën elektronike, duke vepruar ne pajtim me **nenin 108/A par. 2 te LPP-së,** ku thotë: "*Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar*", pastaj ZPP me date 15.12.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke mos vepruar ne pajtim te plotë me **nenin 108/A par. 9 te LPP-se,** ku thotë: "*Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.*" si dhe **nenin 108/A par. 12 te LPP-se, ku thotë:** *Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë",* që do të thotë se AK – ZPP ka qene i obliguar te veproj ne pajtim te plote sipas neneve dhe sqarime si me larte, pasi qe vendimi i nxjerr nga ZPP i datës 15.12.2022 i mungon pjesa kryesore – dispozitiv (arsyetimi i refuzimit te kërkesë për rishqyrtim). Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **ka respektuar nenin 7, 59, 60 të LPP-së,** andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

**Eksperti shqyrtues sqaron**, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e GOE akues **të aprovohet si pjeserisht e bazuar**, dhe rekomandon të mbetet në fuqi B58 - njoftimi mbi vendimin e AK (*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe autoriteti kontraktues të vazhdoj me procedurën duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

*Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:*

- *Autoritetit Kontraktues* – *Komuna Gllogoc*
- *Panelit Shqyrtues* – *OSHP*
- *Grupi OE ankues* – "BM Group " Sh.p.k.– *Prishtinë*



S.B